USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

AFTER SCHOOL SUPPORT FOR TEENS

KEC
Qendra per Arsim e Kosoves
Kosova Education Center



# JETA DHE PUNA

## DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT E GJIMNAZEVE

| Prishtinë, 2022

**Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.**

**Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt (ASSET) të cilin e zbaton Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në partneritet me Family Health International (FHI 360) dhe Crimson Capital.**

# JETA DHE PUNA

## DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT E GJIMNAZEVE

**HARTIMI:**

Ky doracak është bazuar në Udhëzuesit për Fasilitues të kurseve “Këshillimi dhe orientimi për karrierë” hartuar nga Dr. Bardha Qirezi dhe Dr. Keith Prenton; “Ndërmarrësia dhe edukimi financiar” hartuar nga MSc. Dafina Turkeshi, MA. Valire Ismaili dhe MA. Mexhide Çollaku; si dhe “Klubi i teknikëve” hartuar nga MSc. Rrezarta Pllana dhe MA. Burbuqe Hana, dhe zyrtarët teknik të Programit ASSET.

Doracaku për mësimdhënës është përpiluar dhe pasuruar edhe me përmbajtje për koceptet e “Edukimit për zhvillim të qëndrueshëm” nga Dr. Bardha Qirezi, MA. Shpresa Hoxha, MA. Lamir Shkurti, MA. Njomza Selimi, MA. Pajtim Vela dhe Cand.Dr. Luljeta Belegu Demjaha. Doracaku është pasuruar me shembuj konkret të planeve mësimore të realizuara nga mësimdhënësit e trajnuar përmes këtyre kurseve.

**BOTIMI I PARË**
Maj, 2022

**FALËNDERIM:**

Programi “Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt” dëshiron të falënderojë të gjithë kontribuesit që ndihmuan në hartimin e këtij doracaku. Falënderime të veçanta shkojnë për ekipin hartues, shkollat partnere të programit dhe mësimdhënësit, të cilët ofruan shembuj të planeve mësimore për këtë doracak.

# PËRMBAJTJA


**MIRËSEVINI** ... 7

**TABELA E SHKURTESAVE** ... 8

**SI MUND T'JU NDIHMOJË KY DORACAK** ... 9

**SI TË PËRDORET KY DORACAK** ... 13

**KAPITULLI PARË** ... 15

**FUSHA MËSIMORE JETA DHE PUNA – konceptet themelore** ... 15

- **Përshkrimi dhe konceptet e fushës** ... 15
- **Fondi i orëve** ... 15
- **Zbatimi i integruar i koncepteve** ... 16

**KAPITULLI DYTË** ... 19

**TEKNOLOGJI E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK)** ... 19

- **Programet e TIK-ut dhe rëndësia e tyre** ... 19
- **Mësimi praktik i programeve kompjuterike dhe gjuhëve programuese** ... 23

**KAPITULLI TRETË** ... 25

**NDËRMARRËSIA DHE EDUKIMI FINANCIAR (NEF)** ... 25

- **Përfitimet nga ndërmarrësia** ... 25
- **Krijimi i Vlerave/ Krijimi i idesë** ... 26
- **Modeli i Biznesit CANVAS** ... 27
- **Të bërit biznes dhe konteksti i tregut** ... 29
- **Profili i ndërmarrësit dhe shkathtësitë** ... 31
- **Zbatimi i koncepteve të ndërmarrësisë në krijimin e projekteve në shkolla** ... 31

**KAPITULLI KATËRT** ... 33

**ORIENTIMI DHE KËSHILLIMI PËR KARRIERË (OKK)** ... 33

- **Karriera koncept i rëndësishëm për të gjithë** ... 33
- **Ideimi i njësive mësimore për OKK** ... 40

**KAPITULLI PESTË** ... 43

**EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM (EZhQ)** ... 43

- **Kalkulatori i gjurmës** ... 43
- **Paketa e Gjelbër** ... 43
- **Aktivitetet në shkollë** ... 45

**KAPITULLI GJASHTË** ... 48

**SHEMBUJ TË PLANEVE MËSIMORE TË REALIZUARA NGA FUSHA JETA DHE PUNA** ... 48

Shembujt e Njësive Mësimore, Klasa e 10-të ........ 49
Shembujt e Njësive Mësimore, Klasa e 11-të ........ 50
Shembujt e Njësive Mësimore, Klasa e 12-të ........ 51
**SHTOJCAT** ........ 52
Formulat dhe funksionet ........ 54
3.1. Projekti shitorja ime ........ 58
Krijimi i një biznesi të ri ........ 62
Komunikimi Elektronik ........ 95
Projekti: Baza e të dhënave -Fakultetet ........ 100
Ide ndërrmarrëse ........ 107
Hyrje në Java ........ 117
Krijimi dhe Shitja e Produkteve të realizuara me 3D printer ........ 121
Karriera Ime: Profesioni im ........ 130
Karriera Ime: Kërkimi i Fakultetit ........ 137
**Shtojca 1: Analiza e RNF, RNL dhe Njësive mësimore për qëllime planifikimi** ........ 143

# MIRËSEVINI

**Të dashur mësimdhënës**,

Ky doracak, është hartuar specifikisht për mësimdhënësit e fushës 'Jeta dhe Puna', dhe përmban në vete katër koncepte të ndryshme mësimore, si: Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Ndërmarrësia dhe Edukimi Financiar (NEF), Këshillimi dhe Orientimi për Karrierë (OKK), dhe Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm (EZhQ)., ku këto nuk janë të ndara si lëndë të veçanta, si dhe në dokumentet kurrikulare identifikohen përmes rezultateve mësimore të pritura. Pikërisht, mosndarja specifike e këtyre koncepteve në lëndë të veçanta, me fond të caktuar të orëve ka bërë që mos të gjejnë zbatim të gjitha, por vetëm TIK-u në kuadër të fushës 'Jeta dhe Puna'. Mësimdhënësve të kësaj fushe u ka munguar edhe zhvillimi profesional i plotë për të realizuar rezultatet e pritura, sipas kërkesave të kurrikulës, prandaj, pikënisje fillestare për hartimin e doracakut ka qenë bashkëpunimi me zyrtarët për trajnime në MASHTI, të cilët kanë shprehur nevojën për zhvillimin profesional të mësimdhënësve të kësaj fushe, si mbështetje e drejtëpërdrejtë e reformës kurrikulare. Si rrjedhojë, ky material adreson realizimin e të gjitha koncepteve të fushës "Jeta dhe Puna.

Fillimisht, adresimi i koncepteve të fushës 'Jeta dhe Puna' u bë përmes programeve trajnuese të veçanta, si: Orientimi për Karrierë; Ndërmarrësia dhe Edukimi Financiar; Klubet e teknikëve, të cilat janë aprovuar nga KShLM, dhe pastaj përmes tyre janë trajnuar shumica e mësimdhënësve të fushës. Me përmbushjen e suksesshme të kërkesave nga këto kurse, mësimdhënësit certifikohen me numër të caktuar të pikëve për licencim. Por, për të kompletuar dijen e tyre për realizimin e plotë të fushës mësimore 'Jeta dhe Puna'", gjatë hartimit të doracakut, janë marrë për bazë kërkesat specifike të zbatimit të RN-ve nga Kurrikula Bërthamë, prandaj këtu janë adresuar edhe dy konceptet tjera: TIK-u dhe EZhQ.

Doracaku, i cili do t'u shërbejë mësimdhënësve që të freskojnë njohuritë e fituara në kurset e lartëcekura, por edhe mësimdhënësve të rinj të cilët dëshirojnë të mësojnë më tepër në zbatim të kësaj fushe mësimore, është hartuar në kuadër të programit "After School Support for Teens" (ASSET) – "Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt", të financuar nga USAID. Programi ASSET me kohëzgjatje 5 vjeçare, qershor 2017 – qershor 2022, është menaxhuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me FHI 360 dhe Crimson Capital Corp. Qëllimi kryesor i Programit ASSET është zhvillimi i shkathtësive për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë duke krijuar botëkuptim pozitiv për të ardhmen e tyre. Programi ka punuar me 16 gjimnaze në komuna të ndryshme të Kosovës: Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Viti, Kamenicë, Istog, Obiliq, Rahovec, Lipjan, Suharekë, Han të Elezit, Fushë Kosovë dhe Vushtrri. Aktivitetet kryesore të realizuara nga Programi mund të përmbledhen në: zhvillim të kompetencave për jetë dhe punë, përkrahje të edukimit për karrierë dhe ndërmarrësi në shkolla, dhe lidhjen e shkollave me punëdhënës dhe komunitet.

Suksese!

# TABELA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| **ASSET** | After School Support for Teens (Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt) |
| **DKA** | Drejtoritë komunale të arsimit |
| **EZhQ** | Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm |
| **FHI360** | Family Health International |
| **KEC** | Qendra për arsim e Kosovës |
| **MESTI** | Ministria e arsimit, e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit |
| **NEF** | Ndërmarrësia dhe edukimi financiar |
| **OKK** | Këshillimi dhe orientimi për karrierë |
| **RNF** | Rezultatet e të ncënit të fushës kurrikulare |
| **RNK** | Rezultatet e të nxënit për kompetenca |
| **RNL** | Rezultatet e të nxënit të lëndës |
| **TIK** | Teknologjia e informacionit dhe komunikimit |
| **USAID** | United States Agency for International Development |
| **ZhPM** | Zhvillimi profesional i mësimdhënësve |



Nxënësit e gjimnazit 'Gjon Buzuku' gjatë realizimit të projekteve në hapësirën krijuese të shkollës

# SI MUND T'JU NDIHMOJË KY DORACAK

Ky doracak ka për qëllim t'u shërbejë mësimdhënësve të fushës 'Jeta dhe Puna', që të kuptojnë, jo vetëm secilin koncept të kësaj fushe veç e veç, por edhe të ndihmojnë nxënësit t;i integrojnë ato koncepte përmes projekteve mësimore. Në këtë mënyrë do të zgjerohet këndëvështrimi i mësimdhënësve duke i parë konceptet e fushës mësimore si të integruara dhe jo si aspekte të izoluara. Doracaku ka për bazë dhe reflekton dokumentet zyrtare të MASHTI-it,: Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Kurrikulën Bërthamë për gjimnaze, si dhe programin për ZhPM të kurseve OKK dhe NEF. Në doracak poashtu mund të gjeni edhe materiale dhe udhëzime praktike për realizim të koncepteve të TIK-ut dhe EZhQ, për të cilat mësimdhënësit pjesë e ekipit hartues të këtij doracaku kanë hartuar shembuj të ndryshëm të planeve mësimore me nxënës.

Qëllimet dhe parimet e Kurrikulës së Kosovës synojnë që të përmirësojnë cilësinë dhe efektivitetin e mësimdhënies në shkolla dhe që t'ua mundësojnë mësimdhënësve t'i zhvillojnë te nxënësit e tyre shkathtësitë përkatëse, përmes aktiviteteve të vazhdueshme. Materiali në këtë doracak është dedikuar, specifikisht për mësmdhënësit e gjimnazeve të fushës 'Jeta dhe Puna'. Me përvetësimin e këtij programi pritet, që mësimdhënësit të aftësohen, që të ndihmojnë nxënësit e tyre në arritjen e kompetencave mësimore, e në veçanti të zhvillojnë dhe vlerësojnë te ta shkathtësitë e buta, si: të menduarit kritik, punën ekipore, ndërgjegjëshmërinë dhe këmbëngulësinë, zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, shkathtësitë hulumtuese dhe ndërmarrëse. Këto shkathtësi ndihmojnë mësimdhënësit e të gjitha fushave kurrikulare, për ta ndërlidhur të nxënit dhe për ta bërë të njejtin sa më atraktiv për çdo moshë të fëmijëve. Për më tepër, ky program aftëson mësimdhënësit, që përmes vëzhgimit të vlerësojnë nxënësit e tyre në mënyrë të vazhdueshme, dhe t'u japin atyre informatë kthyese për t'u përmirësuar.

Përmes aktiviteteve dhe intervenimeve të ndryshme, programi ASSET ka mbështetur zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulës Bërthamë për klasat 10-12 të gjimnazeve, në veçanti duke i ofruar përkrahje fushës 'Jeta dhe Puna', po nuk është kufizuar vetëm te kjo fushë. Për të përkrahur shkollat në zbatimin e projekteve praktike, Programi ASSET ka mbështetur ato që të themelojnë hapësirat krijuese "Qendrat për karrierë dhe ndërmarrësi", të njohura si "Makerspaces", të cilat mund të shfrytëzohen gjatë dhe pas orarit mësimor. Këto hapësira janë te pajisura me teknologji bashkëkohore, për t'iu mundësuar nxënësve konkretizimin e mësimit teorik të secilës fushë mësimore, e poashtu edhe për punën e tyre hulumtuese.

Në bashkëpunim me partnerët tjerë, programi ASSET ka promovuar edhe "Qendrën virtuale të karrierës" busulla.com, portal online për karrierë, në dispozicion për të rinjtë dhe prindërit e tyre. Poashtu, janë angazhuar bizneset që të përkrahin nxënësit në zhvillimin e shkathtësive për punë, duke i përkrahur ata në realizimin e praktikës në kompanitë e tyre, me ç'rast të njejtit janë mentoruar dhe këshilluar për karrierë. Aktiviteti tjetër, "Harta e të rinjve për komunitetin", i orientuar në veprim, përmes të cilit të rinjtë hulumtojnë komunitetin e tyre përmes anketimeve dhe reflektimeve mbi informacionet e dhëna, përfshinë të rinjtë të cilët i pajisë me shkathtësi dhe kështu u mundëson të bëhen agjentë të ndryshimit dhe kontribues produktiv në komunitetin e tyre.




Mësimdhënësit gjatë trajnimit në NEF

**Ndërlidhja me kurrikulën**

Ndërlidhur me kërkesat kurrikulare të fushës ‘Jeta dhe Puna’, dhe në përgjithësi me strategjitë mësimore të rekomanduara me dokumentet kurrikulare për secilën fushë tjetër mësimore, Programi ASSET ka hartuar gjashtë programe për zhvillim profesional të mësimdhënësve (ZhPM):

1. Mësimdhënia e bazuar në projekte (MBP);
2. Vlerësimi për të nxënë (VpN);
3. Këshillimi dhe orientimi në karrierë;
4. Ndërmarrësia dhe edukimi financiar;
5. Klubet e teknikëve; dhe
6. Shkathtësitë e buta në kurrikulën shkollore.

Me këto programe të ZhPM është tentuar që të intervenohet drejtëpërdrejtë në procesin mësimor në klasë, përmes krijimit të mësimdhënësve kompetent, të cilët do të jenë në gjendje të zbatojnë sa më lehtë filozofnë e Kurrikulës së Kosovës. Në këtë drejtim, për katër vitet e para, Programi ASSET ka zhvilluar aktivitet të gjerë trajnimi të mësimdhënësve me programet e cekura më lart, me ç’rast mësimdhënësit e certifikuar janë shpërblyer me pikë të ndryshme për licencim. Gjatë këtij procesi janë përfshirë pjesa më e madhe e stafit mësimor në shkollat partnere të Programit, e poashtu edhe një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve nga shkollat jopartnere.

**Mësimdhënësit e certifikuar në programet e ASSET-it**

| # | Emri i programit | # pikëve për licencim | # të certifikuar | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | F | M | Gjithsejt |
| 1 | Mësimdhënia e bazuar në projekte | 24 | 303 | 218 | 521 |
| 2 | Vlerësimi për të nxënë | 24 | 183 | 124 | 307 |
| 3 | Këshillimi dhe orientimi për karrierë | 24 | 65 | 38 | 103 |
| 4 | Ndërmarrësia dhe edukimi financiar | 24 | 30 | 55 | 85 |
| 5 | Klubet e teknikëve | 24 | 20 | 25 | 45 |
| 6 | Shkathtësitë e buta në kurrikulën shkollore | 16 | 343 | 255 | 598 |

Procesi i trajnimit të mësimdhënësve është realizuar me bazë në shkollë, përmes fasilituesve shkollor, të cilët janë certifikuar paraprakisht përmes një procesi më kompleks. Fasilituesit shkollor janë përzgjedhur përmes një procesi të rekrutimit në bazë të kritereve të paracaktuara (mësimdhënës të përkushtuar, njohës të mirë të kurrikulës, të vullnetshëm të punojnë në mbështetje të kolegëve të tyre në shkollë, dhe të gatshëm që të kalojnë nëpër programin e përgatitjes së tyre për fasilitues), dhe pas trajnimit për programin bazë (p.sh. në MBP apo VpN), ata kanë përfunduar edhe kursin e standardeve të fasilitimit, dhe janë certifikuar.

Një numër i konsiderueshëm i fasilituesëve shkollor, të kurseve të lartë cekura, janë në dispozicion të shkollave nëpër komunat partnere të programit ASSET, por edhe në MASHT, për shfrytëzim të mëtejmë nga sistemi arsimor në vend.

Ndërlidhjen me filozofinë e kurrikulës së re, të bazuar në kompetenca mësimore, Programi ASSET e ka konkretizuar përmes posterit për mësimdhënës dhe për nxënës, të cilët paraqesin ndërvarrësinë dhe kontributin e listës së përzgjedhur të shkathtësive të buta në realizimin e gjashtë kompetencave kryesore të Kurrikulës së Kosovës.

AFTER SCHOOL SUPPORT FOR TEENS



# SI TË PËRDORET KY DORACAK

Ky doracak do të publikohet online, dhe do të jetë në dispozicion të të gjithë mësimdhënësve në mbarë vendin. Kryesisht do të përdoret nga mësimdhënësit e fushës ‘Jeta dhe Puna’ për t’u njoftuar me konceptet dhe kërkesat e dalura nga kurrikula, e po ashtu edhe me shembuj të ndryshëm për zbatimin e mësimit me nxënës në klasë.

Kapitulli i parë na njofton për llojet dhe konceptet themelore të fushës ‘Jeta dhe Puna’, dhe specifikat tjera të mësimdhënies, siç është fondi i orëve total dhe ndarja e orëve për konceptet e fushës. Pastaj ofrohen udhëzime për zbatimin e integruar të koncepteve të kësaj fushe.

Kapitulli i dytë përqëndrohet të konceptet e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK), programet e TIK-ut dhe rëndësinë e tyre, pastaj te mësimi praktik i programeve kompjuterike dhe gjuhëve programuese.

Kapitulli i tretë i dedikohet koncepteve të Ndërmarrësisë dhe Edukimit Financiar (NEF), përfitimeve nga ndërmarrësia, krijimit të vlerave dhe ideve për biznese. Më tutje udhëzohet për modelin e biznesit CANVAS, duke dhënë edhe shembuj të ndërmarrjeve të themeluara nga nxënësit, shpjegohet konteksti i tregut, profili i ndërmarrësit dhe shkathtësitë e nevojshme, dhe zbatimi i koncepteve të ndërmarrësisë në krijimin e projekteve në shkolla.

Kapitulli i katërt ka për temë qendrore Këshillimin dhe Orientimin për Karrierë (OKK), duke filluar me shpjegimin e rëndësisë së konceptit, pastaj reflektim mbi profesionet, dhe temat e lidhura me aktivitete të ndryshme në praktikë për mësimdhënësit dhe nxënësit. Dhe në pjesën e fundit ofrohen udhëzime për ideimin e mësimeve në klasë.

Kapitulli i pestë përqëndrohet te edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (EZhQ) dhe temat e lidhura me rezultatet mësimore që duhet zbatuar në klasë me nxënësit, si kalkulatori i gjurmës, paketa e gjelbër, dhe aktivitet gjatë realizimit në klasë.

Kapitulli i gjashtë dhe i fundit ofron shembuj të planeve mësimore të realizuara nga fusha ‘Jeta dhe Puna’, të strukturuar sipas klasave 10, 11 dhe 12.

Në fund ofrohen edhe shtojcat, ku mund të shihen të gjitha analizat, të cilat i kanë paraprirë hartimit të këtij doracaku.

# SHKATHTËSITË E BUTA
## PËR JETË DHE PUNË

### Jam mendimtar kritik
- Dua të jem i informuar drejt
- Arsyetoj duke u bazuar në fakte, të dhëna, informacione të verifikuara
- Arsyetoj gjykimet e mija
- Përdor logjikën
- Dalloj të gabuarën
- Marr parasysh rrethanat para se të marr qëndrim

### Jam i ndërgjegjshëm
- Respektoj rregullat dhe udhëzimet e dakorduara
- Jam i përpiktë
- Planifikoj realizimin e aktiviteteve/ detyrave
- Menaxhoj mirë kohën
- Veproj me sinqeritet
- Reagoj ndaj sjelljeve jo-etike

### Jam komunikues i mirë
- Flas dhe shkruaj qartë
- Për të qartësuar idetë, shfrytëzoj grafikone, vizatime, ilustrime
- Shfrytëzoj teknologjinë për të komunikuar idetë
- Përdor drejt gjuhën e trupit
- Përshtas tonin dhe shpejtësinë e zërit
- Përdor forma artistike për të shprehur idetë ose porositë (shfaqje, instalacione, pantomimë, këngë, video, dramë, ekspozita, etj.)

### Jam këmbëngulës
- Punoj vazhdimisht drejt arritjes së qëllimit
- Nuk dorëzohem lehtë para pengesave dhe dështimeve
- Jam i përqendruar gjatë kryerjes së detyrave
- Insistoj në ruajtjen e vlerave dhe standardeve përballë presioneve

### Zgjidh problemet
- Jam praktik
- Identifikoj dhe kuptoj problemin
- Analizoj shkaktarët e problemit
- Propozoj dhe diskutoj opsione të mundshme për zgjidhje
- Zgjedh opsionin më të mirë të mundshëm
- Vlerësoj ndikimin e zgjidhjes së zbatuar

### Punoj në ekip
- Respektoj secilin në ekip
- Kontribuoj me ide të reja dhe dëgjoj idetë e të tjerëve
- Marr dhe jap komente konstruktive
- Bashkëpunoj me të gjithë në ekip
- Ndihmoj të tjerët në ekip
- Marr përgjegjësitë e mija
- Jam tolerant dhe bëj kompromise për të arritur qëllimet e përbashkëta

### Jam kreativ
- Ofroj ide të reja dhe inovative
- Kombinoj idetë e ndryshme në një ide të re, origjinale dhe unike
- Shfrytëzoj informacione dhe resurse të tjera (kohën, materialet, njerëzit, paratë) në mënyrë efikase
- Përdor elemente artistike gjatë aktiviteteve

### Jam hulumtues
- Mbledh informacione nga burime të ndryshme
- Përdor edhe teknologjinë e informacionit për të hulumtuar
- Vërtetoj burimin, besueshmërinë dhe cilësinë e informacionit
- Analizoj dhe përpunoj informacionin
- Jam i vetëdijshëm se plagjiatura është shkelje

### Kam inteligjencë emocionale
- Jam i matur në shprehjen e emocioneve
- Jam i durueshëm
- Reflektoj për situatat/veprimet
- Ndikoj në qetësimin e situatave
- Pranoj gabimet dhe kërkoj falje
- Bashkëndiej me të tjerët
- Jam i hapur ndaj kritikave

### Kam shpirt ndërmarrësi
- I shndërroj idetë në veprime
- Marr iniciativa
- Marr parasysh rreziqet
- E ndaj vizionin tim dhe frymëzoj të tjerët
- Planifikoj resurset (buxhetin, kohën, ekipin, etj.) për të kryer një aktivitet
- Mësoj nga sukseset, dështimet apo gabimet
- Jam i gatshëm të nis nga fillimi

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

AFTER SCHOOL SUPPORT FOR TEENS

www.asset-ks.org

# KAPITULLI PARË

# FUSHA MËSIMORE JETA DHE PUNA – konceptet themelore

## Përshkrimi dhe konceptet e fushës

Përshkrimi i fushës jeta dhe puna bazohet në dokumentet kurrikulare si Kurrikula Bërthamë (MASHT, 2016), dhe Planet dhe programet lëndore sipas fushës për klasën 10, 11 dhe 12 (MASHT, 2016).

Fusha jeta dhe puna përfshihet në të gjitha nivelet formale te arsimit parauniversitar, respektivisht nëpër të gjitha shkallët kryesore të Kurrikulës së Kosovës dhe përshkruhet si bartëse në zhvillimin gradual të kompetencave për jetë dhe punë (MASHT, 2016.f. 83). Në shkallën kurrikulare 1 dhe 2 fusha jeta dhe puna realizohet në formë të lëndës mësimore "Shkathtësi për jetë", përderisa në shkallën 3 dhe 4 përmes lëndës mësimore "Teknologji me TIK" dhe në shkallën 5 dhe 6 realizohet me fushën mësimore "Jeta dhe puna" duke bërë që kompetencat mësimore të pritura të kësaj fushe të arrihen gradualisht. Fokusi i këtij doracaku është pikërisht fusha "jeta dhe puna" për shkallët kurrikulare 5 dhe 6, përkatësisht klasët 10, 11 dhe 12 te gjimnazet.

Kjo fushë përfshin katër koncepte kryesore:

- Teknologji e Informimit dhe Komunikimit (TIK)
- Ndërrmarrësi dhe Edukim Financiar (NEF)
- Orientim dhe Këshillim në Karrierë (OKK)
- Edukim për Zhvillim të Qëndrueshëm (EZHQ)

Në përshkrimin e koncepteve në këtë doracak jepet ana praktike e zbatimit të kurrikulës duke u bazuar në praktika të mira të mësimdhënies, të realizuara me rastin e trajnimeve në kuadër të programit ASSET.

## Fondi i orëve

Në kuadër të dokumenteve kurrikulare është i përcaktuar fondi i orëve të përgjithshme të fushës, dhe nuk ka ndarje të përcaktuar për konceptet e kësaj fushe. Prandaj, tabelat në vijim paraqesin një ndarje të sugjeruar të numrit të përgjithshëm të fondit të orëve të përcaktuara me kurrikulë, për secilin koncept të fushës. Fondi i propozuar i orëve është orientues dhe së bashku me përshkrimet dhe udhëzimet në këtë doracak kontekstualizojnë kurrikulën nga praktika e mësimdhënësve. Mësimdhënësit mund të planifikojnë ndarje tjetër të fondit të përgjithshëm të orëve, në bazë të interesave aktuale të nxënësve dhe komunitetit, por gjithmonë duke u munduar

që të ruhet një ekuilibër në mes të fondit të orëve për konceptet e ndryshme, për të mundësuar realizimin e plotë të tyre.

*Tabela 1. Ndarje e sugjeruar e fondit të orëve për klasë dhe koncepte* për Gjimnazet Shkencore

| **Konceptet** | | **Teknologji e Informimit dhe Komunikimit (TIK)** | **Ndërrmarrësi dhe Edukim Financiar (NEF)** | **Orientim dhe Këshillim në Karrierë (OKK)** | **Edukim për Zhvillim të Qëndrueshëm (EZHQ)** | **Gjithsej orë** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkalla 5 | Klasa X | 36 orë | 14 orë | 14 orë | 10 orë | 74 orë |
| | Klasa XI | 18 orë | 7 orë | 7 orë | 5 orë | 37 orë |
| Shkalla 6 | Klasa XII | 36 orë | 14 orë | 14 orë | 10 orë | 74 orë |

*Tabela 2 Ndarje e balancuar e fondit te orëve për klasë dhe koncepte* për Gjimnazet Shoqërore

| **Konceptet** | | **Teknologji e Informimit dhe Komunikimit (TIK)** | **Ndërrmarrësi dhe Edukim Financiar (NEF)** | **Orientim dhe Këshillim në Karrierë (OKK)** | **Edukim për Zhvillim të Qëndrueshëm (EZHQ)** | **Gjithsej orë** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkalla V | Klasa X | 36 orë | 14 orë | 14 orë | 10 orë | 74 orë |
| | Klasa XI | 36 orë | 14 orë | 14 orë | 10 orë | 74 orë |
| Shkalla VI | Klasa XII | 18 orë | 7 orë | 7 orë | 5 orë | 37 orë |

## Zbatimi i integruar i koncepteve

Kurrikula e Kosovës sugjeron që të mësuarit në shkolla të organizohet përmes integrimit të dijes. Konceptet e ndryshme të fushës “jeta dhe puna” sugjerohet të integrohen maksimalisht, ashtu që të mos perceptohen të ndara, dhe të kuptohet se secila ka rëndësinë e vet. Praktikat e mira tregojnë që planifikimi për këtë fushë duhet të ketë parasysh renditje logjike të temave të cilat adresojnë njohuritë, shkathtësitë, sjelljet, qëndrimet, vlerat dhe rutinat e nevojshme për të përvetësuar konceptet e kësaj fushe. Po ashtu, sugjerohet bashkërenditje me fushat tjera mësimore, për të integruar mësimin gjatë shkollimit të mesëm të lartë, duke bërë kështu që nxënësit të kuptojnë rolin e kompetencave mësimore dhe ndërlidhjen e tyre. Në këtë mënyrë rritet edhe vetëdija e nxënësve për rëndësinë e TIK, NEF, OKK dhe EZHQ.

Mësimdhënësve u rekomandohet që për secilin koncept të kësaj fushe, në sesionin hyrës të flitet për rolin e tij dhe ndërlidhjen e tyre në mes vete. Sugjerohet që rezultatet mësimore të pritura të analizohen veç e veç, por edhe të krahasohen duke gjetur pikat ndërlidhëse, të cilat do të mund

të integronin njohurinë dhe të konkretizoheshin në zbatim. Për shembull, RNF-të që kanë të bëjnë me kuptimin e punës praktike në shtëpi, shkollë dhe punë, si dhe ngritjen e cilësisë personale për jetë dhe punë të zbatohen dhe integrohen mjaftueshëm, duke bërë që konceptet, programet apo gjuhët programuese të mësohen duke ndërlidhur përdorimin e tyre në shkollë dhe jetë, dhe jo të mësohen vetëm teknikisht dhe mekanikisht.

Në këtë doracak, është synuar të jepen shembuj se si bëhet kjo ndërlidhje duke ofruar më shumë tema në formë të projekteve, punës praktike dhe kreative, të përcjellura me metoda të përshtatshme të vlerësimit. Derisa në klasën e 10 dhe 11 përqendrimi është në të mësuarit e koncepteve themelore të fushës dhe ndërlidhjes së tyre në mes vete, ndërsa në klasën e 12 mbetet vend për më shumë orë për për kërkim, hulumtim, përgatitje dhe aplikim në universitete dhe në punë. Nëse orët që janë në dispozicion në orarin e rregullt shkollor për fushën "jeta dhe puna" nuk mjaftojnë për të realizuar të priturat nga këshillimi dhe orientitmi në karrierë, dhe nga edukimi për ndërmarrësi, atëherë sugjerohet që të organizohen sesione shtesë në kuadër të klubeve të karrierës ose aktiviteteve jashtëkurrikulare, me tendencën që të përfshihen sa më shumë nxënës. Ngjashëm, të praktikuarit e TIK-ut dhe koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm mund të aplikohen në klubin e teknikëve ose me projektet tjera mësimore në shkollë.

Aktivitetet jashtëkurrikulare të planifikuara mirë, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave mësimore të nxënësve dhe shkathtësitë për jetë dhe punë, janë pa aq të rëndësishme sa fushat/lëndët mësimore të organizuara në kuadër të orarit të rregullt mësimor. Disa nga aktivitetet jashtëkurrikulare të cilat mund të zhvillohen për të mbështetur nxënësit në kuadër të fushës "jeta dhe puna" janë:

- Organizimi i ditës së dyerve të hapura
- Java e karrierës
- Panairi i Punës
- Takimet me profesionistë
- Testimet
- Hulumtimet
- Praktikat
- Vizita në biznese
- Sfida e Dizajnit
- Rregullimi ose gjelbërimi i shkollës
- Zgjidhjet teknologjike si websajti, reklama e shkollës, etj.

Mësimdhënësit e fushës "jeta dhe puna" janë liderë të aplikimit të teknologjisë, prandaj ata mund të jenë liderë edhe në aplikimin e teknologjisë për komunikim në mësimdhënie dhe realizim të projekteve të ndryshme mësimore. Teknologjia mësimore është një ndërmarrje e planifikuar e mësimdhënësit, veprim intelektual i orientuar në sigurimin e cilësisë në mësim dhe aktualizimin e tij. Sipas karakteristikave që mbart, teknologjia mësimore imponohet në çdo kohë e në të gjitha etapat e procesit të komunikimit gjatë mësimdhënies. Ajo konsiderohet e pazëvendësueshme në organizimin bashkëkohor të mësimdhënies, duke u shtrirë në çdo segment të mësimit. Përmes saj, nxënësit vihen në pozita aktive, ndërsa mësimdhënësit bëhen koordinatorë, ndihmës, udhëzues, motivues dhe nxitës gjatë procesit mësimor. Mënyra e drejtë e përdorimit të teknologjisë mësimore garanton suksesin në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Mësimdhënësit e fushës “jeta dhe puna” kanë përgjegjësinë që nxënësve të zgjojnë dhe zhvillojnë shpirtin ndërmarrës te nxënësit. Prandaj, është e rëndësishme që konceptet e ndërmarrësisë të realizohen drejtë dhe plotësisht me nxënës, duke u mësuar se si krijohen vlerat, menaxhohet koha, si gjenden mundësitë e ndryshme në treg të punës, dhe përfundimisht duke u mësuar atyre se si mund krijohet një ndërmarrje. Poashtu, në këtë fushë duhet të realizohen me kujdes konceptet e informimit, këshillimit dhe orientimit në karrierë të nxënësve. Konceptet e orientimit në karrierë në këtë doracak adresohen përmes shpjegimit të kuptimit dhe rëndësisë së tyre, e poashtu edhe me shembuj të modeleve të përzgjedhura të planeve mësimore të realizuara nga mësimdhënës të ndryshëm. Dhe, në fund, konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm përqënderohen në edukimin drejt plotësimit të nevojave për kërkesat për jetë të gjeneratave të ardhshme. Këtu ndërlidhet ekonomia, shoqëria, mjedisi dhe ndërvarësia e tyre.



Foto nga puna e nxënësve në hapësirën krijuese në shkollën Xhevdet Doda në Prishtinë

# KAPITULLI DYTË

# TEKNOLOGJI E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK)

Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK) ka të bëjë me shfrytëzimin e kompjuterëve si një mjet ndihmës për krijimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave ne procesin e mësimdhënies dhe te nxënit. Teknologjia ka zhvillim të shpejtë dhe ndikim të madh në jetën tonë. Këtyre zhvillimeve të shpejta duhet t'u përgjigjemi edhe ne, që pastaj t'u përgjigjemi kërkesave të punës dhe zhvillimit në përgjithësi. TIK do të ndryshojë vazhdimisht duke u përditësuar, që të jetë më i përshtatshëm dhe më i lehtë i përdorshëm për njeriun. TIK u ofron mbështetje nxënësve në zhvillimin e personalitetit, për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe u ndihmon në përgatitjen e tyre për të përvetësuar veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me TIK-un. Nxënësit përvetësojnë shkathtësi të përdorimit të TIK-ut për gjetjen, zhvillimin, analizën dhe prezantimin e informacioneve, si dhe të modeleve për zgjidhjen e problemeve në situata të caktuara.

Aktivitetet kryesore në lëndën e TIK-ut përfshijnë mësimin e koncepteve dhe te nxënit, përdorimin e aplikacioneve të ndryshme, punën me pajisje te ndryshme harduerike, krijimin e produkteve softuerike dhe aplikimin e këtyre aftësive në jetën e përditshme, etj. Ato gjithashtu përfshijnë edhe sistemet e avancuara që mundësojnë grumbullimin, organizimin, ruajtjen, përdorimin dhe transmetimin e informacioneve në forma të ndryshme.

## Programet e TIK-ut dhe rëndësia e tyre

Nëpërmjet TIK-ut, nxënësit krijojnë shprehi dhe shkathtësi gjatë punës teorike dhe praktike për kërkim të pavarur të informacioneve nga të gjitha fushat kurrikulare. Për këtë arsye, përveç programeve të reja, paketa e Microsoft që përmban Word, Excel, PowerPoint, etj., duhet të përforcohet dhe zotërohet si mjet për të bërë detyra, prezantime dhe projekte tjera, në shkollë e më vonë edhe në studime dhe punë. Përdorimi efikas i këtyre programeve është shkathtësi që i duhet çdo të punësuari kudo në botë.

### Programi për përpunimin e teksteve / WORD

Programi Word është njëri ndër programet më të popullarizuara për përpunimin e teksteve. Përdoret në të gjitha profesionet, prandaj sot nuk mund të paramendohet puna e një zyrtari, gjuhëtari, gazetari, mjeku ose menaxheri pa njohjen e programit Word. Në shkollën e mesme, nxënësit duhet ta përjetojnë si pjesë të përvojës së tyre arsimore. Nëse Word nuk përdoret për të shkruar ese, projekte dhe detyra tjera, atëherë mund të themi se nuk është duke u përdorur mjeti të cilin nxënësit e kanë në dispozicion. Edhe nëse nxënësit mund të mos kenë kompjuter në shtëpi, duhet të inkurajohet përdorimi i kabineteve dhe bibliotekave apo edhe bashkëpunimi mes

nxënësve. Kështu që varësisht nga kushtet, mësimdhënësit mund të caktojnë numrin e detyrave që dërgohen me shkrim duke përdorur Word.

Duke përdorur programin Word, nxënësit zhvillojnë shkathtësitë gjuhësore, krijojnë tekste në formate të ndryshme si prozë, poezi, dramë, pamflet, referat, katalog, pyetësor, test, etj.. Po ashtu, ata mund të shprehin kreativitetin duke vendosur fotografi, figura dhe grafikone si dhe të shtypin ato. Përveç kësaj, nxënësit mund të dërgojnë detyrën me email, apo ta dorëzojnë në ndonjë platformë, dhe kështu mësimdhënësit të menaxhojnë më mirë kohën e tyre dhe të japin këshilla dhe rekomandime drejt në dokument.

## Programi aplikativ për përpunimin tabelar dhe grafik të të dhënave / Excel

Excel është një program aplikativ për organizim, llogaritje, grumbullim dhe prezantim të të dhënave. Excel-i ofron mundësinë e organizimit dhe menaxhimit të të dhënave të ndryshme në formë tabelare. Excel, përveç që është programi më i përdorur në industri të ndryshme, ai bashkëvepron edhe me programet edhe sistemet e tjera të avancuara. Excel ofron edhe shumë funksione dhe formula, të cilat përdoren për kalkulimin e të dhënave dhe analizën e tyre. Edhe pse atributi më i rëndësishëm i Excel-it është kryerja e kalkulimeve të ndryshme, fuqia e Excel-it qëndron në fleksibilitetin që u ofron shfrytëzuesve në definimin e strukturës së të dhënave dhe paraqitjen grafike të tyre. Excel shfrytëzohet ndonjëherë për të ruajtur një listë të thjeshtë, ndonjëherë për t'i ruajtur harxhimet familjare, e ndonjëherë për të bërë edhe bilance mjaft komplekse për ndonjë kompani. Excel përdoret edhe për aktivitete që ndërlidhen me financa dhe punë të tjera si:

- **Përpunimi i numrave:** Krijimi i raporteve financiare, krijimi i buxheteve, analiza i rezultateve të anketimeve dhe kryerja e çfarëdo analize financiare.
- **Organizimi i listave:** Bën ruajtjen efektive të listave duke shfrytëzuar rreshtat dhe shtyllat e tabelave.
- **Qasja tek të dhënat tjera:** Mundeson importimin e të dhënave nga burimet tjera dhe
- **Krijimi i diagrameve:** Mundëson krijimin e një numri të madh të diagrameve.

## Programi aplikativ për përgatitjen e prezantimeve / PowerPoint

Programi tjetër që nxënësit marrin njohuri në klasën e dhjetë është programi PowerPoint. Në ditët e sotme, çdo projekt, planifikim, plan biznesi ose parashikime tjera, nuk mund të mendohen edhe pa anën prezantuese të tyre. Prezantimi paraqet përgatitjen dhe organizimin e informacioneve me qëllim të paraqitjes së tyre nëpërmjet pajisjeve elektronike, në formë të sllajdeve të renditura, me përmbajtje nga të gjitha fushat e veprimtarisë intelektuale. Prezantimet shpjegohen gojarisht, mirëpo ana vizuale e rregulluar është e pazëvendësueshme për shpjegim më të mirë. Programi PowerPoint i paketës Microsoft Office përdoret për përgatitjen e prezantimeve të cilat paraqitën nëpërmjet pajisjeve elektronike në formë të prezantimeve elektronike nëpër institucione shkollore, institucione të biznesit, ose të tjera. Programi PowerPoint e ka mundësinë e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me programet e tjera të Office, siç janë: Word, Excel etj. Madje, nëse

kemi krijuar ndonjë zëvendësim automatik në word ose Excel ai do të bartet në mënyrë automatike edhe në PowerPoint. Natyra e programit është e ngjashme me programet tjera të Office dhe një pjesë e madhe e detyrave në këtë program kryhet plotësisht njëlloj, si edhe në programet e mëparshme. Përmes PowerPoint lehtësohet procedura e organizimit të informatave në sllajde, me qëllim të prezantimit të tyre sa më të mirë.

## Multimedia, sekuencat multimediale

Multimedia është përmbajtje që përdor kombinimin e formave të ndryshme të elementeve siç janë: teksti, zëri, fotografitë, animacionet, videot dhe përmbajtje interaktive me qëllim komunikimi. Multimedia mund të jetë edhe interaktive atëherë kur i lejon njerëzit të formojnë komanda në kompjuter, siç janë video lojërat.

Multimedia paraqet bashkimin e dy fjalëve që janë “multi” dhe “medium”, andaj multimedia mund të përkufizohet si medie e shumëfishtë që shërben për të dhënë informacione në formë digjitale te shfrytëzuesi. Multimedia është një fushë me kontrollim kompjuterik të tekstit, animacionit, grafikës, zërit (audios), videos, fotografive dhe formave të tjera të medies, që paraqet, regjistron, transmeton, dhe përpunon të gjitha informacionet në formë digjitale.

Prezantimet mund të përfshijnë klipin audio dhe video ose animacion. Përmbajtja e tillë e prezantimeve ndikon pozitivisht në audiencë, sepse me ndihmën e klipeve audio dhe video prezantuesi paraqet mirë, ndërsa shikuesi mund të kuptojë lehtë përmbajtjen e prezantimit.
Llojet aktuale të kompjuterëve shfrytëzohen edhe për paraqitje të sekuencave multimediale. Sekuencat e tilla dizajnohen me kombinimin e materialeve multimediale, përkatësisht të teksteve, grafikës, videos, zërit dhe animacioneve. Ekzistojnë softuerë edukativë që përfshijnë tekstin, audion, videon dhe animacionin e të cilët quhen softuerë të multimedies. Për dizajnimin e sekuencave multimediale shfrytëzohen programe përkatëse. Windows Movie Maker, Video Editor, Wondershare Filmora, Adobe Premiere, etj.

Fushat e aplikimit të multimedies janë: Biznesi, shitjet ose prezantimet e marketingut, prezantimi i një prodhimi për treg, arsimi, simulimet, E-learning/Distance learning, argëtimi, televizioni, telefonat celularë, vendet publike etj.

## Interneti dhe Komunikimi

Me zhvillimin e teknologjisë u zhvillua edhe interneti i cili ka bërë që komunikimi të jetë më i lehtë. Interneti është një bashkësi e miliona rrjeteve lokale të lidhura ndër vete, duke krijuar kështu rrjetin global të komunikimit. Ai lidh miliona kompjuterë nga i gjithë globi duke formuar një rrjet të tillë përmes të cilit secili kompjuter mund të komunikojë me kompjuterin tjetër kudo në botë, me kusht që të dy të jenë të lidhur në internet. Nxënësit mësojnë përdorimin e internetit duke zhvilluar aktivitete të ndryshme për arritjen e kompetencave dhe rezultateve të lëndës. Gjithashtu nxënësit mësojnë për shërbimet e internetit, navigimin dhe kërkimin e informacioneve përmes motorëve të kërkimit në internet.

Interneti mund të shfrytëzohet edhe për komunikim. Komunikimi mund të bëhet me mjete dhe forma të ndryshme. Njëri ndër shërbimet kryesore të internetit që përdoret për komunikim ndërmjet njerëzve, është komunikimi nëpërmjet postës elektronike. Posta elektronike, ose siç njihet tashmë si E-mail, mundëson shkëmbimin e të dhënave në formë elektronike, do të thotë përmes kompjuterëve. Ky shërbim është shumë i shpejtë dhe i saktë. Përveç e-mailit ekzistojnë edhe komunikime të tjera elektronike si: Instant Mesaging (IM), VoIP (Voice over Internet Protocol), SMS (Short Message Service), IRC (Internet relay chat), forumet, blogjet, portalet e internetit, etj.

## Navigimi në internet

Shfletimi i internetit bëhet përmes shfletuesve "browser" si Google Chrome, Microsoft Edge, Mozilla Firefox, Safari, Opera, etj. Kërkimi i informacioneve në internet është njëri ndër aktivitetet më të shpeshta që bëjnë përdoruesit e internetit. Për nxënësit, është shumë me rëndësi si të kërkojnë informacionin, dhe si të vlerësojnë informacionin. Në kohën kur keqinformimi është bërë pjesë e manipulimit, krijimi i shprehive për të gjetur informacion të verifikueshëm është tejet me rëndësi. Në rastet kur dëshirojmë kërkim më specifik për të arritur deri te rezultati i kërkuar mund t'i përdorim edhe operatorët e motorëve të kërkimit që janë karaktere dhe komanda speciale që zgjerojnë aftësitë e kërkimeve të rregullta të tekstit. Kërkimi në internet, ndihmon në gjetjen e materialeve shtesë për mësime. Është shumë me rëndësi që nxënësit të mësojnë se nëse gjejnë materialin, së pari duhet të shënojnë burimin dhe mos të kopjojnë tekstin për të paraqitur detyrën e vet, por ta shfrytëzojnë atë si informacion.

## Programi aplikativ për bazat e të dhënave (ACCESS)

Bazat e të dhënave paraqesin grumbull të organizuar të dhënash. Nga ky grumbull i organizuar mirë i të dhënave, mund të nxirren dhe të paraqiten pothuajse çfarëdo të dhëna të pjesshme. Meqenëse puna me të dhëna, që janë të organizuara në bazë të të dhënave, është shumë e përshtatshme dhe me shumë interes, krijimi dhe menaxhimi i bazave është domosdoshmëri e kohës. Nuk ka kompani, komunë, institucion shkollor, mjekësor ose financiar, që nuk do të kishte nevojë t'i ruante të dhënat e veta në një bazë të dhënash.

Për krijimin dhe shfrytëzimin e bazës me të dhëna përdoren sisteme të menaxhimit të të dhënave siç është: Access, Oracle, SQL server etj. Përmes sistemeve të tilla, bazës mund t'i shtohen të dhëna, pastaj të dhënat e saj mund të modifikohen, ose edhe të fshihen. Pastaj mund të shtrohen pyetje (query) lidhur me të dhënat e përfshira në bazë, si dhe të jepen raporte me të dhëna të ndryshme të saj. Nxënësit mësojnë të planifikojnë dhe të krijojnë baza të të dhënave nëpërmjet programit Access. Së pari mësojnë për tabelat të cilat janë objekti kryesor i bazës së të dhënave sepse brenda tyre vendosen të dhënat, gjithashtu nxënësit mësojnë për pyetësorët, formularët, raportet dhe makrot. Nxënësit duke i mësuar këto objekte të bazës së të dhënave do të jenë në gjendje të dizajnojnë baza të të dhënave dhe t'i menaxhojnë të dhënat në mënyrë të pavarur.

## Algoritmet dhe gjuha programuese JAVA

Algoritmet janë grumbulli i veprimeve me një radhë të fiksuar, të cilët ndërmerren gjatë zgjidhjes së një problemi të caktuar. Algoritmet në programim shërbejnë si funksione të cilat e bëjnë programin efikas.[1] Nxënësit do të mësojnë për krijimin e algoritmeve përkatëse për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, dhe t'i praktikojnë ato gjatë mësimit të gjuhës programore Java. Nxënësit mësojnë se si të përdorin gjuhën programuese Java për të ndërtuar softuerë, që është edhe fillimi i një edukimi si programues të ardhshëm.

JAVA si gjuhë programuese e orientuar në objekte është një nga gjuhët më të përdorura në fushën e zhvillimit të softuerit. Programet në Java krijohen përmes përdorimit të ndonjë editori teksti (p.sh. Notepad, etj) apo ndonjë mjedisi të integruar për zhvillim IDE (p.sh. NetBeans, Eclipse etj) dhe ruhen me ekstensionin java. Mësimdhënësit mund të përdorin llojin të cilin e kanë përdorur më shumë dhe që është i hapur për të lehtësuar qasjen e nxënësve.
Nevojat e industrisë për ta përdorur Java si gjuhë programuese janë relativisht të mëdha. Gjithashtu, gjuha programuese Java mësohet nga nxënësit që të arrijnë t'i kuptojnë konceptet themelore të programimit dhe të përgatiten për tregun e punës. Java është një nga gjuhët programuese më të popullarizuara e cila ka një sintaksë të thjeshtë e të lexueshme, është e lehtë për t'u mësuar dhe e orientuar në objekte. Java mund të aplikohet për zhvillimin e desktop dhe ueb aplikacioneve. Java gjithashtu përdoret për të krijuar aplikacione Android, për të krijuar ueb faqe në internet duke i përpiluar me JavaScript etj.

# Mësimi praktik i programeve kompjuterike dhe gjuhëve programuese

Mësimi i bazuar në projekte në shekullin e fundit është dëshmuar që jep një numër përfitimesh për nxënësit, duke filluar nga të mësuarit më të thellë të përmbajtjes akademike me një motivim më të fortë për të mësuar. Duke parë në mënyrë specifike se si puna e bazuar në projekte mbështet rezultatet e të mësuarit të shekullit XXI në zotërimin e përmbajtjes së rëndësishme akademike, e cila është themeli i çdo projekti të planifikuar mirë. Puna e bazuar në projekte ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi për të jetuar në një bazë të njohurive dhe shoqërisë së lartë teknologjike. Modeli i shkollës tradicionale e cila na ka dhënë rezultate të fakteve të mësimit pasiv dhe recitimit të tyre nga konteksti nuk është më i mjaftueshëm për t'i përgatitur nxënësit për të mbijetuar në botën e sotme. Zgjidhja e problemeve më komplekse kërkon që nxënësit të zotërojnë aftësitë themelore (lexim, shkrim dhe matematikë) si dhe shkathtësitë e shekullit XXI (të menduarit kritik e kreativ, puna ekipore, zgjidhja e problemeve, grumbullimi i hulumtimeve, menaxhimi i kohës, sintetizimi i informacionit dhe shfrytëzimi i mjeteve të teknologjisë së lartë). Me këtë kombinim të njohurive e shkathtësive, nxënësit bëhen të zotë dhe menaxherë të procesit të tyre të të mësuarit. Mësimi praktik i programeve dhe gjuhëve programuese sugjerohet të bëhet përmes rasteve konkrete dhe projekteve. Në këtë rast, mësimdhënësit mund të zgjedhin tema nga konceptet e ndryshme të fushës jeta dhe puna për të realizuar gjëra praktike. Si orientim, në këtë doracak janë paraqitur

[1] Christensson, P. (2013, August 2). *Algorithm Definition*. Retrieved 2021, Apr 22, from https://techterms.com

disa projekte për mësimin e programeve dhe gjuhëve programuese. Për shembull, është sugjeruar që të ndërlidhet krijimi i shitores, stoqeve dhe analiza e shitjeve përmes Excel. Ose për shembull, përdorimi i PowerPoint dhe multi media realizohet duke bërë prezantime të ideve të bizneseve dhe reklamën e shitores. Ngjashëm krijohen konceptet e e-commerce dhe prezantimi në web përmes webfaqeve.

Ngjashëm, kur nxënësit mësojnë një gjuhë programuese si Java, duhet të kuptojnë se kjo gjuhë përdoret pothuajse në të gjitha aplikacionet që ata përdorin. Poashtu, mund të paraprijë mësimin e gjuhëve tjera si C, C♯ dhe C++. Përveç motivimit për të mësuar kodimin, mësimi praktik kërkon kontekstualizimin dhe përdorimin e burimeve ku nxënësit mund të testojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre. Për shembull: https://www.w3schools.com/java.




Foto nga procesi i trajnimit të mësimdhënësve të Gjilanit për ndërmarrësi dhe edukim financiar

# KAPITULLI TRETË

# NDËRMARRËSIA DHE EDUKIMI FINANCIAR (NEF)

Ndërmarrësia është proces i krijimit të gjërave të reja me vlerë, duke përkushtuar kohën, burimet, dhe duke supozuar rrezikun për të krijuar mundësi të reja në treg. Rrjedhimisht, "ndërmarrës" është personi që krijon ndërmarrjen e re duke u ballafaquar me rrezik dhe pasiguri, për të arritur profitin e dëshiruar duke identifikuar mundësitë e reja dhe duke angazhuar burime". Zhvillimi i shkathtësive për punësim dhe ndërmarrësi, që synohet përmes kësaj fushe, krijon një botëkuptim pozitiv për të ardhmen e të rinjëve. Kuptimi i konceptit të ndërrmarrësisë shpien drejt ngritjes së vetëdijes për ata që aspirojnë të jenë ndërrmarrës, krijimit të kushteve më të mira për ndërmarrës si dhe zhvillimit të njohurive në këtë drejtim. Procesi i zhvillimit të ndërrmarrjes është proces analitik dhe kreativ që përfshin identifikimin e mundësive (brainstorming, fokus grupe, rrjetëzim), vlerësimin e mundësive (hartimi i biznes planit) dhe zbatimin e planit të biznesit. Ky proces karakterizohet me veprim të vazhdueshëm, sepse motivimi i ndërmarrësit për të krijuar punë nuk varet nga punëdhënësi, por nga vet ndërmarrësi.

Është e rëndësishme për nxënësit që të kuptojnë që pavarësisht se çfarë karriere zgjedhin, secili ka një rol në botën e punës, dhe se zhvillimi dhe demonstrimi i aftësive të ndërmarrësisë dhe inovacionit rrit produktivitetin personal dhe shoqëror. Për mësimdhënësit e gjimnazeve mund të duket se krijimi i ndërrmarrjeve virtuale në shkollë është shumë kërkues, por qëllimi i këtij procesi është të shfrytëzojnë mjete interaktive që ndihmon provokimin e të menduarit si ndërmarrës tek të rinjtë (lojërat, puna në terren, diskutimet, prezantimet), dhe të aplikojnë raste të studimit apo video gjatë mësimit të ndërmarrësisë, të nxisin kreativitetin dhe zgjidhjen e problemeve përmes projekteve në ndërmarrësi, të përdorin metoda të thjeshta për të mësuar rreth pritjeve të klientëve për produktet apo shërbimet e ofruara në ndërmarrësi, dhe të aplikojnë plane të thjeshta financiare.

Ndërrmarrësia dhe edukimi financiar nuk mund të mësohen duke riprodhuar tekstet, por duke angazhuar nxënësit në mënyrë kreative përmes njësive mësimore në formë të punëtorisë, duke krijuar grupe dhe duke sfiduar ata të vijnë me ide dhe zgjidhje. Në këtë udhëzues, janë dhënë shembuj konkret dhe praktik të realizimit të disa njësive mësimore që zhvillojnë konceptet kryesore të ndërmarrësisë.

## Përfitimet nga ndërmarrësia

Ndërmarrësit konsiderohen si shpikës që dalin me ide të reja për produktet, tregjet ose teknikat e tyre. Pra, një ndërmarrës është personi i cili percepton mundësi, organizon burimet e nevojshme për ta shfrytëzuar këtë mundësi dhe në fund e shfrytëzon atë. Pajisjet kompjuterike, telefonat e

mençur, makinat e ndryshme, ATM të bankave, kartat e kreditit, shërbimet postare dhe shërbimet e tjera janë të gjithë shembujt të ideve ndërmarrëse të cilat u konvertuan në produkte apo shërbime.

Disa nga përfitimet socio-ekonomike nga edukimi për ndërmarrësi janë:

- Krijimi i mundësive për punësim apo vetëpunësim. Ekzistenca e aktiviteteve të biznesit ndikon te punësimi. Bizneset e themeluara kanë nevojë për njerëz që të punojnë për ta.
- Përmirësimi i cilësisë së jetës. Njerëzit kanë nevojë të punojnë për të mbijetuar, për të plotësuar nevojat e tyre dhe për të kënaqur dëshirat e tyre.
- Shpërndarja e barabartë e të ardhurave. Sa më shumë aktivitete ndërmarrëse të ketë në një zonë të caktuar, sidomos në fshatra, aq më shumë banorët e këtyre zonave kanë mundësi të punësohen aty duke shmangur kështu largimin e tyre në vende të tjera.
- Përdorimi i burimeve. Ne mund të përdorim, t'i përpunojmë dhe t'i shndërrojmë burimet tona natyrore për gjëra më të dobishme.
- Përfitimet sociale përmes qeverisjes. Burimet e mbledhura nga qeveria kthehen përsëri në dobi të njerëzve në formën e shërbimeve, projekteve të infrastrukturës, objekteve shkollore dhe ruajtjes së rendit dhe qetësisë.
- Përfitimet tek të rinjtë. Të rinjtë kanë lirinë e organizimit të kohës dhe angazhimit në punë kreative.

Kur shpjegohet ndërrmarrësia, dallimi kryesor mes ndërmarrësit dhe punëtorit, është orari, kërkesa për investime dhe rreziku. Përderisa një punëtorë në një ndërmarrje mund të ketë një orar të rregullt, punë specifike dhe page fikse, prej tij ose saj nuk kërkohet të investojë apo të ndërmarrë rreziqe. Ndërmarrësit, në anën tjetër edhe pse kanë liri të organizojë kohë, përgjegjësia e tyre është e gjithanshme dhe tejkalon punët specifike. Po ashtu ndërmarrësit duhet të investojnë dhe rrezikojnë paratë e veta me planin për të kthyer ato me punë të suksesshme.

Mësimdhënësit shpjegojnë konceptin e ndërmarrësisë përmes modelimit të një ideje të biznesit. Metoda e punës bazohet në përdorimin e rasteve të studimit, punës në terren, lojraveve interaktive si dhe prezantime të moderuara. Duke e ditur se konceptet kryesore të të mësuarit janë krijimi i idesë, planifikimi i biznesit, administrimi, marketingu, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i projekteve nxënësit zhvillojnë shkathtësitë e analizës, mendimit kritik, hulumtimit, argumentimit, prezantimit dhe punës në grupe. Njësitë mësimore në ndërrmarrësi realizohen përmes shtrirjes dhe ndarjes së aktiviteteve dhe nëpër punëtori të ndryshme, ndërmjet të cilave duhet të caktohet një periudhë me ç'rast nxënësit do të punojnë individualisht apo në grup rreth detyrave që do të ju epen.

Në këtë doracak janë dhënë disa metoda konkrete të realizimit të konceptit si krijimi i idesë, analiza e tregut, modeli biznesit canvas, të bërit biznes/tregti dhe prezantimi biznesit.

## Krijimi i Vlerave/ Krijimi i idesë

Për krijimin e një ndërmarrjeje kërkohet ndonjë ide e cila krijon vlerë. Mësimdhënësit, në fazën e krijimit të ideve, stimulojnë kreativitetin e nxënësve. Nga ta mund të kërkohet të mendojnë për

ndonjë ide që do të plotësojë nevojat e njerëzve. Për krijimin e ideve, sugjerohet teknika e krijimit të ideve duke përdorur hapat në vijim:

Hapi 1: Përgatituni për zbulimin e ideve
Hapi 2: Merrni shënim për çdo stuhi mendimesh, ide apo mundësi
Hapi 3: Shikojeni botën në mënyrë tjetër
Hapi 4: Shikoni drejt të ardhmes – Vizioni
Hapi 5: Mendoni çka do të dëshironi të bëni
Hapi 6: Zgjidhni disa nga idetë më të përshtatshme
Hapi 7: Krahasoni rrezikun dhe shpërblimin
Hapi 8: Dëgjoni intuitën
Hapi 9: Zgjidhni idenë më të mirë dhe më të përshtatshme

## Modeli i Biznesit CANVAS

Modeli Canvas është një model biznesi me një teknikë dhe praktikë inovative që përfshin një model biznesi më të gjerë, me një prezantim të shkurtër dhe shumë të kuptueshëm, dhe shërben si një udhëzues për procesin e zhvillimit të strategjisë së ndërmarrjes. Mësimdhënësit duhet të njihen mirë me Modelin Canvas dhe të fusin në praktikë përdorimin e tij, pastaj të shpjegojnë se si të përdoren komponentët kryesorë të këtij modeli dhe si të procesohet kjo gjatë mësimdhënies dhe praktikave me nxënës. Elementet kryesore të modelit janë: partnerët kryesorë, aktivitetet kryesore, burimet kryesore, vlera e ofruar, segmentet e klientëve, marrëdhëniet me klientët, shpërndarja (kanalet), struktura e kostove, dhe të hyrat.




*Modeli i Biznesit Canvas*

Elementet kryesore të modelit mund të shpjegohen shkurtimisht si në vijim:

- Segmentimi i tregut nënkupton definimin e grupeve të ndryshme të klientëve.
- Vlera e ofruar përshkruan produktet dhe shërbimet, të cilat për klientë të caktuar përbëjnë/krijojnë vlerë. Në këtë komponentë mundohemi të gjejmë se cilat probleme të klientëve do të mund të zgjidhen përmes idesë dhe cilat janë nevojat e klientëve.
- Kanalet nënkuptojnë rrugët që përdor një ndërmarrje, për të arritur/kontaktuar klientët me qëllim te transmetimit të vlerës.
- Marrëdhëniet me klientin ndërlidhen me segmentimin ku përcaktohen grupet për të cilët krijohet vlera, karakteristikat e tyre dhe përcaktimi i klientëve më të rëndësishëm.
- Të hyrat janë të ardhurat që ndërmarrja synon të arrijë përmes segmentimit të klientëve. Këtu definohet vlera për të cilën klientët janë të gatshëm për të paguar dhe mënyra e preferuar e pagesës së tyre.
- Burimet kryesore janë asetet themelore që janë të nevojshme për funksionimin e një modeli biznesi.
- Aktivitetet kryesore janë aktivitetet kryesore, që një ndërmarrje duhet të ndërmarrë me qëllim që modeli i biznesit të funksionojë.
- Partnerët kryesorë janë partnerët dhe furnizuesit cilët kontribuojnë në arritjen e suksesit të modelit të biznesit, që mundësojnë të sigurohen burimet dhe minimizohen rreziqet.
- Struktura e kostove përshkruan të gjitha kostot të cilat krijohen gjatë zbatimit të modelit të biznesit duke i specifikuar kostot më të rëndësishme dhe më të larta për secilin aktivitet.

Nxënësit duhet të arrijnë të shpjegojnë edhe operacionet ditore të biznesit, lokacionin, pajisjet, njerëzit dhe proceset gjatë planifikimit të tyre. Metodat për përpunimin e Planit Canvas janë: puna në grup, prezantimi, pyetjet dhe diskutimi. Çdo grup do të prezantojë Biznes Planin Canvas dhe grupet tjera do të bëjnë vlerësim dhe diskutim për punën e grupit që prezanton.

## Shembuj të themelimit të ndërmarrjeve dhe reflektimi

Për të zhvilluar shpirtin ndërmarrës dhe për të kuptuar më lehtë konceptet e ndërmarrësisë, sipas këtij programi, nxënësit udhëhiqen që të kalojnë nëpër përvojën e themelimit të ndërmarrjes për qëllime ushtrimi, d.m.th., në fund të kësaj pjese ata pritet të themelojnë ndërmarrjen virtuale. Gjatë këtij procesi, mësimdhënësi është mentor dhe udhëzues nëpër hapat e krijimit të ndërmarrjes. Për nxënësit është me rëndësi të kuptojnë kontekstin e ndërmarrjes dhe shkathtësitë ndërmarrëse, shkathtësitë e bindjes, shkathtësitë për të zgjidhur probleme, punën ekipore, argumentimin, menaxhimin e rrezikut, marrjen dhe përpunimin e informacioneve, të menduarit kreativ, si dhe përpikërinë dhe qëndrueshmërinë. Nga mësimdhënësi shpjegohet rëndësia e shkathtësive të komunikimit si dhe llojet e komunikimit me klientë. Nga nxënësit pritet që të bëjnë analizë dhe reflektim individual në lidhje më atë se çka mund të bëjnë dhe si të zhvillojnë shkathtësitë e tyre, si dhe ku dëshirojnë të arrijnë. Preferohet që mësimdhënësit, nëse kanë mundësi, të dërgojnë nxënësit në vizita të ndonjë ndërmarrjeje, të shikojnë video-filma për ndërmarrje, apo të ftojnë ndonjë ndërmarrës si vizitor në klasë, që të bisedojnë lidhur me bizneset e tyre. Po ashtu, nëse në shkollë funksionin klubi i karrierës ose zyra e karrierës, nxënësit mund

të aplikojnë për punë praktike në ndërmarrje dhe të kuptojnë më mirë se si funksionon një ndërmarrje.

Në vazhdim kemi prezantuar punën e nxënësve duke punuar Modelin e Biznesit Canvas në klasë dhe një nxënës duke ushtruar praktikën në një biznes “AgroGroup Fauna” në qytetin e Gjilanit.



Nxënësit duke punuar në modelin e biznesit

## Të bërit biznes dhe konteksti i tregut

Lidhja me situata që përjetohen përditë dhe të cilat reflektohen nga të rinjtë duhet të përjetohen përmes ushtrimeve të ndryshme. Këto ushtrime tregojnë edhe se cilat janë efektet që mund të krijohen përmes tregëtisë, se si burimet janë të shpërndara në mënyrë jo të njëjtë, dhe se jo secili mund të marrë pjesë në tregti. Segmentimi i tregut, kërkimi i marketingut dhe parashikimi i shitjeve janë pjesë integrale të asaj që quhet analizë tregu. Aktivitetet që lidhen me produktin, çmimin, reklamimin dhe shpërndarjen kombinohen për të formuar miksin e marketingut.

Shpesh termi treg i referohet një vendi ku realizohet blerja dhe shitja. Por koncepti më i drejtë për tregun është se tregu përfshin një grup klientësh aktualë apo klientësh të mundshëm të cilët kanë fuqi blerëse si dhe nevoja të paplotësuara. Nëpër pjesë të ndryshme apo hapa që merren gjatë ndërmarrësisë sqarohen se si duhet bërë planifikimi, struktura e organizimit, korniza kohore, qëllimet, parashikimi i kostove, marketingu i projektit dhe përfundimi i projektit. Kompetencat e fituara nga aktivitetet ndërmarrëse me nxënës kanë të bëjnë me procesin e marrjes së vendimit

në grup, krijimin e strategjisë dhe marrjen e vendimeve si dhe dallimin e niveleve të ndryshme të rreziqeve.




Vizualizimi dhe paraqitja me anë të videove e rasteve të suksesit në praktikë është shumë me rëndësi tek ndërmarrësit e rinj për arsye se ata mësojnë praktika të reja dhe inovative për bërje të biznesit. Gjithashtu mësimdhënësit duhet të bëjnë analizë personale dhe reflektim individual me kolegët në lidhje më atë se si mund të zhvillojnë shkathtësitë e të mësuarit të ndërmarrësisë tek nxënësit. Interaktiviteti dhe përdorimi i lojërave të ndryshme është një dukuri shumë e mirë për mësimnxënie dhe zhvillim të kompetencave. Mësimdhënësi përdor shembuj praktik si prezantimi i lojës së tregtisë, pastaj përcaktohet qëllimi i përgjithshëm i ndërmarrësve, diskutohet rreth kompetencave që përfitojnë nxënësit nga këto metoda dhe rreth mënyrës se si bëhet planifikimi i procesimit të zhvillimit të ndërmarrësisë me nxënësit.

Në vazhdim prezantohen pyetjet me anë të së cilave nxënësit përgjigjen në raport me përvojën e tyre gjatë praktikës apo hulumtimit në treg.

**PYETJET**

1. Cilat janë vështirësitë e një ndërmarrësi?
2. Cilat janë mangësitë e një ndërmarrësi?
3. Çfarë kriteresh duhet të plotësojë një biznes i cili konsiderohet biznes i vogël?
4. Cilat janë përparësitë dhe dobësitë e organizimit të një biznesi të vogël?
5. Cilët janë faktorët e suksesit në organizimin e një biznesi të vogël?
6. Plotësoni pyetësorin e vet-vlerësimit dhe nxjerrni konkludimin nëse jeni të aftë të drejtoni një biznes?
7. Cilat janë pjesët përbërëse të një plani biznesi?
8. Cilat janë kriteret që përdoren për të vlerësuar një projekt-ide mbi organizimin e një biznesi?
9. Cilat janë mënyrat e zotërimin të një biznesi të vogël?
10. Cilët janë faktorët që favorizojnë fillimin e një biznesi të ri?

## Profili i ndërmarrësit dhe shkathtësitë

Kur shpjegohet profili i ndërmarrësit, diskutohen shkathtësitë, njohuritë dhe aktivitetet tipike. Për shembull, mund të thuhet që ndërmarrësit i kanë këto karakteristika:

- Të ndjekin ëndërrat e tyre
- Të jenë praktik
- Të kenë besim në veten
- Të mësojnë çdo ditë
- Të jenë liderë

Ndërmarrësia sipas këtyre karakteristikave kërkon përkushtim dhe gatishmëri për të mësuar dhe aplikuar metoda të reja praktike. Po ashtu, disa nga shkathtësitë praktike janë aftësia për të përcaktuar qëllimet, planifikimi dhe organizimi për të arritur qëllimet duke gjetur burimet efektive dhe efiçente. E rëndësishme për ndërmarrësit është aftësia për të marrë vendime të bazuara në informacione relevante dhe fakte. Përdorimi i firmave ushtrimore dhe inicimi tek nxënësit për krijim të projekteve dhe ideve biznesore dhe futja në praktikë e kësaj mënyre të punës në shkolla, qofshin ato virtuale apo reale, janë çelës i suksesit për nxënës. Krijimi i ndërmarrjeve virtuale ose reale nga nxënësit, përgjatë kësaj periudhe, duhet të përcjellet me mbështetje përmes mentorimit, takimeve reflektuese, vëzhgimeve në shkollë, aktiviteteve jashtëshkollore, shkëmbimit të emailave, kontrollimit të planit të biznesit, deri në përcaktimin e projektit përfundimtar dhe zbatueshmërisë. Si përfundim, të ofrohet mundësia e prezantimeve e cila ka për qëllim që projektet e realizueshme të mund të zbatohen në shkollat ku mësimdhënësit punojnë, por edhe të shpërndahen në shkollat apo institucionet e tjera relevante.

## Zbatimi i koncepteve të ndërmarrësisë në krijimin e projekteve në shkolla

Realizimi i planeve mësmore të lidhura me ndërmarrësinë, me metodën e themelimit të ndërmarrjeve, është treguar shumë tërheqës për nxënësit. Gjatë asaj periudhe, duke mësuar konceptet e reja dhe duke i vënë në zbatim konkret, nxënësit ndjehen si pjesë e ndonjë ndërmarrjeje dhe me entuziazëm presin hapin tjetër të punës, deri në themelimin e ndërmarrjes së tyre.

Disa shembuj konkret në lidhje me aktivitetet e nxënësve janë prezantuar në vazhdim duke përfshirë edhe garat nacionale në të gjitha shkollat e Kosovës, si Sfida e Dizajnit gjatë të cilës nxënësit zhvillojnë aktivitete të ndryshme garuese. Nxënësit organizojnë gara përbrenda shkollës me bashkëmoshatarët e tyre apo edhe në mes të Shkallës V (klasa 10 dhe 11) dhe Shkallës VI (klasa 12) në lëndë të ndryshme e cila nxit nxënësit në aspektin e aktiviteteve garuese, zhvillimin e koncepteve ndërmarrëse dhe menaxhimin e projekteve, deri tek finalizimi dhe vlerësimi. Figura 5 në vazhdim është e punuar nga nxënësit, të cilët kanë krijuar një ide biznesi dhe në bazë të zhvillimit të idesë ndërmarrëse ata kanë punuar disa ueb faqe.




*Shembull i krijimit të një ideje biznesi për zhvillimin e websajteve*

Sfida e Dizajnit është një garë e cila ndihmon nxënësit tanë që të shfrytëzojnë imagjinatën, njohuritë, kreativitetin dhe ndërmarrësinë për të zhvilluar punimet e tyre në bazë të kërkesave të sfidave të caktuara. Si përfundim, në këtë garë vendet e para fituese marrin edhe çmime dhe kupona me anë të të cilëve nxënësit pastaj furnizohen me pajisje apo materiale të ndryshme të nevojshme për aktivitete shkollore.




Foto nga trajnimi i mësimdhënësve të Gjilanit dhe Kamenicës në kursin e ndërmarrësisë

# KAPITULLI KATËRT

# ORIENTIMI DHE KËSHILLIMI PËR KARRIERË (OKK)

Karriera mund të definohet si rrugëtimi që bën një individ gjatë edukimit formal, joformal dhe punës. Orientimi për karrierë nënkupton “informim, këshillim dhe orientim që ka për qëllim të përgatisë nxënësit dhe punëkërkuesit me shkathtësi të menaxhimit të karrierës për të bërë zgjedhje të mirëinformuara dhe të menaxhojnë karrierën e tyre gjatë gjithë jetës”. (OECD, 2004, p. 19) (Zelloth, 2011, p. 1) Nga perspektiva individuale, kemi të bëjmë me mësimin tërë-jetësor për të arritur qëlimet personale dhe profesionale. Nga perspektiva institucionale, orientimi për karrierë nënkupton organizimin e proceseve dhe aktiviteteve të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj. Aktivitetet kryesore në OKK mund të ndahen në tri lloje sipas shkathtësive që synohet të arrihen:

1. Shkathtësitë për vetëvlerësim dhe reflektim (vetë-testimi, testimi profesional dhe ndërgjegjësimi për përparësitë dhe mangësitë)
2. Shkathtësitë për hulumtim të mundësive dhe kërkesave për zhvillim të kompetencave ose për punësim (analiza e kërkesave të aplikimit për shkollë, universitet, punë dhe përgatitja efikase për konkurs)
3. Shkathtësitë e menaxhimit (vendimmarrja e informuar, planifikimi i zhvillimit dhe veprimit)

Pasi që orientimi për karrierë është identifikuar si pikë kryesore në Planin Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016), zbatimi i këtij koncepti ka pasur një zhvillim të mirë tri viteve të fundit duke pasur parasysh hartimin e strategjive për orientim dhe këshillim në karrierë, organizimin e trajnimeve dhe hapjen e klubeve të karrierës nëpër shkolla. MAShTI po ashtu ka aprovuar portalin për karrierë busulla.com që të përdoret në shkollat e Kosovës. Po ashtu, departamenti për arsimin tërëjetësor, ka sugjeruar temat që mund të përdoren sipas klasëve, aktiviteteve dhe shkathtësive të OKK, të cilat i kemi quajtur me një emër Rezultatet e OKK ose me shkurtesën ROKK. (Departamenti për Arsim Tërëjetësor (MASHT), 2018) Për të mos zhvendosur vëmendjen nga Rezultatet e Fushës (RNF) dhe Rezultatet e Lëndës (RNL), ROKK referohet si dokument shtesë prej të cilit mësimdhënësit mund të marrin ide. Vlen të theksohet se paraqitja e RNL në plan programet mund të jetë e prezantuar me pika apo numra, dhe ato mund të ndryshojnë gjatë viteve, në dokumentin që ne i referohemi në analizën e bërë gjatë përpilimit të këtij doracaku, numrat janë përshtatur me RNF për arsye të referimit.

## Karriera koncept i rëndësishëm për të gjithë

Për të pasur sukses në realizimin e konceptit të OKK me nxënës në shkolla, mësimdhënësit duhet të kuptojnë karrierën edhe në kontekstin e mësimdhënies si dhe të promovojnë aspektet e

vetëvlerësimit, reflektimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm. Koncepti i karrierës mund të konkretizohet përmes portalit të aprovuar nga MAShTI www.busulla.com (MASHT, n.d.) Sugjerohet që mësimdhënësit e Fushës Jeta dhe Puna të regjistrohen vetë në portalin busulla.com si mësimdhënës dhe të bëjnë testin IVAP. Kjo u ndihmon atyre në njohjen me portalin, si dhe u mundëson disa funksione tjera si mësimdhënës kur regjistrohen nxënësit.

Sa i përket realizimit, portali mund të përdoret për realizimin e disa njësive mësimore që ndërlidhen me shkathtësitë për vetëvlerësim dhe reflektim sikur: regjistrimi në portal, bërja e testit IVAP dhe të potencialit, si dhe analizën e profesioneve në ndërlidhje me rezultatet e testit IVAP dhe të potencialit. Mësimdhënësit të cilët realizojnë konceptin e OKK, por edhe të tjerët, sugjerohen të bëjnë reflektimin në vijim lidhur me profesionin e mësimdhënësit. Në këtë mënyrë ata praktikisht do të mund të ndërlidhin konceptin me përvojën e tyre personale. Modeli kërkon që të përshkruhen aspektet në vijim:

- Përmbledhja e profesionit
- Aktivitetet kryesore
- Njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen
- Kushtet e punës
- Veglat e punës
- Shkollimi dhe trajnimet e domosdoshme

I njëjti model mund të përdoret edhe për përshkrimin e profesioneve të ndryshme. Mësimdhënësit, duke bërë përshkrimin e profesionit të tyre, të cilin e njohin më së miri, e shpjegojnë më konkretisht strukturën e përshkrimit të profesioneve. Me nxënës, në klasë apo në distancë, mund të synohet përshkrimi i profesioneve të ndryshme përmes videove të paraqitura në https://busulla.com/occupations.

## REFLEKTIM PËR PROFESIONIN E MËSIMDHËNËSIT

*Përshkruani profesionin e mësimdhënësit sipas strukturës të paraqitjes së profesioneve në busulla.com*

- Përmbledhja e profesionit
- Aktivitetet kryesore
- Njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen
- Kushtet e punës
- Veglat e punës
- Shkollimi dhe trajnimet e domosdoshme

**SHEMBULL i përshkrimit të profesionit të** mësimdhënësit sipas strukturës.
**Shpresa Hoxha-Behrami, Prishtinë**

Përmbledhja e profesionit:
Shkolla është institucion edukativo-arsimor, e cila ka funksion akademike, profesional, shoqëror dhe qytetar në shoqërinë demokratike. Mësimdhënësit e arsimit të mesëm të lartë realizojnë një

ose më shumë lëndë. Rolin kryesor në shkollë e ka nxënësi, ndërsa roli i mësimdhënësit është të ndihmojë nxënësit në mësimnxënie, në konkretizimin e koncepteve që mësojnë në lëndët shkollore të bëjë ndërlidhjen e teorisë dhe praktikës, me shembuj nga jeta reale. Mësimdhënia është një profesion me shumë përgjegjësi, një mundësi për t'u shërbyer të tjerëve duke ndikuar në formësimin e një shoqërie të tërë. Mësimdhënësi frymëzon të tjerët, mësimdhënësit e bëjnë ndryshimin, *siç e thotë Eqrem Çabej: "Mësimdhënia nuk është profesion, por mision".*

**Aktivitetet kryesore**

- Njeh dhe i mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MAShTI/përgjegjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës;
- Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit;
- Demonstron njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës;
- Planifikon zbatimin efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyese dhe raporton sa i përket mësimit të nxënësve;
- Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
- Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe bashkësi.

**Njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen**

- Zotëron lëndën që ligjëron dhe ndërlidhjen e saj me lëndët tjera në disiplinën e caktuar dhe jashtë saj;
- Njeh dhe vlerëson teoritë e ndryshme të të mësuarit në kontekstin e të kuptuarit se si mësojnë nxënësit dhe cilat janë metodat më efektive në mësimdhënie;
- Përdor strategji të llojllojshme të mësimdhënies për t'i motivuar nxënësit dhe nxitur të menduarit e nivelit të lartë;
- Njeh dhe praktikon metoda të planifikimit të lëndës dhe njësive mësimore duke u bazuar në parime dhe qëllime të dala nga KKK dhe në praktikat specifike të lëndës;
- Krijon mjedis mësimor të sigurt dhe mbështetës, që e rrit nxënien dhe i inkurajon nxënësit të bëhen persona që i zgjidhin problemet, që janë vendimmarrës, që mësojnë gjatë tërë jetës, si dhe që bëhen pjesëtarë të dobishëm të shoqërisë;
- Njeh dhe i respekton kërkesat ligjore, administrative dhe organizative të profesionit, duke e përfshirë orarin mësimor, vlerësimin dhe proceset tjera të komunikimit dhe vlerësimit të cilësisë në shkollë;
- Menaxhon aktivitetet në klasë duke realizuar mësim gjithëpërfshirës me nxënësin në qendër, dhe duke menaxhuar me kohën, aranzhimin e klasës, mjeteve mësimore dhe disiplinën dhe angazhimin e nxënësve;
- Analizon në mënyrë kritike burimet e mësimdhënies dhe menaxhon përzgjedhjen, përshtatjen, krijimin dhe përdorimin efikas të tyre;
- Inkuadron përdorimin e TIK në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit;
- Vlerëson vazhdimisht progresin e nxënësve si dhe komunikon me nxënësit për t'u ofruar informata kthyese në mënyrë konstruktive. Planifikon plotësimin e zbrazëtive te të arriturat e nxënësve;
- Merr përgjegjësi për zhvillimin e vet profesional për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies, bashkëpunimin në shkollë, pjesëmarrjen në shoqata profesionale dhe angazhimin në komunitetin profesional;

- Komunikon, bashkëpunon në mënyrë efektive me nxënës, prindër/ kujdestarë, kolegë, dhe komunitet.

**Kushtet e punës**

Mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta zakonisht punojnë me orar të rregullt mësimor si dhe orë shtesë, për t'u përgatitur për orët mësimore, për të marrë pjesë në takimet e stafit dhe për të ndërmarrë detyra administrative siç janë shënimet dhe shkrimi i raporteve. Atyre gjithashtu mund t'u kërkohet të punojnë orë shtesë për të dërguar nxënës në ekskursione ose kampe, si dhe për të marrë pjesë në këshillin e mësimdhënësve, diplomime ose ngjarje të tjera shkollore.

**Veglat e punës**

Mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta përdorin shumëllojshmëri të teknologjive dhe mjeteve arsimore për të zhvilluar mësimin, të tilla si tabelat, librat e mësimit dhe librat e punës, si dhe pajisjet dhe tekstet audio-vizuale, platforma online, portale online, etj. Ata përdorin kompjuterë dhe pajisje të tjera zyreje. Ata poashtu përdorin materiale ose pajisje që janë të rëndësishme për fushën në të cilën ata japin mësim, të tilla si pajisje arti dhe artizanale, pajisje sportive, etj.

**Shkollimi dhe trajnimet e domosdoshme**

Për të punuar si mësimdhënës i shkollës së mesme të lartë ju duhet të përfundoni studimet Bachelor dhe Master për lëndët përkatëse. Duhet t'u nënshtroheni në vazhdimësi trajnimeve që organizohen nga MAShTI, mësim gjatë gjithë jetës, etj., qe të jemi në hap me kohën.[2]

Pas bërjes së përshkrimit, mësimdhënësit duke u bazuar në përvojën e tyre personale në lëndë të caktuar, konsultojnë standardet e përgjithshme të mësimdhënësve[3] dhe udhëzuesit për licencimin e mësimdhënësve[4]. Si mësimdhënës të fushës "jeta dhe puna", sugjerohet që ata të vetëdijesohen edhe për kompetencat digjitale të mësimdhënësve[5] në mënyrë që të tregojnë shembuj të aplikimit të teknologjisë në mësimdhënie për mësimdhënësit tjerë në shkollë.

## Plani Personal Zhvillimor

Përveç reflektimit mbi profesionin, mësimdhënësit kërkohet të bëjnë një **Plan Personal Zhvillimor (PPZH).** PPZH është një proces i strukturuar i zhvillimit të karrierës dhe ka për qëllim zhvillimin e aftësisë së individit (pra edhe mësimdhënësit) që të reflektojë në zhvillimin e vet profesional, të planifikojë përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm. Përderisa, mësimdhënësit e OKK e kanë si rezultat zhvillimin e këtij plani për nxënësit, rekomandohet që të përpilojnë një plan të tillë edhe për veten. Përderisa MAShTI përdor modelet e veta, ne rekomandojmë që

[2] https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/07/ua-masht-10-2018-per-normativin-mbi-kuadrin-profes-te-arsimit-te-pergjithshem-x.pdf
[3] https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf
https://www.teachingenglish.org.uk/sites/teacheng/files/CPD_framework_for_teachers_WEB.PDF
[4] https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/sistemimi-i-licencimit-dhe-zhvillimit-te-mesimdhenesve-ne-karriere.pdf
[5] https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu

mësimdhënësit të reflektojnë duke inkuadruar çështjet në vijim:

## Shembull i reflektimit për planin personal zhvillimor (PPZH) për mësimdhënës

Shkruaj një përmbledhje të shkurtër për karrierën tuaj si mësimdhënës.

1. Cilat janë qëllimet tuaja për të ardhmen?
2. Cilat janë përparësitë tuaja si mësimdhënës?
3. Cilat janë mangësitë tuaja si mësimdhënës?

**Sembull i reflektimit të mësimdhënëses Shpresa Hoxha-Behrami, Prishtinë:**

1. **Cilat janë qëllimet tuaja për të ardhmen?**

- Qëllimet e mija në të ardhmen janë të kontribuoj në ngritjen e cilësisë në arsim, duke u zhvilluar profesionalisht në vazhdimësi sepse një mësues i mirë gjithmonë është në kohë me gjëra të reja, e gatshme për të mësuar;
- Të hulumtoj mbi zhvillimet e reja në arsim;
- Të punoj për mirëqenien e nxënësve;
- Të punoj me mësimdhënës të tjerë, duke shkëmbyer njohuri, metoda dhe përvojë.

2. **Cilat janë përparësitë tuaja si mësimdhënës?**

- Nga aspekti profesional jam e pergatitur dhe njohëse e mirë e lëndës të cilën e ligjëroj.
- Jam fleksibile dhe e interesuar për mësim të vazhdueshëm, mësim gjatë tërë jetës.
- Jam e gatshme për të ndarë njohuritë dhe pervojat e mira me nxënësit, mësimdhënësit dhe komunitetin në përgjithësi .
- Përdor metodologji dhe teknika mësimore më bashkëkohore, duke ndërlidhur njësitë me realitetin dhe zgjidhjen e problemeve nga jeta reale.

3. **Cilat janë mangësitë tuaja si mësimdhënës?**

- Lënda të cilën e ligjëroj kërkon në vazhdimësi të jem në hap më kohën dhe të percjell trendet e teknologjisë, të cilën edhe po mundohem ta bëj me përkushtimin më të madh.

Ngjashëm mund të krijohet një model për nxënës i cili përshtatet sipas moshës apo momentit kur krijohet plani.

## Shembull i reflektimit të nxënësit, plani personal zhvillimor, (PPZH) / Nxënësi

Kërkoni nga nxënësit që të shkruaj një përmbledhje të shkurtër për qëllimet e tyre në karrierë duke u bazuar në hulumtimin e tyre individual sipas pyetjeve të mëposhtme.

1. **Cili është profesioni juaj i preferuar**?

- Përmbledhja e profesionit
- Aktivitetet kryesore
- Njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen
- Kushtet e punës
- Veglat e punës

- Shkollimi dhe trajnimet e domosdoshme

2. **Cilat janë lëndët më të rëndësishme të ndërlidhura me këtë profesion në shkollën tuaj?**
3. **Cilat janë përparësitë e juaja lidhur me këtë profesion ? Cilat njohuri dhe shkathtësi të kërkuara për këtë profesion i posedoni ju?**
4. **Cilat janë mangësitë e juaja lidhur me këtë profesion? Cilat njohuri dhe shkathtësi ju mungojnë më specifikisht?**

Në bazë të përgjigjeve në pyetjet e mëparshme, bëni një përmbledhje të profesionit tuaj të preferuar për të ardhmen.

## Shembull i përmbledhjes së profesionit

1. Profesioni im i preferuar është inxhinier i informatikës apo i softuerit.
2. Përmbledhja e dy profesioneve që i përshtaten preferencës sime në busulla.com janë:

   https://busulla.com/occupations/inxhinier-e-i-e-informatikes

   https://busulla.com/occupations/dizajnues-e-i-e-softuerit.

3. Sipas përshkrimit të njohurive dhe shkathtësive të kërkuara, lëndët më të rëndësishme janë: matematika, teknologjia, fizika, ndërrmarrësia, gjuha shqipe dhe angleze.
4. Unë jam i mirë në matematikë dhe komunikim. Shkruaj mirë dhe bëj prezantime të mira. Poashtu jam i vëmendshëm ndaj hollësive dhe dua qe punimet ose prezantimet e mia të jenë të sakta, të paraqitura mirë vizualisht dhe të bëjnë përshtypje.
5. Më duhet të rris njohuritë e mia në programim si dhe aplikimin e teknologjisë. Më duket zgjidhje e mirë të rris interesimin në këtë fushë, të mësoj ndonjë gjuhë programuese dhe të regjistrohem në klubin e teknikëve.

Mësimdhënësit të cilët praktikojnë një reflektim të tillë, menaxhojnë më mirë karrierën e tyre dhe mund të planifikojnë përmirësimin pa marrë parasysh obligimet zyrtare. Kur mësimdhënësit planifikojnë përmirësimin, mund të marrin parasysh edhe vlerësimet e nxënësve, vlerësimin e drejtorit, apo vlerësimet nga inspektorët. Ashtu si rekomandohet të promovohet kultura e përmirësimit tek nxënësit përmes aktiviteteve të ndryshme në OKK, ashtu edhe mësimdhënësit mund të përfitojnë nga zbatimi i parimeve të OKK dhe të promovojnë këtë koncept në mënyra më efikase.

Kur planifikohet përmirësimi, pikënisje janë mangësitë, duke u fokusuar në disa që konsiderohen të rëndësishme për ju apo për nxënësit. Tabela në vijim mund të përdoret për këtë qëllim.

### Shembull nga Plani Zhvillimor i mësimdhënësit

| Çfarë dua/duhet të bëj/mësoj? | Si do ta arrij këtë? | Çfarë burime do të përdor? | Si do ta mas suksesin tim? | Kur do ta ndryshoj planin tim? |
|---|---|---|---|---|
| Do të mësoj se si të përgatis kriteret e vlerësimit duke përdorur rubrikën. | Do ta ndryshoj instrumentin e vlerësimit që të përshtatet me rezultatet e të nxënit.<br><br>Do të përpiloj kriteret e disa niveleve të arritjes në instrumentin e vlerësimit që e përdor. | Do të kërkoj në internet për të shikuar modele të rubrikave për llojet e vlerësimit.<br><br>Do të konsultohem me kolegë.<br><br>Do të marr pjesë në trajnim për vlerësim nëse organizohet.<br><br>Do të lexoj literaturë. | Suksesin do ta mas me rubrikën e krijuar për instrumentin e vlerësimit dhe nga përshtypjet e nxënësve dhe prindërve. | Në semestrin tjetër. |

### Shembull i planit zhvillimor për nxënësit

| Çfarë dua/duhet të bëj/mësoj? | Si do ta arrij këtë? | Çfarë burime do të përdor? | Si do ta mas suksesin tim? | Kur do ta ndryshoj planin tim? |
|---|---|---|---|---|
| Do të mësoj se si të shkruaj ese argumentuese. | Do të lexoj dhe t`i kushtoj kujdes teknikave për shkrimin e eseve argumentuese.<br><br>Do të ushtroj parashtrimin e tezës kryesore në ese.<br><br>Do të ushtroj ndarjen e esesë në hyrje, trup dhe përmbyllje.<br><br>Do të ushtroj shkrimin e paragrafëve të cilët argumentojnë një ide të shoqëruar me evidencë dhe pikëpamje të ndryshme. | Do të konsultoj librin dhe burimet në internet.<br><br>Do të shkoj në klubin e debatit në shkollë. | Suksesin do ta mas me notat si rezultat i shkrimit të eseve.<br><br>Përshtypjet e kolegëve në debatet apo punimet e shkruara.<br><br>Komentet e mësimdhënësve. | Në semestrin tjetër. |

# Ideimi i njësive mësimore për OKK

Parakusht për ideimin e njësive mësimore për çfarëdo fushe, dhe në këtë rast edhe për OKK, janë Korniza Kurrikulare, Kurrikula Bërthamë dhe Planet Mësimore për klasat e caktuara. Të gjithë mësimdhënësit praktikojnë planifikimin vjetor, dy-mujor, javor edhe ditor si pjesë e aktiviteteve të rregullta të punës së tyre. Sfida e mësimdhënësve qëndron në zbatimin praktik të kurrikulës dhe jo në përmbushjen e obligimit formal të planifikimit.




Udhëzimet për mbledhjen e temave OKK

Në figurën 5, është bërë një analizë për të ilustruar planifikimin për OKK, ne bazohemi tek RNF dhe RNL për OKK si dhe në tri llojet e shkathtësive për OKK. Për të ideuar njësitë mësimore praktikë e mirë është që të shikohen RNF dhe RNL zyrtare, të krijohen udhëzime shtesë si në rastin tonë me Rezultatet e OKK (ROKK), dhe të mendohet se çfarë tema do të mund të realizojmë sipas orëve që kemi në dispozicion. Mësimdhënësit mund të japin idetë e tyre duke i vendosur në tabelë. Kjo mund të rishikohet disa herë derisa të sigurohen se kanë mjaft tema për secilën fushë dhe secilën klasë.

Pas mbledhjes së temave, ato mund të përzgjidhen për planin vjetor për të ndihmuar planifikimin e tyre të integruar në fushën Jeta dhe Puna për secilën klasë.

Në këtë mënyrë mund të koordinojnë aktivitetet dhe të shfrytëzojnë ndonjë aktivitet shkollor për të fuqizuar kuptimin e konceptit. Për shembull, mësimdhënësit në Gjimnazin “Xhavit Ahmeti” në Gjilan kanë bërë një koordinim mes mësimdhënësve kur është shpjeguar koncepti i aplikimit për praktikë/punë. Me rastin e hapjes së klubit të karrierës dhe të teknikëve, është bërë shpallja për praktikë në klub për nxënësit e klasave X, XI, dhe XII. Nxënësit kanë pasur detyrë të aplikojnë

realisht në praktikë dhe ata që janë përzgjedhur për intervista kanë kaluar edhe në procesin e intervistimit, i cili ka përfunduar me përzgjedhjen e 12 nxënësve në klubin e karrierës dhe 12 nxënësve në klubin e teknikëve. Ngjashëm, në shkollën Eqrem Çabej në Prishtinë, Mësimdhënësja e TIK dhe Mësimdhënësja e Gjuhës Shqipe janë koordinuar për të realizuar njësinë mësimore CV dhe Letra Motivuese, duke përforcuar aspektet e shkrimit dhe përdorimit të modeleve me përdorimin e programit Word.

## Zhvillimi i Njësisë Mësimore

Kur zhvillohet njësia mësimore ose plani për realizimin e saj, merret tema të cilën e kemi nxjerrë në bazë të analizës së RNF, RNL dhe ROKK dhe specifikohet qëllimi, rezultatet e njësisë dhe aspektet tjera të realizimit. Preferohet që fillimisht të bëhet vizualizimi i temës me qëllim që të sigurohemi që jemi duke aplikuar të gjitha aspektet e parapara.

Këtu konsiderojmë edhe Kompetencat e Kurrikulës së Kosovës (RNK) si dhe shkathtësitë e buta. Po ashtu, duhet të konsiderojmë kohën, grupin me të cilin organizohet njësia, metodat e mësimdhënies, materialet dhe mënyrën e vlerësimit.

Planifikimi është proces kreativ dhe jo vetëm përshkrues. Duke përdorur letra të thjeshta me ngjyrë sipas modelit të dhënë më poshtë, mësimdhënësi planifikon njësinë mësimore. Ky proces mund të jetë grupor apo individual dhe mund të përdoret edhe për lëndë të tjera.



Foto nga aktiviteti i zhvillimit të njësive mësimore




Shembull i gjenerimit të temave nga mësimdhënësit




Shembuj të aplikimit të zhvillimit të njësive mësimore të OKK nga mësimdhënësit

Pas këtij procesi, mësimdhënësi plotëson formën e planifikimit të njësisë mësimore dhe e praktikon në klasë. Njësitë model të krijuara gjatë trajnimit për OKK janë paraqitur në shtojcat (klikoni te tabelat 4.1-4.3). Për cilindo model që përdoret nga shkolla, aspektet e paraqitura më lart janë themelore për planifikim. Zakonisht, sipas reflektimeve në praktikën profesionale planifikimi i duhur shmang mbingarkesën e nxënësve, përqendrimin në metodën e ligjërimit/shpjegimit dhe demotivimin e nxënësve. Po ashtu, sipas nevojës, mësimdhënësit duhet të krijojnë edhe shumë materiale përcjellëse, të cilat përdoren gjatë realizimit, si prezantim, udhëzime, pyetje, formularë, etj.

# KAPITULLI PESTË

# EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM (EZhQ)

Zhvillimi i qëndrueshëm përkufizohet si "zhvillimi që plotëson nevojat e tanishme pa rrezikuar aftësinë e gjeneratave të ardhshme që të plotësojnë nevojat e tyre" (Komisioni Bruntland, 1987). Koncepti ngërthen ndërlidhjen mes tri shtyllave kryesore të zhvillimit: ekonominë, shoqërinë dhe mjedisin, dhe ndikimin që njëra-tjetra kanë në jetën dhe mirëqenien e njerëzve dhe të të gjitha qenieve të gjalla në tokë. Edhe pse ky koncept ka shumë pak orë të planifikuara, mënyra më e mirë për arritjen e kompetencave është mësimi i bazuar në projekte dhe ndërlidhja me lëndë tjera. Disa nga aktivitetet që sugjerohet të realizohen për ngritjen e vetëdijes së nxënësve për ndikimin individual dhe shoqëror janë:

1. Kalkulatori i gjurmës: https://www.footprintcalculator.org/
2. Aktivitete që mund të përshtaten për nivele të ndryshme të shkollimit nga paketa e gjelbër: http://documents.rec.org/publications/GreenPackKS-AL_Aug2012_Web_1.pdf
3. Projektet shkollore.

## Kalkulatori i gjurmës

Secila qenie që jeton në planetin tokë lë gjurmën e vet sipas mënyrës së jetës që bën. Njerëzit lënë gjurmën e tyre sipas mënyrës se si ushqehen, tipit të banesës dhe ngrohjes, sipas transportit që përdorin, se si menaxhojnë mbeturinat dhe të tjera. Me rëndësi është që nxënësit të kuptojnë dhe të vetëdijesohen lidhur me gjurmën që secili prej nesh lëmë dhe të mendojnë për ndryshimet që mund t'i bëjmë si individë dhe shoqëri për ruajtjen e planetit tokë. Mësimdhënësit mund të përdorin kalkulatorin e gjurmës, https://www.footprintcalculator.org/, për të reflektuar për ndikimin individual dhe shoqëror në mjedis.

## Paketa e Gjelbër

Paketa e gjelbër është një publikim i REC Kosova, pjesë e rrjetit të zyrave lokale të REC në Evropën Jug-Lindore, e cila promovon mbrojtjen e mjedisit. Në këtë paketë përfshihen 5 kapituj të cilët mbulojnë temat:

1. Përbërësit e mjedisit: ajri, uji, dheu dhe biodiversiteti;
2. Kërcënimet dhe presionet: urbanizimi, zhurma, mbeturinat dhe kimikatet;
3. Aktiviteti njerëzor: energjia, transporti, industria, bujqësia, pyjet dhe turizmi;
4. Sfidat globale: ndryshimet klimaterike, hollimi i shtresës së ozonit, acidifikimi dhe problematikat që ndikojnë mbi detet dhe oqeanet;

5. Vlerat: shoqëria e konsumit, shëndeti i njerëzve dhe mjedisi, të drejtat e qytetarëve, Toka jonë në të ardhmen.

Në kornizën kurrikulare, temat për zhvillimin e qëndrueshëm janë të kufizuara dhe të fokusuara në ndikimin e teknologjisë në mjedis dhe aktivitetet e nxënësve. Mësimdhënësit duhet të kenë kujdes dhe të mbulojnë edhe efektet pozitive të teknologjisë. Të gjitha tekstet dhe planet mësimore në paketën e gjelbër mund të përshtaten dhe mësimdhënësit mund të përdorin ide të cilat janë të rëndësishme për komunitetin ku nxënësit jetojnë.




Momente nga aktivitetet e nxënësve në projekte të ndryshme mësimore

## Aktivitetet në shkollë

Shkollat mund të promovojnë disa aspekte të kulturës për kujdesin ndaj mjedisit duke vendosur temat vjetore për zhvillim të qëndrueshëm dhe duke i realizuar ato me projekte shkollore në lëndë të ndryshme. Për shembull, mund të shikohet nëse mund të izolohet shkolla, të mbjellin drunj, lule apo kopshte, të aplikojnë teknologji të mençur, të krijojnë rregulla që zvogëlojnë ndikimin e shkollës dhe anëtarëve të saj në mjedis, të organizojnë ditë të pastrimit dhe ide të tjera. Mund të realizohen edhe projekte të aspektit shoqëror të cilat ngrisin vetëdijen lidhur me zhdukjen e varfërisë, kujdesin ndaj grupeve të rrezikuara, ruajtjen e vendeve të natyrës, trashëgimisë kulturore dhe vlerave kulturore.

## Realizimi i planeve mësimore në klasë

Mësimdhënësit e të gjitha fushave mësimore duhet bërë disa hapa paraprakë për të realizuar orën mësimore në klasë, duke filluar nga analiza e filozofisë së kurrikulës së Kosovës, rezultatit të fundit të pritur nga shkollimi, rezutateve të pritura nga secila fushë dhe secila shkallë kurrikulare, dhe në fund duke specifikuar të priturat nga secila orë mësimore.
Në vijim të tekstit janë disa udhëzime lidhur me analizën që duhet bërë planeve mësimore, pastaj prezantohen edhe disa shembuj të planeve të realizuara nga mësimdhënësit e klasëve të ndryshme me nxënës.



Foto me anëtarët e ‘Klubeve të karrierës’ me rastin e ‘Ditës së vajzave’

## Analiza e planit mësimor

Aftësia e planifikimit rritet me përdorimin e metodës së analizës e cila mund të përdoret nga mësimdhënësit në shkollë për të ngritur cilësinë e mësimdhënies. Në vijim, paraqitet formulari i analizës së një plani mësimor. Përdoreni si metodë të vlerësimit midis kolegëve para se të dorëzoni planet mësimore të detajuara. Si ushtrim, analizoni njësinë mësimore model *Kërko fakultetet* (5. Shtojcat).

| ***Rezultatet e Temës Mësimore***<br><br>***KL****(10-12)*____________<br><br>***RNF*** *(Kurrikula Bërthamë)*______<br><br>***RNL*** *(Plani Mësimor)*<br>_________<br><br>***ROKK*** *(Shtojca 2)*<br>___________ | ***Niveli sipas Bloom, vendos numrin***<br>1. Mban mend<br>2. Kupton<br>3. Aplikon<br>4. Analizon<br>5. Vlerëson<br>6. Krijon | ***Vendos Kompetencat e Kurrikulës dhe shkathtësitë e buta***<br>1. Të menduarit kritik<br>2. Komunikimi<br>3. Zgjidhja e problemeve<br>4. Kreativiteti<br>5. Inteligjenca emocionale<br>6. Ndërgjeshmëria<br>7. Këmbëngulësia<br>8. Puna ekipore<br>9. Shkathtësi hulumtuese<br>10. Shkathtësi ndërmarrëse | ***Strategjitë e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies***<br>*1. Ligjërate*<br>*2. Demonstrim*<br>*3. Projekt mësimor*<br>*4. Punë nëlaborator*<br>*5. Ushtrime*<br>*6. Diskutim*<br>*7. Vizitë*<br>*8. Tjetër* | ***Metoda e Vlerësimit***<br>*1. Test*<br>*2. Ese*<br>*3. Projekt*<br>*4. Prezantim*<br>*5. Portofolio*<br>*6. Tjetër* |
|---|---|---|---|---|
| ● Përdor TIK për të kërkuar në portalin e karrierës busulla.com për fakultetet që i konsideron në të ardhmen | | | | |
| ● Krahason programet e studimit dhe informata për institucionet | | | | |
| ● Bën një plan hulumtimi për përzgjedhjen e fakultetit. | | | | |

## Reflektimi pas realizimit të njësisë mësimore

Pas realizimit të njësisë mësimore mësimdhënësit mund të reflektojnë mbi atë se si shkoi ora dhe duke përdorur formën në vijim.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Vlerësim personal për realizimin e Planit Mësimor** | | | | | |
| **Për secilin seksion notoni vetën me notën prej 1 deri në 5, kurse tek hapësira shpjegoni!** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
| ***Sa u realizua Plani Mësimor në praktikë: Shpjego***<br>1 (aspak); 2 (shumë pak); 3 (gjysma); 4 (shumica); 5 (plotësisht) | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
| Plani nuk u realizua plotësisht sepse nxënësit nuk e përfunduan detyrën me kohë dhe unë nuk arrita të jap detyrat e shtëpisë! | | | | | |
| **Si filloi klasa? Çfarë përgatitje/ shpjegime bëtë?**<br>1 (pa përgatitje); 2 (përgatitje gjysmake); 3 (përgatitje, por pa udhëzime); 4 (me përgatije paraprake dhe udhëzime të mira); 5 (me përgatitje të mira dhe udhëzime efikase) | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
| Klasa filloi me një diskutim për karrierën dhe vazhdoi me projektimin e busulla.com në ekran.<br>Nxënësit mirëpritën temën por kabineti nuk ishte përgatitur paraprakisht për të mos humbur kohë dhe nuk u dhashë udhëzimet në fletë për regjistrim, kështu që nxënësit tërë kohën pyesnin dhe u vonuam shumë me procesin e regjistrimit. | | | | | |
| **Sa ishin të interesuar nxënësit?**<br>**Si mbajtët interesimin e tyre?Shpjego**!<br>1 (aspak); 2 (pak); 3 (pjesërisht); 4 (shumicën e kohës); 5( tërë kohën) | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
| Nxënësit ishin të interesuar tërë kohën, dhe mungesën e kompjuterëve për secilin nxënës e zëvendësuam me përdorimin e telefonave. | | | | | |
| ***Sa i realizuan nxënësit detyrat me %?***<br>***Shpjego dhe jep një mostër të shkëlqyer, kaluese dhe jo kaluese!***<br>1 (0%); 2 (30%); 3 (50%); 4 (70%); 5 (100%) | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
| 75% të nxënësve e realizuan detyrën. Disa e përfunduan në klasë dhe disa në shtëpi.<br>Ata që nuk e realizuan, u paralajmëruan që detyra e radhës do të kërkojë regjistrimin. | | | | | |

Reflektimi në këtë mënyrë adreson aspektet e realizimit duke përfshirë përgatitjet, problemet eventuale dhe realizimin e detyrave. Një reflektim i tillë mund të ndihmojë që sidomos të shikoni çështjet:

- Çfarë duhet të kem parasysh sa i përket përgatitjes kur e realizoj këtë njësi me grupin tjetër?
- Çfarë ndikoi në interesimin e nxënësve?
- Pse nxënësit nuk i kanë dorëzuar detyrat apo pse kanë arritur rezultatin e caktuar?
- A ka aspekte të përgjithshme që duhet të përforcohen, bazuar në vlerësimin e marrë?

# KAPITULLI GJASHTË

# SHEMBUJ TË PLANEVE MËSIMORE TË REALIZUARA NGA FUSHA JETA DHE PUNA

Planet mësimore të paraqitura më poshtë janë plane të cilat kanë dalë nga trajnimet e mbajtura nga programi ASSET: TIK, OKK, Ndërmarrësi, MBP, VpN si dhe kanë përmbushur kriteret se si duhet të realizohet një plan mësimor me të gjithë elementet e kërkuara nga kurrikula bërthamë. Në këto trajnime u identifikuan numër i madh i planeve me përfshirje të mirë në të gjitha elementet, por ne kemi përfshirë vetëm disa nga ato, të ndara në shkallë dhe fusha. Tabela në vijim përmbledhë numrin e planëve mësimore nga shembuj të realizuar, për secilin koncept dhe secilën klasë.

| Tabela përmbledhëse e planeve mësimore nga Fusha Kurrikulare Jeta dhe Puna | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konceptet e fushës Jeta dhe Puna** | Shkalla V-të kurrikulare (klasa X dhe XI) | | Shkalla e VI-të kurrikulare (klasa XII) | Nr. total i planeve |
| | **Planet për klasën e 10-të** | **Planet për klasën e 11-të** | **Planet për klasën e 12-të** | |
| **TIK** | **2** | **2** | **1** | **5** |
| **Orientim në Karrierë** | **3** | **1** | **2** | **6** |
| **Ndërmarrësia** | **2** | **2** | **2** | **6** |
| **Edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm** | **1** | **-** | **-** | **1** |
| **Nr. total** | **8** | **5** | **5** | **18** |

Planet janë përzgjedhur sipas kritereve:

1. Lidhja e mirë ndërmjet rezultateve mësimore dhe kritereve të suksesit;
2. Organizimi dhe planifikimi i mirë i orës mësimore dhe
3. Zbatimi i teknikave të VpN-së.

Sqarim: Punimet e mësimdhënësve janë paraqitur siç janë punuar në origjinal nga mësimdhënësit. Në vijim të tekstit janë prezantuar me radhë planet nga tabela e mësipërme, për klasët 10, 11, 12. Për të parë elaborimin e hollësishëm të planeve mund të klikoni në ikonën e cilitdo plan mësimor dhe do të ju hapet dokumenti i dëshiruar.

## Shembujt e Njësive Mësimore, Klasa e 10-të

(Sqarim- Kliko mbi ikonë për t'u hapur njësia mësimore e planifikuar)

| Koncepti | Tema/Njësia mësimore |
|---|---|
| **Teknologji e Informimit dhe komunikimit- TIK** | **1. Formulat dhe funksionet/Bazat e llogaritjeve me formula**<br>Bazat e llogaritjeve me formula.docx |
| | **2. Projekti Shitorja ime/ Regjistrimi i artikujve në fl. punuese**<br>Regjistrimi i artikujve në fletën p |
| **Punë dhe edukim për ndërmarrësi** | **3. Krijimi i një biznesi të ri /Zhvillimi i një ideje të biznesit, modeli Canvas**<br>Zhvillimi i një ideje të biznesit, modeli c |
| | **4. Swot analiza**<br>Swot analiza, Kl.X.docx |
| **Këshillim dhe orientim në karrierë** | **5. Karriera Ime/Hapja e një adrese email-i**<br>Hapja e një adrese email-i.docx |
| | **6. Karriera Ime/ Regjistrimi në portalin e karrierës busulla.com**<br>Regjistrimi në portalin e karrierës l |
| | **7. Karriera Ime/ Testi i Potencialit në busulla.com**<br>Testi i Potencialit në busulla.com.docx |

| | |
|---|---|
| **Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm** | **8. Ndikimi i Wifi në shëndetin e njerëzve /Projekti "Ndikimi i WiFi-së në shëndetin e komunitetit tonë"**<br>Projekti Ndikimi i WiFi-së në shëndeti |

| **Shembujt e Njësive Mësimore, Klasa e 11-të**<br>(Sqarim- Kliko mbi ikonë për t'u hapur njësia mësimore e planifikuar) | |
|---|---|
| **Koncepti** | **Tema/Njësia mësimore** |
| **Teknologji e Informimit dhe komunikimit-TIK** | **9. Komunikimi elektronik /Menaxhimi i emailave**<br>Menaxhimi i emailave.docx |
| | **10. Shfrytëzimi i aplikacionit-baza e të dhënave/ Planifikimi, ndërtimi dhe ruajtja e bazës së të dhënave**<br>Planifikimi, ndërtimi dhe ruajtja e bazës s |
| **Punë dhe edukim për ndërmarrësi** | **11. Ide ndërmarrëse/ Ndërtimi i urës**<br>Ndërtimi i urës.docx |
| | **12. Hyrje në ndërmarresi**<br>Hyrje në ndërmarrësi.docx |
| **Këshillim dhe orientim në karrierë** | **13. Aplikimi për praktikë / Ndërtimi dhe ngarkimi i CV-së**<br>Ndërtimi dhe ngarkimi i CV-is.doc |

## Shembujt e Njësive Mësimore, Klasa e 12-të

(Sqarim- Kliko mbi ikonë për t'u hapur njësia mësimore e planifikuar)

| Koncepti | Tema/Njësia mësimore |
|---|---|
| **Teknologji e Informimit dhe komunikimit-TIK** | **14. Hyrje në Java/ Deklarimi i variablave**<br>Deklarimi i variablave.docx |
| **Punë dhe edukim për ndërmarrësi** | **15. Ide ndërmarrëse /Krijimi dhe shitja e produkteve të realizuara me 3D printer**<br>Krijimi dhe Shitja e Produkteve të realizı |
| | **16. Krijimi i Vlerave_12**<br>Krijimi i Vlerave_12.docx |
| **Këshillim dhe orientim në karrierë** | **17. Karriera Ime/ Profesioni im**<br>Profesioni im.docx |
| | **18. Karriera Ime/ Kërkimi i fakultetit**<br>Kërkimi i faklutetit.docx |

# SHTOJCAT

Të pjesa e shtojcave, mund të shihen të gjitha analizat e hollësishme të koncepteve të fushës, të rezultateve mësimore të cilat i kanë paraprirë hartimit të këtij dokumenti.
Për të lexuar dokumentet në fjalë, mund të klikoni mbi ikonat përkatëse në tabelën e mëposhtme.

| **Shtojcat për klasat X, XI, XII**<br>**(Sqarim- Kliko mbi ikonë për të hapur Shtojcat)** |
|---|
| **Shtojca1: Analiza e RNF, RNL dhe njësive mësimore për qëllime planifikimi, kl. X**<br>Shtojca 1, klasa X.docx |
| **Shtojca 2: Analiza e RNF, RNL dhe njësive mësimore për qëllime planifikimi, kl. XI**<br>Shtojca 2, klasa XI.docx |
| **Shtojca 3: Analiza e RNF, RNL dhe njësive mësimore për qëllime planifikimi, kl. XII**<br>Shtojca 3, klasa XII.docx |

# BIBLIOGRAFIA


Departamenti për Arsim Tërëjetësor (MASHT). (2018). Rezultatet e Orientimit dhe Këshillimit për Karrierë (ROKK). Prishtinë.

MASHT. (2016). *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës .* Prishtina: MASHT.

MASHT. (2016). *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës (Gjimnazet - klasa X, XI, XII) ( e rishikuar). .* Prishtina: MASHT.

MASHT. (a.d.). *Platforma zyrtare e MASHT për orientim profesional,.* Gjetur në Busulla.com: busulla.com

OECD. (2004). *Career Guidance and Public Policy: Bridging the Gap.* Paris: OECD.

Zelloth, H. (2011, October). Career Gudiance in ETF Countries- a missing link in transition from education to the labour market. *Informs*(06). Gjetur në https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/85A866463B0E5D44C12579830030756B_INFORM_6_Career%20guidance.pdf

Formulat dhe funksionet

**Shkolla: Gjimnazi "Gjon Buzuku"    Komuna: Prizren    Data: ......................**
**Mësimdhënësi/ja: Lamir Shkurti**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda:TIK** | **Shkalla e kurrikulës:V** | **Klasa: X** |
| Tema[6]: Formulat dhe Funksionet<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[7]:<br><br>6 orë mësimore | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>4.2.1 Shpjegon veprimet në lidhje me formulat.<br>4.2.2 Lokalizon vendosjen e formulave në qeli.<br>4.2.3 Cekë shprehjet aritmetikorë.<br>4.2.4 Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritja e shumës, e prodhimit etj.).<br>4.2.5 Përdorë funksione për punën me tekst, funksionet financiare dhe shpjegon rëndësinë e tyre<br>4.2.6 Identifikon zgjidhjen e problemeve gjatë përdorimit të funksioneve.<br>4.2.7 Përdor formulat dhe funksionet në shembuj të jetës së përditshme | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[8] (të synuara me përmes temës)***:***<br>**I.1** Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.<br>**I.9.** Përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informatave të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.<br>**II.7**. Prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh., nga shkencat, teknologjia etj.) të realizuar në laborator ose në punëtori të shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë informative, jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike.<br>**III.3** Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.<br>**III.6** Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[9] (të synuara përmes temës):<br>**1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet** | | | |

[6] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[7] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[8] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[9] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme

| |
|---|
| *1.1 Analizon ndryshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.*<br>**2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë**<br>*2.1 Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit.*<br>**4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme**<br>*4.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe pune hulumtuese.*<br>*4.2 Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.* |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[10] (të synuara përmes temës):<br>● Shpjegon veprimet në lidhje me formulat.<br>● Lokalizon vendosjen e formulave në qeli.<br>● Cekë shprehjet aritmetikorë.<br>● Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritja e shumës, e prodhimit etj.). |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: **Bazat e llogaritjeve me formula ( 2 orë mësimore)** |
| Fjalët kyçe: formula, argumenti, operatori, adresimi relativ, adresimi absolut, adresimi i përzier |

| | |
|---|---|
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:<br>Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:<br>● Kupton formulat argumentet dhe operatorët<br>● Shkruan dhe editon formulat në Excel<br>● Mbush qelizat me formula, me të dhëna dhe me vlera numerike<br>● Përdor adresat relative, absolute dhe adresat e përziera<br>● Aplikon formulat në shembuj praktik në shtëpi ose punë, përshembull produktet në shitore ose inventarin në shtëpi | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:<br>Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:<br>● Cek operatorët aritmetik dhe logjik<br>● Shpjegon veprimet në lidhje me formulat<br>● Lokalizon vendosjen e formulave në qeliza<br>● Demonstron mbushjen e qelizave me formula, me të dhëna dhe me vlera numerike<br>● Kupton dallimin në mes adresave relative, absolute dhe të përziera<br>● Kupton funksionet e formulave ne kontekst praktik |

| |
|---|
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Teksti mësimor, kompjuteri, video projektor. |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndër-kurikulare dhe me situata jetësore:<br>Ndërlidhja kurikulare: Matematikë, Gjuhë angleze |

[10] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 5 minuta;*** ***Metoda e punës***

| | |
|---|---|
| **Diskutim**<br>**Pyetje diskutimi:**<br>Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të tregojnë njohuri themelore të matematikës dhe llogaritjeve në Excel.<br>Nxënësit tregojnë për operatorët aritmetik dhe operatorët logjik. | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**<br>Diskutim në dyshe- reflektim<br>3 minuta diskuto në çifte, pastaj për 2 min jep përgjigje.<br>Nxënësit reflektojnë për njohurit për llogaritjet në Excel |

***REALIZIMI I KUPTIMIT*** ***Koha: 25 min;*** ***Metoda e punës***

Mësimdhënësi shpjegon se si shkruhen formulat në Excel, veprimet si mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi dhe si bëhet editimi pas shkrimit të formulës.
Pastaj nxënësve u kërkohet ti plotësojnë tabelat e shembujve me formula




Pastaj shpjegon mbushjen e qelizave me formula, me të dhëna dhe me vlera numerike.
Në vazhdim shpjegon adresimin relativ, absolut dhe të përzier duke bërë dallimin në mes tyre.

**Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**

Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual.
Një pyetje- shumë përgjigje (nxënësit janë të ulur para kompjuterit duke provuar ushtrimet dhe mësimdhënësi do ti vëzhgoj).

**Mbledhja e provave:**

Nxënësit kanë realizuar ushtrimin e dhënë nga mësimdhënësi

Listë kontrolli: fleta e punës me kriteret e suksesit

**Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**

Analizë e listë kontrollit ne realizimin e kritereve të suksesit. Informata kthyese përshkruese/ orientuese aty ku ka nevojë për përmirësim.

***PËRFUNDIMI*** ***Koha: 15 min;*** ***Metoda e punës***

| | |
|---|---|
| **Pyetje përmbyllëse:**<br>● Cilët janë operatorët aritmetik dhe logjik?<br>● Si bëhen llogaritjet në Excel?<br>● Si bëhet shkrimi dhe editimi i formulës? | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse** |

| | |
|---|---|
| • Si mbushen qelizat me formula, me të dhëna dhe me vlera numerike?<br>• Çka janë adresat relative, absolute dhe të përziera?<br>• Çfarë aplikimi kanë këto formula në një kontekst real. psh. shitjet në një dyqan | Nxënësit reflektojnë duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë, përforcojnë njohuritë duke realizuar në praktikë ushtrimet e dhëna nga mësimdhënësi. |
| **Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:<br>• Portofolio<br>• Të gjitha detyrat për temën ruhen në usb.<br>• Plotësohet libri i punës | |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>• Detyrë Shtëpie: Ushtrimet nga libri i punës<br>• Listë kontrolli: Libri i punës i plotësuar dhe sjellja e detyrave me usb ose email. | |
| **Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:<br>Varësisht nga numri i nxënësve në klasë dhe kompjuterëve në dispozicion mund të realizohet njësia mësimore ashtu që të gjithë nxënësit të kenë mundësinë të realizojnë ushtrimet e dhëna nga mësimdhënësi, por nëse nuk kemi kompjuterë të mjaftueshëm, nxënësit ushtrimin do ta ndjekin nëpërmjet video projektorit dhe vetëm disa nxënës do të kenë mundësi të dalin para kompjuterit. | |

## 3.1. Projekti shitorja ime

**Shkolla: Gjimnazi "Xhevdet Doda"** **Komuna: Prishtinë** **Data: ...................**

**Mësimdhënësi/ja: Njomza Selimi**

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna** | **Lënda: TIK** | **Shkalla e kurrikulës: V** | **Klasa: X** |
| Tema[11]: Puna në Excell/ Projekti shitorja ime<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[12]: 10 orë | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>4.2.1. Shpjegon veprimet në lidhje me formulat.<br>4.2.2. Lokalizon vendosjen e formulave në qeli.<br>4.2.3. Cekë shprehjet aritmetikorë.<br>4.2.4. Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritja e shumës, e prodhimit etj.).<br>4.2.5. Përdorë funksione për punën me tekst, funksionet financiare dhe shpjegon rëndësinë e tyre<br>4.2.6. Identifikon zgjidhjen e problemeve gjatë përdorimit të funksioneve. | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[13] (të synuara me përmes temës)***:***<br>**I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**<br>I.3 Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.<br>I.5 Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, ibrar, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.<br>**II Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ**<br>II.1 Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).<br>**III Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm**<br>III.6 Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një ibrary apo detyre të caktuar, të cilat më pas I analizon, I klasifikon dhe I paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[14] (të synuara përmes temës):<br>**2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë**<br>*2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit.* | | | |

[11] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[12] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[13] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[14] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme

| | |
|---|---|
| **4. Përdorimi i TIK-ut për të avansuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.**<br>*4.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe pune hulumtuese* | |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[15] (të synuara përmes temës):<br>4.2.7. Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritja e shumës, e prodhimit etj.).<br>4.2.8. Përdorë funksione për punën me tekst, funksionet financiare dhe shpjegon rëndësinë e tyre | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: Regjistrimi i artikujve në fletën punuese **( 2 orë mësimore )** | |
| Fjalët kyçe: rresht, shtyllë, qeli, fletë punuese etj. | |
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:<br>Në përfundim të orëve të mësimit nxënësi të:<br>● Identifikon rreshtat, shtyllat, qelizat si dhe adresën e qelizave<br>● Inserton, ndryshon dhe fshin të dhënat në tabela të Excel-it<br>● Kërkon dhe zëvendëson përmbajtjen e qelizave | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:<br>● Shpjegon sipërfaqen punuese të Excel-it<br>● Demonstron vendosjen e të dhënave (emrat e autorëve) në tabela të Excel-it, ndryshimin dhe fshierjen e të tyre<br>● Shpjegon kërkimin dhe zëvendësimin e të dhënave |
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit: Kabineti i informatikës i pajisur me kompjuter, internet, videoprojektor. | |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Gjuhë dhe komunikim/ Gjatë përdorimit të paketës së Microsoft office-it (Excell) pjesë e programit janë në gjuhën angleze dhe sigurisht që duhet herë pas herë të përkthehen në mënyrë që të jenë sa më të qarta.<br>Punë hulumtuese/ Kërkimi i autorëve të ndryshëm për regjistrim në fletën punuese. | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |
| ***PJESA HYRËSE*** ***Koha 5 minuta;*** ***Metoda e punës*** | |
| **Pyetje diskutimi:**<br>**Diskutim**<br>Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të tregojnë se çka është rreshti, shtylla dhe qeliza dhe si identifikohen.<br>Nxënësit diskutojnë mbi tipet e të dhënave. | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**<br>Nxënësit nxitën që të flasin dhe të shprehin opinjonin e tyre në lidhje me pyetjen. Varësisht nga përgjigjjet mësimdhënsi e merr informatën mbi nivelin e asaj se çka dinë nxënësit dhe sigurohet të jep informatë kthese mbi atë që u diskutua. |

[15] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| ***REALIZIMI I KUPTIMIT*** ***Koha 25 minuta;*** | ***Metoda e punës*** | | |
|---|---|---|---|
| **Analizim i projektit "Shitorja ime" dhe demsotrim në fletën punuese**<br><br>Nxënësve iu paraqitet një skenar me të cilin do të punohet gjatë tërë praktikimit të paketës së office-it gjegjësisht Excell-it dhe PowrPointit. Skenri do të jetë punë praktike e gjithë klasës meqë ata do ta sistemojnë "Shitorën e tyre" (librarinë për shitjën e librave) në punën me qelitë. Gjatë paraqitjeës së skenarit nxënësve iu kërkohet që brenda orës mësimore për10 minuta të shfletojnë në internet për gjetjen e autorëve që dëshirojnë t'i mbajnë në librarinë për shitje.<br>**Mësimdhësi përdorë tekinikën udhëzues paraprijës për të bërë shpjgimet fillestare brenda Excel-it gjegjësisht fletës punuese**<br>Mësimdhënësi shpjegon se si insertohen të dhënat në tabela të Excel-it, si bëhet navigimi nëpër qeliza, si bëhet ndryshimi dhe fshierja e të dhënave, si anulohen (zhbëhen) dhe përsëritën operacionet prej ruajtjes së fundit.<br>Kësisoji nga nxënësit kërkohet qe secili prej tyre t'I regjistroj nga 5 autorë me librat pëkatëse në librinë punuese.<br><br>Herë pas here msimdhënsi vëzhgon regjistrimet që nxënësit bëjën në fletën punuese dhe jep udhëzime të nevojshme. | **Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**<br><br>Vlerësim i vazhdueshëm individual<br><br>Nxënësit vlerësohen për punën që ata e bëjnë përgjatë hulumtimit të autorëve për librarinë përkatëse si dhe pytjeve që ata i bjënë në lidhje me ndërtimin e të dhënëave përkatëse për librarinë. | **Mbledhja e provave:**<br>Nxënësit hulumtojnë, dhe analizojnë autorët që do t'i mabjnë në "Shitoret e tyre".<br>Arsytushmëria e përzgjedhjës së autorëve përkatës paraqet entuziazimin për punën që nxënësit i pret në arritjen e rezultatve lëndore.<br><br>Puna praktike e regjistrimit të autorëve në fletën punuese. | **Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**<br><br>Praktikimi i regjitrimit të një/dy autorëve nga mësimdhnësi në fletën punuese të shfaqur në ekran për të gjithë nxënësit me projektor, do të ishte informatë kthyese për secilin nxnënës meqë ata do të arrinin të shihnin nëse kanë punuar skatë në regjistrimin e autorëve.<br><br>Përcjellja e punës së nxnësve nga mësimidhënësi mund të bëhet edhe gjatë kohës kur ata regjistrojnë autorët. |

<table>
<tr><td colspan="2">PËRFUNDIMI Koha 15 minuta; Metoda e punës</td></tr>
<tr><td>Pyetje përmbyllëse:<br>Pse zgjodhët këta autor që të jenë pjesë ?<br>A patët ndonjë vështirësi gjatë regjistrimit të autorëve në feltën punuese?</td><td>Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse<br>Nxënësit ftohen në dyshe që t'i vlerësojnë punimet e njëri tjetrit më pas ta komentojnë punën e shoku/shoqës si dhe problemet evetuale që mund t'i kenë pasur.<br>Në fund mësimdhënsi nëse vëren se nxënësit kanë pasur ndonjë sfidë që nuk kanë arritur ta kalojnë edhe pas punës në dyshe, në mënyrë praktike bën zgjidhjen dhe demostrimin e problemit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknikat e vlerësimit të nxënësve:<br>Nxënësit vlerësohen për pjesën e parë të diskutimit për përgjigjjet që ata thonë. Në veçanti vlerësohen për regjistrimin e autorëve në fletën punuese si dhe vlerësimet që i bëjnë njëri tjetrit gjatë pjesë së punës në dyshe.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Detyrat dhe puna e pavarur:<br>Përzgjedhni të gjithë autorët që do të vendosni si klasë që t'i mbani brenda shitorës tuaj: të jenë nga tre autorë të ndryshmë nga secili nxnënës. Të hulutohet dhe të regjistrohen të gjitha veprat e autorëve të përzgjedhur në fletën punuese</td></tr>
<tr><td colspan="2">Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore:</td></tr>
</table>

Krijimi i një biznesi të ri

**Shkolla: Gjimnazi Natyror "Xhavit Ahmeti"** **Komuna: Gjilan** **Data: 10.03.2021**
**Mësimdhënësi/ja: Pajtim Rashiti**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda: TIK** | **Shkalla e kurrikulës: 5** | **Klasa: 10** |
| Tema[16]: Krijimi i një biznesi të ri<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[17]: 8 | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: (Taksonomia e Bloom-it)<br>● ***Përdor*** *pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive ndërmarrëse*<br>● ***Planifikon*** *zhvillimin e një ideje për krijimin e ndërmarrjes*<br>● ***Tregon*** *për qëllimet dhe planifikimet e ndërmarrjes*<br>● ***Dizajnon*** *një biznes përmes modelit canvas (Dizajno komponentet)*<br>● ***Pershkruan*** *qëllimet e një ndërmarrësi*<br>● ***Vlereson*** *idetë ndërmarrëse* | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[18] (të synuara me përmes temës)***:***<br>Kurrikula Bërthamë (fq: 18-19):<br>***1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Komunikues efektiv),***<br>***2. Kompetenca e të menduarit (mendimtar kreativ (krijues dhe kritik)),***<br>***3. Kompetenca e të mësuarit (nxënës i suksesshëm),***<br>***4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (kontribuues produktiv).*** | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[19] (të synuara përmes temës):<br>Kurrikula Bërthamë (fq: 85-86):<br>4.1 Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe pune hulumtuese,<br>4.2 Demonstron shkathësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve,<br>5.1 Prezanton ide kreative për krijimin e një biznesi duke u bazuar në analizën e tregut të punës,<br>7.1 Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacion dhe kërkesa të tregut të punës. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| Njësia mësimore: Zhvillimi i një ideje të biznesit, modeli canvas | | | |
| Fjalët kyçe: biznes, marketing, website, ndërmarrës, dizajn, programim, burime njerëzore. | | | |

[16] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[17] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[18] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[19] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme

Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:

- *Përdor TIK-un dhe platformat e ndryshme për t'u informuar rreth krijimit të një biznesi,*
- *Analizon tregun apo kërkesat për biznesin e ri,*
- *Dallon ndërmarrësinë dhe profesionet e tjera.*

Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:

- ***Hulumto** në internet përmes shfletuesit dhe merr informacione rreth biznes planit Canvas*
- ***Zgjedh** një ide biznesi*
- ***Zgjedh** konfliktet*
- ***Puno** në grup*
- ***Reflekto** kreativitet dhe bëhu komunikativ*
- ***Reflekto** për idenë ndërmarrëse individuale/të grupit rreth krijimit të grafikëve për nxënësit e tjerë*
- ***Krijo** grafik të biznes modelit Canvas*

Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:
**Burimet**: Seminari : Materiale; MMag. Beate tötterström, Osterwald, a. / pigneur, Y. et al. (2010), Business model generation, Frankfurt, new york
**Mjetet**: plan i biznesit i punuar në një program/softuer për prezentim, flipchart, markera, fleta me ngjyrë, fotografi

Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore: Lëndën e Ekonomisë, Matematikës.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 10 minuta;*** ***Metoda e punës: punë në grup, prezantim, pyetje, diskutim.***

**Pyetje diskutimi:**
Mësimdhënësi fillon diskutimin me pyetjen për nxënës:
A do të dëshironit që të bëheni ndërmarrës apo të krijoni një biznes të ri?
Pastaj krijohen grupet të cilat punojnë në idetë e ndërmarrjes apo produktit/shërbimit përkatës.
Qëllimi është hartimi i planit të biznesit Canvas për çdo ndërmarrje.

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**

- Flipchart,
- Markera,
- Letra me ngjyra,
- Fotografi

***REALIZIMI I KUPTIMIT*** ***Koha: 35 minuta;*** ***Metoda e punës***

**Pyetje diskutimi:**

- Grupet përcaktojnë idenë dhe ndajnë detyrat në bazë të komponentëve,
- Dizenjohen dhe plotësohen kutitë e komponentëve,
- Përshkruhen qëllimet me fjalë dhe vizatim.

**Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**
Formularë reflektimi (Feedback, Listë kontrolli për komponentet e modelit



Canvas:

**Mbledhja e provave:**

- Modeli CANVAS i krijuar nga nxënësit




**Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**
Analizë e listës së kontrollit në realizimin e kritereve të suksesit.
Gjatë praktikës nxënësit i mbështet mësimdhënësi me sugjerime dhe ndihmë.
Informata kthyese përshkruese/

| | | | |
|---|---|---|---|
|  | | | orientuese aty ku ka nevojë për përmisim. |

| ***PËRFUNDIMI*** ***Koha: 45 minuta;*** | ***Metoda e punës*** |
|---|---|
| **Pyetje përmbyllëse:**<br>● Çdo grup do të prezantojë PB Canvas dhe nga grupet e tjera do të bëhet vlerësimi dhe diskutimi për punën e grupit që prezanton.<br>● E njëjta gjë do të zbatohet edhe për grupet e tjera gjatë prezantimit të tyre. | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**<br>● Formularë reflektimi (Feedback).<br>● Flipchart. |

**Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:
Fusha kurrikulare Jeta dhe puna për shkak te natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe punës, konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive.

- Hulumton tregun për krijimin e një biznesi të ri,
- Krijoni një plan biznesi në grup.
- Prezanton punimin përmes programeve/softuerëve.platformave për prezantim.

**Detyrat dhe puna e pavarur**:
**Udhëzim**:

- Të shpërndahet materiali i nevojshëm për punimin e një PB Canvas.
- Të përcaktohen tri ndërmarrje me veprimtari të ndryshme.
- Të ndahen në grupe sipas përcaktimit nga nxënësit.
- Grupet marrin detyrat dhe përcaktojnë ndërmarrjen për të cilën do të ndërtojnë një plan biznesi Canvas.

**Detyrat**:

- Pasi të përzgjidhen ndërmarrjet, pjesëmarrësit e grupit përcaktojnë detyrat,
- Komponentët ndahen në përpjesëtim me numrin e pjesëmarrësve në grup,
- Të prezantohen në flipchart detyrat përkatëse sipas grupeve dhe të përshkruhen mënyrat e implementimit të tyre.

**Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:

**Plani i orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Jeta e puna / Lënda: Jeta e puna - Ndërmarrësi Shkalla e kurrikulës: V / Klasa:X | |
| Tema / njësia mësimore:<br>**5.Swot analiza** | Rezultati i të nxënit të temës: Vlerëson rëndësinë e aplikimit të Swot analizës për ndërmmarje |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: ***I.1.1;1.2;1.4;1.6;1.8, II.2.1;2.3;2.4;2.5;***<br>***III.3.1;3.2;3.3;3.6;3.7;3.8 VI. 6.1;6.2;6.5;6.6*** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : ***1:5a. 1:5b; 2 :5; 5a. 5b; 4:5; 5.5; 6-5; 7.5; 7.6; 8.5; 8.6; 9.6*** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Fjalët kyçe: Swot analiza, dobësitë, përparësitë, sfidat, ide, ndërmarrës, hulumtim, kërkesa, biznes, | |
| Rezultatet e të nxënit të lëndës:<br>-Siguron informatën<br>-Përpunon informatën<br>-Krijon<br>ide të reja<br>Kriteret e<br>suksesit:<br>-Tregon rëndësinë e zbatimit të Swot analizës<br>-Përshkruaje procesin e bërjes së Swot analizës | |
| Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuter, video-projektor, internet, fletore për shënime. | |
| Përdorimi i TIK-ut: Interneti,Word, Power point, Prezi. | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Matematika / Arsimimi me TIK dhe mësimi elektronik, Përgaditja për jetë dhe për punë, Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për punë, Arsimimi për ndërmarrësi, Vetëdijësimi për ekonomi, Njohuri themelore financiare | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **E- Pjesa hyrëse**: **5 minuta** Prezantohet tema si dhe kërkohet nga nxënësit të japin mendime rreth asaj që dijnë për Swot analizën. Pse është e rëndësishmë ajo, cka vë në pah, si na ndimon të përmirohemi si kompani, kushduhet ta bëjë Swot analizën etj. | |
| **R- Pjesa kryesore 15 minuta:** Së bashku me nxënësit bëjnë Swot analizën personale, cilat janë përparësitë, mundësitë, sfidat dhe rreziqet tona personale – si mund ti përdorim ato për tu përmirësuar.<br>**R- Pjesa përmbyllëse 10 minuta:**<br>Kërkohet nga nxënësit që të mendojnë dhe diskutojnë me shkoun e bankës rreth Swot analizës së frimës ushtrimore të krijuar në orët e kaluara si dhe të fillojnë plotësimin në fletën A4. | |



Strength(Përparësitë)
Weakness (Dobësitë)
Opportunities(Mundësitë)
Threats(Rreziqet)




Strength(Përparësitë)
Weakness (Dobësitë)
Opportunities(Mundësitë)
Threats(Rreziqet)


LEJOINA KODRA - DIZAJN GRAFIK
• Strength(Përparësitë)
• Weakness (Dobësitë)
• Opportunities(Mundësitë)
• Threats(Rreziqet)


Vesa Reshitaj
Magic Ideas
• Strength(Përparësitë)
• Weakness (Dobësitë)
• Opportunities(Mundësitë)
• Threats(Rreziqet)







## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Shkolla: Gjimnazi i filologjisë "Eqrem Çabej"** **Komuna: Prishtinë** **Data: ......................**
**Mësimdhënësi/ja: Shpresa Hoxha-Behrami**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda:TIK** | **Shkalla e kurrikulës:V** | **Klasa: X** |
| Tema[20]: Karriera Ime<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[21]:<br><br>10 orë mësimore | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br><br>Përdorin TIK-un për të krijuar një llogari në Gmail.com.<br>Shkruajnë dhe dërgon e-mail-e duke zbatuar rregullat për shkrimin e një e-mail-i.<br>Shkëmbejn në mënyrë të sigurt informacionin me të tjerët nëpërmjet e-mail-it.<br>Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës "se çfarë janë të aftë të bëjnë".<br>Shpjegojnë se si mund t'í arrijnë qëllimet për të zhvilluar karrierën.<br>Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë.<br>Tregojnë për azhurnimin/përditësimin e portfolios personale.<br>Përdorin aplikacione të ndryshme për ndërtimin e CV, përzgjedhin formën e duhur të CV-së dhe ndërtojnë përmbajtjen e saj. | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[22] (të synuara me përmes temës)*:*<br>**I.4** Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe të gjuhës së huaj në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.<br>**III.6** Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.<br>**IV.3** Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[23] (të synuara përmes temës):<br>**3. Këshillim dhe orientim në karrierë**<br>3.1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme. | | | |

[20] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[21] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[22] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[23] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme

Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[24] (të synuara përmes temës):

Përdor TIK-un për të krijuar një llogari në Gmail.com

Shkruan dhe dërgon e-mail-e një ose shumë përdoruesve duke zbatuar rregullat për shkrimin e një e-mail-i.

Shkëmben në mënyrë të sigurt informacionin me të tjerët nëpërmjet e-mail-it.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: Hapja e një adrese email-i **( [25]1 orë mësimore)**

Fjalët kyçe: Browser, gmail.com, create acount, e-mail, send, attach, compose., Sing in, Sign out, Upload, Download;

| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore, nxënësi: |
|---|---|
| Në përfundim të orës së mësimit nxënësi do të:<br>● **kupton** pse shërben posta elektronike;<br>● **përshkruan** rrugën për hapjen e një adrese email-i;<br>● **dallon** pjesët përbërëse të një email-i ;<br>● **dergon** dhe merrë email me bashkangjitjen e nje fajlli në një email; | **1. Krijon** një adresë të re e-mail-i në Gmail si: emrimbiemri@gmail.com<br>**2. Analizon** pjesët përbërëse të një email-i<br>**3. Dergon** e-mail tek mësimdhënësi/ja, shoku/shoqja duke bashkëngjit një fajllë |

Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:

Teksti mësimor, njohuritë që nxënësit kanë në lidhje me temen , kabineti i informatikës, internet, videoprojektor.

Linku: accounts.google.com

Shënim: Kjo njësi nuk realizohet nëse nuk ka internet. Mësimdhënësi duhet të sigurohet që të rregullojë qasjen në internet para orës në mënyrë që të mos humb kohë.

Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore

Ndërlidhja kurrikulare:

Lidhet me fushën e gjuhëve dhe të komunikimit: Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përdorimit të postës elektronike, përdor një gjuhë të saktë dhe të qartë në shkrimin e e-maileve.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 5 minuta; Metoda e punës: Diskutim***

| **Pyetje diskutimi:** | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit** |
|---|---|
| Cilat janë mënyrat më të përhapura të komunikimit sot? A keni një adresë e-mail-i? N.q.s po, pse e përdorni atë? | Diskutim në dyshe- reflektim<br>3 minuta diskuto në çifte, pastaj për 2 min jep përgjigje.<br>Nxënësit reflektojn për rendësin e përdorimit të email-it për aq sa kanë njohuri. |

[24] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

[25] Në kushte normale është planifikuar 1 orë mësimore 45’, por në kushte të jashtëzakonshme minutat e planifikuara i zvogëlojm duke ju përshtatur situates.

<table>
<tr><th colspan="4">REALIZIMI I KUPTIMIT Koha 25 min; Metoda e punës: Demonstrim, hulumtim, zbatim në praktikë</th></tr>
<tr>
<td>Pyetje diskutimi:<br>Cilët hapa duhen ndjekur për të hapur një email adresë në gmail.com?<br>Veprimtari praktike-<br>Ndiqen hapat:<br>Si veprojmë për të hapur një adresë në gmail?<br>Në browserin që keni, klikoni<br>gmail.com –<br><br><br><br><br>Kërkohet të plotësoni të dhënat personale:<br><br>Next<br><br></td>
<td>Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve<br><br>Vlerësim i vazhdueshëm individual dhe në grup<br>Nxënësit diskutojnë midis tyre për hapat që ndjekin për krijimin e një adrese e-mail-i.<br>Nxënësit/et diskutojnë rreth rregullave për shkrimin e një e-mail-i<br>Ata argumentojnë përgjigjet e dhëna, duke respektuar dhe plotësuar njëri-tjetrin.<br>Pyetje verifikuese për progresin apo problemet në krijimin e një email adrese.</td>
<td>Mbledhja e provave:<br><br>Punë individuale / Punë në grupe<br>Nxënësit në mënyrë individuale hapin një adresë të re e-mail-i në Gmail, shkruajnë një e-ma-il dhe bashkangjisin:dokument, deshmin e hapjes se emailit dhe dergojn të mësimdhënësi/ja.<br><br>Bashkëbisedim, punë në grupe ,analizojn komponentet përbërëse të email-it.<br></td>
<td>Strategjitë për të siguruar informatën kthyese<br><br>Shqyrtim i emailave të pranuar nga nxënësit.<br>Informata kthyese përshkruese / orientuese aty ku ka nevojë për përmisim.</td>
</tr>
</table>

Plotësojm të dhënat tjera shtesë si:




Pranojm kushtet qe duhet tu përmbahemi gjatë përdorimit dhe kemi krijimin e llogarisë.




(mësimdhënësi/ja i sqaron hapat me videoprojektor).

| *PËRFUNDIMI* *Koha: 15 min; Metoda e punës: reflektim , kuiz* | |
|---|---|
| **Pyetje përmbyllëse:**<br>**Pyetjet e Kuizit**<br>Pse shërben e-mail-i?<br>Cfarë rëndësie ka përdorimi i një email adrese adekuate?<br>Çfarë rregulla zbatohen me rastin e dërgimit të e-mailit?<br><br> | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**<br>**Realizimi i kuizit**<br>(Karriga e autorit ) , Me rroten e fatit (lojë fati në mënyrë elektronike) përcaktohet se cili grup do të fillojë i pari ta paraqesë punën e bërë. Kërkohet një nxënës të dal që të ulet në karrigën e vendosur para nxënësve tjerë dhe të terheqë një pyetje të përgatitur paraprakisht ( pyetjet gjinden në një shportë), nxënënësi terheq pyetjen, përgjigjet dhe e praktikon në kompjuter kuizin e përgatitur nga mësimdhënsja, kështu vazhdohet edhe më nxënës të tjerë, në varshmëri me kohën. |
| **Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:<br>Realizimi i kuizit<br>Portfolio<br>Të gjitha detyrat për temën ruhen në portfolio.<br>Për këtë njësi ne portfolio vendoset :<br>Hapja e një email adrese (dëshmia screenshot në një word dokument/prezantim-hapat e hapjes se një adrese email-i;).<br>● Analiza e pjesëve përbërëse të një email-i | |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>Nxënësit/et pasi të krijojnë një adresë e-maili, të shkruajnë dhe të dërgojnë një e-mail një ose disa përdoruesve dhe të bashkangjisin: dokument, foto , video etj..<br>Analiza e pjesëve përbërëse të një email-i | |
| **Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:<br>**Ana e fortë**- Nxënësi/ja hap adresen e e-mail-it, shkruan dhe dërgon e-mail. Kupton rëndesinë qe ka përdorimi i një emaili adekuat në shkollë, punë...Ai/ajo e përdor lehtësisht internetin ose burime të tjera elektronike për kërkim informacioni dhe mundesia per tu kyqur ne portalin e karrierës Busulla.com.<br>**Ana e dobët**-Klasa duhet të ketë internet per tu kyqyr në email. | |

**Shembuj të detyrave të përfunduara nga nxënësit:**



Krijimi i një email adrese duke përdorur telefonin




*Probleme të shfaqura gjatë krijimit të emailit: Emri i llogarisë kam dashur qe të jetë vetëm <u>aritasadiku@gmail.com</u> mirpo ky emer është i zënë dhe duhet të provojmë emra të tjerë.*



Shembull- Nxënësja ka arritur të hap një email adresë , të dërgojë një e-mail dhe të bashkangjesë dokument.



Shembull- Bashkangjitja e një dokumenti, dergimi i e-mailit.

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Shkolla: Gjimnazi i filologjisë “Eqrem Çabej”** **Komuna: Prishtinë** **Data: ......................**

**Mësimdhënësi/ja: Shpresa Hoxha-Behrami**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda:TIK** | **Shkalla e kurrikulës:V** | **Klasa: X** |
| Tema[26]: Karriera Ime<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[27]:<br><br>10 orë mësimore | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br><br>3.1.1. Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës “se çfarë janë të aftë të bëjnë”.<br>3.1.2. Shpjegojnë se si mund t’í arrijnë qëllimet për të zhvilluar karrierën.<br>3.2.1. Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë.<br>3.2.2. Tregojnë për azhurnimin/përditësimin e portfolios personale.<br>3.2.3. Përdorin aplikacione të ndryshme për ndërtimin e CV, përzgjedhin formën e duhur të CV-së dhe ndërtojnë përmbajtjen e saj. | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[28] (të synuara me përmes temës)*:*<br><br>**III.6** Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.<br>**IV.3** Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.<br>**V.1** Analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[29] (të synuara përmes temës):<br><br>**3. Këshillim dhe orientim në karrierë**<br>3.1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[30] (të synuara përmes temës): | | | |

[26] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[27] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[28] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[29] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme
[30] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| |
|---|
| -Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës "se çfarë janë të aftë të bëjnë".<br>-Shpjegojnë se si mund t'í arrijnë qëllimet për të zhvilluar karrierën.<br>-Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë. |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: **Regjistrimi në portalin e karrierës busulla.com ( [31]1 orë mësimore)** |
| Fjalët kyçe: Busulla.com,njohja e vetvetes,testet e karrierës IVAP, testi i Potencialit, eksplorim i profesioneve |

| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore, nxënësi: |
|---|---|
| Në përfundim të orës së mësimit nxënësi do të:<br>● **kuptoj** pse shërben portali Busulla.com;<br>● **përshkruaj** rrugën për regjistrimin në portalin busulla.com;<br>● **argumentoj** rendësinë që ka portali Busulla.com për karrierën; | **1. hap** llogari në portalin Busulla.com dhe deshmo me prt sc;<br>**2. tregon hapat** për regjistrim në portalin busulla.com;<br>**3. analizon** komponentet përbërëse të portalit; |

| |
|---|
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Teksti mësimor, njohuritë që nxënësit kanë në lidhje me temen , kabineti i informatikës, internet, videoprojektor.<br>Linku: https://busulla.com/<br><br>Shënim: Kjo njësi vështirë realizohet nëse nuk ka internet. Mësimdhënësi duhet të sigurohet që të rregullojë qasjen në internet para orës në mënyrë që të mos humb kohë.<br>Për nxënësit është e rëndësishme të jenë të informuar që platforma është e disponueshme në ueb faqe dhe si aplikacion mobil për pajisjet Android dhe iOS. |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Ndërlidhja kurrikulare:<br>Krijimi i llogarisë kërkon përdorimin e emailit (preferohet emaili zyrtar i shkollës) dhe krijimin e passwordit. |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| ***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 5 minuta;*** ***Metoda e punës: Diskutim*** |

[31] Në kushte normale është planifikuar 1 orë mësimore 45', por në kushte të jashtëzakonshme minutat e planifikuara i zvogëlojm duke ju përshtatur situates.

**Diskutim**
**Pyetje diskutimi:**

Përdorimimi i portaleve online në fushen e arsimit dhe punësimit.
Sa prej jush kanë përdorur portale online?

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**

Diskutim në dyshe- reflektim
3 minuta diskuto në çifte, pastaj për 2 min jep përgjgigje.
Nxënësit reflektojn për rendësin e përdorimit të portaleve online për aq sa kanë njohuri.

***REALIZIMI I KUPTIMIT Koha 25 min; Metoda e punës: Demonstrim, hulumtim, zbatim në praktikë***

**Pyetje diskutimi:**
Cilët hapa duhen ndjekur për të hapur llogari në portalin Busulla.com?
**Veprimtari praktike**
Ndiqen hapat:
H1: Në platformën Busulla.COM mund të qaseni duke shënuar link-un www.busulla.com në URL-në e shfletuesit.
Regjistrimi në platformë mund të bëhet duke klikuar në butonin 

dhe pastaj në link-un Regjistrohu. Në të njëjtën dritare do të arrini edhe nëse klikoni në butonin **Fillo Këtu**, i cili gjendet në mes dhe në fund të faqes fillestare.




Regjistrimi mund të bëhet edhe përmes llogarisë në Google apo Facebook.

**Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**

Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual
Një pyetje- shumë përgjigje (nxënësit janë të ulur para kompjuterit duke provuar regjistrimin).
Pyetje verifikuese për progresin apo problemet në regjistrim.

**Mbledhja e provave:**

**Hulumtim/ Punë në grupe**
Nxënësit hulumtojn, analizojn komponentet përbërëse të portalit.
Bashkëbisedim, punë në grupe

Listë kontrolli: fleta e punes me kriteret e suksesit.

**Listë kontrolli- Fleta e punës me kriteret e suksesit**

**Emri dhe mbiemri i nxënësit:**_______________________________

| Kriteri i suksesit | Po (kam arritur ta përfundoj me sukses) | Jo (nuk kam arritur ta përfundoj) | Koment |
|---|---|---|---|
| **hap llogari në** portalin Busulla.com dhe deshmo me prt sc | | | |
| **trego hapat** për regjistrim në portalin busulla.com; | | | |
| **analizo** komponentet përbërëse të portalit | | | |

**Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**

Listë kontrolli: fleta e punes me kriteret e suksesit, është vendosur paraprakisht në kompjuter tek nxënësit, nxënësit plotësojn në mënyrë elektronike dhe e dergojn me email tek mësimdhënësi.

Analizë e listë kontrollit ne realizimin e kritereve të suksesit. Informata kthyese përshkruese/ orientuese aty ku ka nevojë për përmisim.

H2: kliko tek rubrika regjistrohu




H3: Plotëso të dhënat e kërkuara, konfirmo Regjistrohu dhe hap llogari në portalin Busulla.com.




Pas regjistrimit të suksesshëm shfaqet dritarja e profilit.

***PËRFUNDIMI*** ***Koha: 15 min; Metoda e punës: reflektim***

| **Pyetje përmbyllëse:** | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse** |
|---|---|
| Cilat ishin sfidat për ta hapur një llogari?<br>Cila komponentë e portalit ju zgjoi interesim?<br>Cfarë rëndësie ka portali për nxënësit | Nxënësit reflektojn duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë, përforcojnë njohurit duke realizuar në praktikë hapjen e një llogarie , kyqjen në portalin Busulla.com dhe duke berë një përmbledhje për portalin, rendesin qe ka portali në Orientimin në Karrierë. |

**Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:
Portfolio
Të gjitha detyrat për temën ruhen në portfolio.
Për këtë njësi ne portfolio vendoset :
Regjistrimi në portal (dëshmia screenshot në një word dokument/prezantim).

- Analiza e komponenteve të portalit me shkrim

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Regjistrimi i nxënësit në portal
- Dëshmia e screenshot e regjistrimit, vlerësimi i komponentëve të portalit (reflektim 300 fjalë)
- fleta e punes me kriteret e suksesit, dergimi në mënyrë elektronike tek mësimdhënësi

**Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:
Varësisht nga numri i nxënësve në klasë dhe pajisjeve në dispozicion mund të realizohet regjistrimi i nxënësve. Regjistrimi mund të vonohet nëse nxënësit nuk kanë emaila ose kanë harruar passwordat e tyre. Prandaj si detyrë kërkohet të përfundohet procesi i regjistrimi nëse nxënësit nuk kanë arritur të përfundojnë procesin brenda minuatave të ndarë për të. Edhe diskutimi për komponentët e portalit mund të jetë i shkurtër, por që nxënsit arrijnë të ananlizojnë komponentët individualisht me bërjen e detyrës.

**Deshmi- Regjistrimi i nxënësve në portalin Busulla.com**



























**Listë kontrolli- Fleta e punës me kriteret e suksesit**

**Emri dhe mbiemri i nxënësit: Ariana Leci**

| Kriteri i suksesit | Po (kam arritur ta përfundoj me sukses) | Jo (nuk kam arritur ta përfundoj) | Koment |
|---|---|---|---|
| **hap llogari në** portalin Busulla.com dhe deshmo me prt sc | √ | | Kam arritur të **hap**, llogari në portalin Busulla.com dhe të krijoj deshmi .   |
| **trego hapat** për regjistrim në portalin busulla.com; | √ | | **Kam ndarë punën time me të tjerët, duke treguar** hapat për regjistrimin në portalin busulla.com |
| **analizo** komponentet përbërëse të portalit | √ | | **Kam bërë një analizë për komponentet e portalit, duke dhënë argumente për** rendësinë që ka portali Busulla.com për karrierën . |

**Listë kontrolli- Fleta e punës me kriteret e suksesit**

**Emri dhe mbiemri i nxënësit: Erblina ........................**

| Kriteri i suksesit | Po (kam arritur ta përfundoj me sukses) | Jo (nuk kam arritur ta përfundoj) | Koment |
|---|---|---|---|
| **hap llogari në** portalin Busulla.com dhe deshmo me prt sc | √ | |   |
| **trego hapat** për regjistrim në portalin busulla.com; | √ | | |
| **analizo** komponentet përbërëse të portalit | | √ | **Nuk kam arritur të bëjë një analizë për komponentet e portalit, sepse kam hasur në vështërsi në hapjen e llogarisë ( probleme me e-emailin), por do ta vazhdoj si detyrë shtepie.** |

**ANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

**Shkolla: Gjimnazi i filologjisë "Eqrem Çabej"** **Komuna: Prishtinë** **Data: ......................**

**Mësimdhënësi/ja: Shpresa Hoxha-Behrami**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><th>Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna</th><th>Lënda:TIK</th><th>Shkalla e kurrikulës:V</th><th>Klasa: X</th></tr>
<tr><td>Tema[32]: Karriera Ime<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[33]:<br><br>8 orë mësimore</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br><br>3.1.3. Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës "se çfarë janë të aftë të bëjnë".<br>3.1.4. Shpjegojnë se si mund t'í arrijnë qëllimet për të zhvilluar karrierën.<br>3.2.4. Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë.<br>3.2.5. Tregojnë për azhurnimin/përditësimin e portfolios personale.<br>3.2.6. Përdorin aplikacione të ndryshme për ndërtimin e CV, përzgjedhin formën e duhur të CV-së dhe ndërtojnë përmbajtjen e saj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[34] (të synuara me përmes temës):<br><br>III.6 Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.<br>IV.3 Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.<br>V.1 Analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[35] (të synuara përmes temës):<br><br>3. Këshillim dhe orientim në karrierë<br>3.1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore36 (të synuara përmes temës):<br><br>-Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës "se çfarë janë të aftë të bëjnë".</td></tr>
</table>

[32] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[33] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[34] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[35] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme
[36] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| |
|---|
| -Shpjegojnë se si mund t'í arrijnë qëllimet për të zhvilluar karrierën.<br>-Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë. |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: **Testi i Potencialit në busulla.com ( [37]1 orë mësimore)** |
| Fjalët kyçe: Busulla.com;Testi Potencialit, |

| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore, nxënësi: |
|---|---|
| Në përfundim të orës së mësimit nxënësi do të:<br>● **kuptoj** pse shërben Testi i Potencialit në Busulla.com;<br>● **përshkruaj** rrugën për ralizimin e Testit të Potencialit në portalin busulla.com;<br>● **argumentoj** rendësinë që ka Testi i Potencialit për orientimin në karrierë; | **1. hap** portalin Busulla.com;<br>**2. realizon** Testin e Potencialit në portalin busulla.com;<br>**3. analizon** rezultatet e fituara pas përfundimit të Testit të Potencialit; |

| |
|---|
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br><br>Teksti mësimor, njohuritë që nxënësit kanë në lidhje me temen , kabineti i informatikës, internet, videoprojektor.<br>Linku: https://busulla.com/<br><br>Shënim: Kjo njësi vështirë realizohet nëse nuk ka internet. Mësimdhënësi duhet të sigurohet që të rregullojë qasjen në internet para orës në mënyrë që të mos humb kohë. |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Ndërlidhja kurrikulare:<br>Ralizimi i testeve kërkon posedimin e një llogarie në busulla.com/ përkatësisht posedimin e një emaili. |

[37] Në kushte normale është planifikuar 1 orë mësimore 45', por në kushte tjera minutat e planifikuara i zvogëlojm duke ju përshtatur situates në të cilës gjindemi.

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| ***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 5 minuta; Metoda e punës: “Personale / E Ndërsjellë / Publike” (PNP)*** | |
| **Pyetje diskutimi:**<br><br>Sa prej jush kanë realizuar teste online?<br>Po për testet vetnjohëse të karrierës keni njohuri? | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**<br><br>Teknika “Personale / E Ndërsjellë / Publike” (PNP) Teknikë e VpN-së e cila përdoret ashtu që nxënësi para se ta thotë përgjigjen në mënyrë publike, së pari e diskuton me shokun ose shoqen dhe në fund ia thotë tërë klasës. |

| ***REALIZIMI I KUPTIMIT*** ***Koha 25 min; Metoda e punës: Demonstrim; Hulumtim; Punë individuale dhe në grup*** | | | |
|---|---|---|---|
| **Pyetje diskutimi:**<br>Cilët hapa duhen ndjekur për të realizuar Testin e Potencialit në portalin Busulla.com?<br>**Veprimtari praktike**<br>Ndiqen hapat:<br>H1: Kyqemi në portalin Busulla.com<br>https://busulla.com/busullaime<br><br>H2: Kliko tek paneli -Testet e karrierës-Testi i potencialit.<br><br>H3: Realizo Testin e Potencialit duke u përgjigjur në pyetjet nga përmbajtja e testeve: Gjuhë shqipe; Gjuhë angleze; Matematikë; Detyra Logjike; | **Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**<br><br>Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual<br>Një pyetje- shumë përgjigje (nxënësit janë të ulur para kompjuterit duke ralizuar Testin e Potencialit/ Gjuhë shqipe; Gjuhë angleze; Matematikë; Detyra Logjike;).<br><br>Pyetje verifikuese për progresin apo problemet në ralizimin e testeve. | **Mbledhja e provave:**<br><br>Nxënësit hulumtojn, realizojn testet e karrieres IVAP në portalin Busulla.com.<br>Plotësimi i nivelit të profilit nga 50% në 100%, pas realizimit të testeve.<br><br>Analizojn rezultatet pas përfundimit të Testit të Potencialit.<br>Nga profesionet e sugjeruara bazuar në përgjigjet e dhëna zgjedhin profesionin qe do ta vazhdojn në të ardhmen. | **Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**<br><br>Analizë e listë kontrollit ne realizimin e kritereve të suksesit.<br>Informata kthyese përshkruese / orientuese aty ku ka nevojë për përmisim. |




H4: Analizo rezultatet pas përfundimit të Testeve të Potencialit.
Profesionet e sugjeruara bazuar në përgjigjet tuaj. Niveli i kompletimit tuaj është 100 %.



Bejn krahasimin e nivelit të kerkuar dhe nivelit në të cilin gjinden.




***PËRFUNDIMI*** ***Koha: 15 min; Metoda e punës: Diskutim i përbashkët; Reflektim***

**Pyetje përmbyllëse:**

Cilat ishin sfidat për të realizuar Testin e Potencialit?
Cila nga testet ju zgjoi interesim me të madhë?
Cfarë rëndësie kanë profesionet e sugjeruara bazuar në përgjgjet tuaja?

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**

Nxënësit reflektojn duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë, përforcojnë njohurit duke realizuar në praktikë realizimin e Testin të Potencialit.

**Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:
Portfolio
Të gjitha detyrat për temën ruhen në portfolio.
Për këtë njësi ne porfolio vendoset :
Realizimi i Testit të Potencialit (dëshmia screenshot në një word dokument/prezantim).

- Analiza  me shkrim e profesionit të se ardhmës bazuar në përgjgjet e dhëna në pyetjet e Testit të Potencialit.

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Realizimi i Testit të Potencialit.
- Dëshmia e screenshot e realizimit të Testit të Potencialit, vlerësimi i rendësis se testeve

**Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:

Varësisht nga numri i nxënësve në klasë dhe pajisjeve në dispozicion mund të realizohet Testi i Potencialit. Realizimi i testeve mund të vonohet nëse nxënësit nuk kanë emaila ose kanë harruar passwordat e tyre. Prandaj si detyrë kërkohet të përfundohet procesi i regjistrimi nëse nxënësit nuk kanë arritur të përfundojnë procesin brenda minuatave të ndarë për të. Edhe diskutimi për komponentët e portalit mund të jetë i shkurtër, por që nxënsit arrijnë të realizojn Testin e Potencialit,analizojnë rezultatet  pas përfundimit individualisht me bërjen e detyrës.

**Shembuj të detyrave të përfunduara nga nxënësit:**

**Analizë pas realizimit të testeve të potencialit- Po,shohim se tek lënda e gjuhes shqipe niveli i kërkuar për profesionin e zgjedhur eshte 3 mirpo kam arritur një nivel me shumë, tek gjuha angleze kam arritur 3 nivele me lart sa qe është kërkuar, ndersa tek matematika gjindem në nivelin e kërkuar, të detyrat logjike niveli i kërkuar është niveli 3 por kam arritur tek  niveli më i lartë,  pra me bën të kuptoj se jam e përgatitur për këtë profesion!**

Profesioni Kiropraktikues/e



| Testi | Pikët e arritura në testin e potencialit | Level 1 | Level 2 | Level 3 | Level 4 | Level 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjuhë Shqipe | 17.33/25 | | | | | |
| Gjuhë Angleze | 19.0/28 | | | | | |
| Matematikë | 13.5/26 | | | | | |
| Detyra logjike | 8.0/9 | | | | | |




Profesioni Radiolog/e

**Refelektim-Rezultatet e testeve janë shumë efikase për ne dhe na ndihmojnë që ne të testojmë veten se sa ne kemi njohuri rreth këtyre lëndeve. Unë e kuptova nga këto teste se duhet të punoj me teper në gjuhë shqipe dhe matematikë sepse nuk jam në nivelin e kërkuar për profesionin tim të përzgjedhur.**



## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Shkolla: Gjimnazi i filologjisë "Eqrem Çabej"** **Komuna: Prishtinë** **Data: ......................**
**Mësimdhënësi/ja: Shpresa Hoxha-Behrami**

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda:TIK** | **Shkalla e kurrikulës:V** | **Klasa: X** |
| Tema[38]: Ndikimi i Wifi në shëndetin e njerëzve<br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[39]:<br><br>3 orë mësimore | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br><br>Tregojnë rëndësinë e pajisjeve të teknologjisë Informative në shëndetin e njeriut<br>Analizon të dhënat në rastet nga jeta e perditëshme dhe paraqet grafikisht të dhenat duke shfrytezuar teknologjine. | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[40] (të synuara me përmes temës)*:*<br>**I.3.** Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.<br>**I.9.** Përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informatave të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.<br>**III.6** Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.<br>**VI.9** Përshkruan (në formë verbale ose të shkruar) mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informatave në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[41] (të synuara përmes temës):<br><br>RNF:9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit<br>9.1. Tregon kujdes për mjedisin e punës dhe arsyeton rolin e teknologjisë në ruajtjen e ambientit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[42] (të synuara përmes temës)<br><br>Identifikon burimet e të dhënave dhe mbledh informacione për WIFI-në<br>Diskuton me moshataret e vetë për ndikim të WIFI-s në shëndetin e nxënësve<br>Shpjegon për rreziqet nga përdorimi i WIFI-s | | | |

[38] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[39] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[40] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[41] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme
[42] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| | |
|---|---|
| Tregojnë rëndësinë e pajisjeve të teknologjisë Informative në shëndetin e njeriut<br>Përgatit pyetësor për temën<br>Përgadit planin e vrojtimit<br>Hulumton për efektet negative<br>Arsyeton në mënyrë efektive gjetjet e hulumtimit<br>Dallon informatat e besueshme prej atyre jo të besueshme<br>Analizon të dhënat në rastet nga jeta e perditëshme dhe paraqet grafikisht të dhenat duke shfrytezuar teknologjine. | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Ndikimi i WiFi-së në shëndetin e komunitetit tonë ( [43]3 orë mësimore)** | |
| Fjalët kyçe: WiFi, Wireless, WLAN | |
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore<br><br>Në përfundim të orës së mësimit nxënësi do të:<br>● **Identifikon** përparsit dhe mangësit e WiFis<br>● **Ndërgjegjësohet** dhe është aktiv në mbrojtjen e vetes dhe shokëve nga rreziku që paraqet përdorimi i pakontrolluar i WiFi-së<br>● **Kombinon** idetë për të krijuar një ide të re për vetëdijësimin e të rinjëve rreth përdorimit të Wi Fi-së | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore, nxënësi:<br><br>1. **Hulumton** efektet shkencore Wifi në shëndetin e njërzve<br>2. **Diskuton** me moshataret e vetë për ndikim të WIFI-s në shëndetin e nxënësve<br>3. **Shpjegon** për efektet pozitive dhe negative;<br>4. **Sugjeron** moshatarët e tij dhe të tjerët se si të përdorin paisijet teknologjike në mënyre të sigurt. |
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Teksti mësimor, njohuritë që nxënësit kanë në lidhje me temen , kabineti i informatikës, telefon, internet, videoprojektor.<br>Përdorin kamera, skaner ose aparat fotografik dixhital për të treguar shumë foto tërheqëse dhe të dobishme për projektin.<br>Burime nga Inerneti:<br>Effect of WiFi on Seeds?<br>Busulla.com<br>https://www.youtube.com/watch?v=Oi-mXf-uufk<br>Dirt Cheap DIY EMF Protection for Your Cell Phone<br>https://www.youtube.com/watch?v=AJwK_npUpbk<br>Wireless Radiation and DC Voltage Exposure Effects on Plants and Humans<br>https://www.youtube.com/watch?v=RLBu-o5DYZU<br>Are there dangers in sleeping next to a Wi-Fi router<br>https://www.youtube.com/watch?v=DCMZLRGBwEY_etj. | |

[43] Në kushte normale është planifikuar 1 orë mësimore 45’, por në kushte të jashtëzakonshme minutat e planifikuara i zvogëlojm duke ju përshtatur situates.

| |
|---|
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore<br>Ndërlidhja kurrikulare:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Shkencat e natyrës: Fizika, Psikologjia etj.. |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| ***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 5 minuta;*** ***Metoda e punës: Diskutim*** |

| **Pyetje diskutimi:** | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit** |
|---|---|
| Kërkohet nga nxënësit qe të paraqesin telefonat e tyre mobil, smartphonet, të tregojn se sa prej tyre janë të kyqur në internet përmes WiFi-së.<br>Vazhdojm me pyetjen shtytëse:<br>Sa po e dëmton Wifi shëndetin tonë? | Nga diskutimi arrimë ta marrim informaten kthyese se çfarë dine dhe çfare nuk dine nxënësit për efektet negative të Wifi-së. |

***REALIZIMI I KUPTIMIT*** ***Koha 25 min; Metoda e punës: Diskutim, hulumtim, Punë në dyshe***

| Pyetje Diskutimi<br>**Ndërtimi i njohurive të reja. (vëzhgo-analizo-diskuto)** | **Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve** | **Mbledhja e provave:** | **Strategjitë për të siguruar informatën kthyese** |
|---|---|---|---|
| Shfaqja e nje videoje të shkurter…(01.50 sekonda)<br>Are there dangers in sleeping next to a Wi-Fi router<br>https://www.youtube.com/watch?v=DCMZLRGBwEY<br><br>Pas shiqimit të videos, hapet diskutimi për efektet pozitive dhe negative të WiFi-së. | Nxënësit lexojn literaturen nga libri, hulumtojn përmes internetit për efektet shkencore Wifi në shëndetin e njërzve. | **Hulumtim/ Punë në dyshe**<br><br>Nxënësit/et duke u nisur nga përvoja vetjake e përdorimit të WiFi-së, nga hulumtimi qe arrijn ta bejnë gjatë orës mësimore, ndërtojnë një diagramë Venn-i ku vendosin disa pika që i konsiderojnë si anë pozitive dhe anë negative të përdorimit të WiFi-së.<br><br>Mësimdhënësi/ja e plotëson këtë diagramë më njohuri të reja. | Nxënësit në dyshe, ndajnë punen e tyre me shoku/shoqen, pas analizimit të punës se shoku/shoqes realizojn vlersim të ndërsjellë. Fajllin vlersimi i ndërsjellë, e percjellin përmes emailit tek shoku/shoqëja qe vlerësojn dhe mësimdhënësi.<br><br>**Vlerësimi i ndërsjellët**<br>Emri i nxënësit që e vlerëson shokun/shoqen:<br>Emri i nxënësit që vlerësohet nga shoku/shoqja:<br><br>(Dy gjera te vlefshme dhe një koment për përmirësi<br>Une vlerësoj punën e bërë të shokut/shoqes<br>•<br>•<br>;) |

<table>
<tr><td colspan="2">PËRFUNDIMI Koha: 15 min; Metoda e punës: reflektim</td></tr>
<tr><td>Pyetje përmbyllëse:<br><br>• Sa arritet të Identifikoni përparsit dhe mangësit e WiFi-s?<br>• A paraqet rrezik përdorimi i pakontrolluar i WiFi-së?<br>• Keni ndonje ide të re për vetëdijësimin e të rinjëve rreth përdorimit të Wi Fi-së?</td><td>Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse<br><br>Nxënësit reflektojn për ndikimin e WiFi-s në shëndetin e njeriut, shpjegojn efektet pozitive dhe negative. Ndajn me klasën vlerësimin e realizuar për shoku/shoqen, argumentojn vlerësimin qe e kanë realizuar.<br>Jepin sygjerime si të përdorin paisijet teknologjike në mënyre të sigurt.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknikat e vlerësimit të nxënësve:<br>● Mësimdhënësi/ja vlerëson gjatë gjithë kohës, duke u kujdesur për çdo përgjigje të kërkesave të ushtrimeve, mendimin kritik, imagjinatën dhe bashkëpunimin.<br>● Vlerësim i ndërsjellë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Detyrat dhe puna e pavarur:<br>Hulumton efektet shkencore Wifi në shëndetin e njërzve,<br>Harton pytësori në formë elektronike,<br>Analizon statistikat për dy shkolla ( SHMU, SHML),<br>Realizohen intervista me ekspert lëndor,<br>Krijimi i broshurave,<br>Krijimi i sekuencave filmike ( Video)<br>Prezantim para audineces ( Prezi, PowerPoint),<br>Publikon në Internet (faqen e shkollës, youtube…).</td></tr>
<tr><td colspan="2">Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore:<br>Ana e fortë- Nxënësit mësojnë për ndikimin e WIFI-së në shëndetin e njeriut dhe përmes burimeve në internet, studimeve të ndryshme, programeve softuerike e të dhënave të tjera ata zhvillojnë njohuritë, qëndrimet dhe shkathtësitë, duke realizuar një fushatë vetëdijesuese për zhvillim të qëndrueshëm. Pika e forte e kësaj njësie mësimore është përdorimi i teknologjisë në mënyrë të kontrolluar. Videot, fotot e ndikimit të Wi Fi-së në komunitetin tonë mund të stimulojnë diskutim në klasë dhe kërkim të informacionit të mëtutjeshëm në shtëpi .<br>Ana e dobët-Klasa duhet të ketë internet të mirë për të lëshuar videot dhe të ketë autoparlant.<br>Përmes një fushate të informimit, nxënësit do të vetëdijësohen rreth përdorimit të WIFI-së, mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informatave në mënyrë të përgjegjshme dhe do të argumentojnë domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë dhe reduktimit të kohës së përdorimit të internetit.<br>Të bëjn zgjidhje të bazuara në informata dhe në përvoja të drejta për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien nga rreziqet e ndryshme, ekspozimit të tepruar të valëve elektromagnetike.</td></tr>
</table>

## Shembuj nga puna e nxënësve







**Vlerësimi i ndërsjellët**

Emri i nxënësit që e vlerëson shokun/shoqen:

A.H

Emri i nxënësit që vlerësohet nga shoku/shoqja:

B. G

(Dy gjera te vlefshme dhe një koment për përmirësim)

| Une vlerësoj punën e bërë të shokut/shoqes |
|---|
| • Ka sqaruar mire efektet pozitive, ka shkruar 4 paragrafë, ku ka cekur përmes WiFi-së mund të kryhen punë të ndryshme. |
| • Ka perfshirë mirë efektet negative, informacioni i dhënë është i qartë. |
| ;) Dizajn sa më pak, rëndësi ka të vrehet teksti i shkruar. |

**Vlerësimi i ndërsjellët**

Emri i nxënësit që e vlerëson shokun/shoqen:

A.V

Emri i nxënësit që vlerësohet nga shoku/shoqja:

S.S

(Dy gjera te vlefshme dhe një koment për përmirësim)

| Une vlerësoj punën e bërë të shokut/shoqes |
|---|
| • Punimi ka informacione te sakta dhe shihet qe eshte rezultat i hulumtimit te mirëfillt |
| • I kushton vëmendje punës që bënë dhe ka ide të ndryshme |
| ;) Për përmirsim do doja qe të ishte më e përpikte me drejtshkrim, dhe nuk ka realizuar të përbashktat. |

**Realizim i detyrave dhe punë e pavarur e nxënësve**

**Produktet finale të dala nga realizimi i projektit**




**Intervistat e realizuara nga nxënësit me ekspert të fushave të ndryshme**

- Intervistë me Visar Sadikun- Specialist i psikologjis klinike dhe psikoterapis
- Intervistë me psikologen: Diellza Sopjani, profesoreshë në shkollën " Eqrem Çabej"
- Intervistë me psikologen Fatime Fejzullahu
- Intervistë me Specialisten e psikologjis: Vlora Pllana
- Intervistë me sociologun Ferdi Kamberi
- Intervistë me profesorin e Fizikës: Ahmet Spahiu
- Intervistë me Dr. Ardiana Makolli
- Intervistë Oftamologun Dr. Ardian Selmaxhaj

Bleona Gashi X4
Intervist me doktore

Blearta Ukëhaxhaj
X13 Intervist me prof

Olta Gashi X6
Intervist me oftamol

Melisa Selimi X6
Intervist me psikolo

Erëza Ajeti -
Intervist me psikolo

| | |
|---|---|
|  |  |
| **Prezantim para audinecës ( Prezi, PowerPoint)-** Ndikimi i Wifi-së, Prezantimi.pptx | **Krijimi i Broshurave-** Agnesa Bajgora X4 Broshurë.wmv |
| **Pjesa skenike : Ndikimi i WiFi-së në shëndetin e komunitetit tonë** Sekuenca filmike- Ndikimi i Wi Fi-së në | |
| **Projekti "Ndikimi i WiFi-së në shëndetin e komunitetit tonë" u shfaq në nivel shkolle, pjesëmarrës: menaxhmenti i shkollës, mësimdhënës, nxënës, prindër.** | |



Komunikimi Elektronik

**Shkolla: Gjimnazi “Gjon Buzuku”** **Komuna: Prizren** **Data: ...........**
**Mësimdhënësi/ja: Lamir Shkurti**

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda:TIK** | **Shkalla e kurrikulës:V** | **Klasa: XI** |
| Tema[44]: Komunikimi elektronik<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[45]:<br><br>4 orë mësimore | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>• Aplikon mundësitë e reja që ofron komunikimi elektronik duke përdorur teknologji informative të ndryshme dhe aplikacione të ndryshme, në krijimin e mesazheve, menaxhimin e tyre dhe në shkëmbimin me të tjerët.<br>• Demonstron shkathtësi në organizimin dhe menaxhimin e informacioneve në komunikimin elektronik. | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[46] (të synuara me përmes temës)***:***<br>**I.1** Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.<br>**I.9.** Përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informatave të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.<br>**III.6.** Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.<br>**VI.9** Përshkruan (në formë verbale ose të shkruar) mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informatave në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[47] (të synuara përmes temës):<br>**2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë**<br>*2.1 Demostron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, porfesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit.*<br>***3.* Këshillim dhe orientim në karrierë**<br>*3.1 Ndërlidh njohuritë dhe shkathtësitë personale me nevojat e tregut të punës.*<br>**4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme**<br>*4.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe pune hulumtuese.*<br>*4.2 Demonstron shkathësi në përdorimin e aplikacioneve.* | | | |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[48] (të synuara përmes temës):<br>● Përdorë aplikacione të ndryshme, në krijimin e mesazheve, menaxhimin e tyre dhe në shkëmbimin me të tjerët. | | | |

[44] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[45] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[46] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[47] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme
[48] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| | |
|---|---|
| ● Demonstron shkathtësi në organizimin dhe menaxhimin e informacioneve në komunikimin elektronik. | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Menaxhimi i emailave (Startimi, konfigurimi, Leximi, përgjigja dhe përcjellja e email-ave) ( 1 orë mësimore)** | |
| Fjalët kyçe: Outlook, e-mail, reply, forward. | |
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:<br>Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:<br>● Aplikon mundësitë e reja që ofron komunikimi elektronik duke përdorur teknologji informative të ndryshme dhe aplikacionin Outlook.<br>● Shpjegon dritaren kryesore të Outlook-ut.<br>● Demonstron shkathtësi në leximin, krijimin e mesazheve dhe menaxhimin e tyre.<br>● Demonstron shkathtësi në shkëmbimin(përgjigjja dhe përcjellja) e mesazheve me të tjerët. | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:<br>Në përfundim të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë:<br>● Starton, mbyll dhe konfiguron programin Outlook<br>● Identifikon elementet e dritares së Outlook-ut<br>● Praktikisht lexon dhe krijon mesazhe.<br>● Praktikisht shkëmben mesazhe me të tjerët |
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Teksti mësimor, kompjuteri, video projektor. | |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Ndërlidhja kurrikulare: Gjuhë angleze | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |
| ***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 5 minuta;*** ***Metoda e punës*** | |

**Diskutim**

Mësimdhënësi tregon qëllimin e përdorimit të programit Outlook. Pasi që supozohet se nxënësit kanë njohuri paraprake për gjërat që do të shpjegohen dhe janë shumë të ngjashme me ato të punuara më herët në njësinë mësimore paraprake, profesori paraqet nëpërmjet projektorit 2 ose 3 ngjarje (psh. fotografi dhe tekste) nxënësit vijnë para kompjuterit dhe vendosin një numër në vendin që mendojnë se duhet të jetë, Pasi klasa të ketë rënë pak a shumë në një mendje me renditjen, profesori kërkon leximin e tekstit për të parë edhe në tekst a është e njëjta renditje sikurse ajo që kanë bërë nxënësit.



1.Shiriti i titullit
2.Shiriti i menysë - Ribbon
3.Shiriti i statusit
4.Regjistri File
5.Shiriti i veglave për qasje të shpejtë
6.Butonat e sistemit operativ Windows 7
7.Butonat për kontrollim të pamjes së dokumentit
8.Vegla Zoom
9.Hapësira Paneli i navigimit
10.Lista e mesazheve

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**

Nxënësit diskutojnë dhe japin përgjigje.

***REALIZIMI I KUPTIMIT  Koha: 25 min;  Metoda e punës***

| | | | |
|---|---|---|---|
| Nxënësit do të lexojnë në heshtje tekstin, deri në momentet e përcaktuara nga profesori, për të nxjerrë provat që tregojnë nëse parashikimet e tyre janë të sakta apo jo duke i praktikuar ato në kompjuter. Këto veprime përsëriten derisa teksti të mbarojë.<br>Pjesa e konfigurimit të e-mailit, dërgimi dhe përcjellja e email-it do të shpjegohet nëpërmjet prezantimit me anë të sllajdeve dhe në mënyrë praktike. | **Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**<br><br>Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual<br>Një pyetje- shumë përgjigje (nxënësit janë të ulur para kompjuterit duke provuar konfigurimin, dërgimin dhe përcjelljen e emailave).<br>Pyetje verifikuese për progresin apo problemet në konfigurim, dërgim dhe përcjellje të emailave. | **Mbledhja e provave:**<br><br>Nxënësit kanë realizuar ushtrimin e dhënë nga mësimdhënësi<br><br>Listë kontrolli: fleta e punës me kriteret e suksesit | **Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**<br><br>Analizë e listë kontrollit ne realizimin e kritereve të suksesit.<br>Informata kthyese përshkruese/ orientuese aty ku ka nevojë për përmirësim. |

| | |
|---|---|
| ***PËRFUNDIMI*** ***Koha: 15 min;*** ***Metoda e punës*** | |
| **Pyetje përmbyllëse:**<br>Nxënësit bashkohen në dyshe dhe tregojnë realizimin praktik të pyetjeve para të tjerëve si përmbledhje për njësinë mësimore.<br>1. Shpjegon qëllimin e përdorimit të programit Microsoft Outlook<br>2. Si startohet dhe mbyllet programin Outlook<br>3. Shpjegoni elementet kryesore të dritares së Outlook-ut<br>4. Praktikisht si konfigurohet një e-mail në Outlook<br>5. Praktikisht të tregohet si lexohen, dërgohen, përgjigjen dhe përcjellën email-at. | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**<br>Nxënësit reflektojnë duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë, përforcojnë njohurit duke realizuar në praktikë ushtrimet e dhëna nga mësimdhënësi. |
| **Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:<br>Portofolio<br>Të gjitha detyrat për temën ruhen në usb.<br>Plotësohet libri i punës | |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br><br>• Detyrë Shtëpie:<br>    • Ushtrimet nga libri i punës,<br>    • Shkrimi i një emaili duke përdorur outlook dhe gmail,<br>    • Krahasimin e programit outlook me gmail ose hotmail.<br><br>• Listë kontrolli: Libri i punës i plotësuar dhe sjellja e detyrave me usb ose email. | |

**Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:
Fillimisht kabineti duhet të jetë i pajisur me internet dhe nxënësit duhet të kenë nga një llogari të gmail-it apo Outlook-ut. Varësisht nga numri i nxënësve në klasë dhe kompjuterëve në dispozicion mund të realizohet njësia mësimore ashtu që të gjithë nxënësit të kenë mundësinë të realizojnë ushtrimet e dhëna nga mësimdhënësi, por nëse nuk kemi kompjuterë të mjaftueshëm, nxënësit ushtrimin do ta ndjekin nëpërmjet video projektorit dhe vetëm disa nxënës do të kenë mundësi të dalin para kompjuterit.

Projekti: Baza e të dhënave -Fakultetet

**Shkolla: Gjimnazi “Xhevdet Doda”** **Komuna: Prishtinë** **Data: ......................**

**Mësimdhënësi/ja: Violina Asllani**

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna** | **Lënda: TIK** | **Shkalla e kurrikulës: V** | **Klasa: XI** |
| Tema: Shfrytëzimi i aplikacionit-baza e të dhënave<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim: 17 orë | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>• Demonstron plotësimin e formularëve elektronik duke dhënë informacione rreth rëndësisë së tyre për secilën fushë të formularit.<br>• Dallon anët pozitive dhe negative të internetit duke marrë parasysh zhvillimin e tyre personal.<br>• Identifikon virusët e ndryshëm në internet duke pasur parasysh rrezikun e tyre dhe jep zgjidhje për mbrojtjen e të dhënave nga virusët.<br>• Demonstron nëpërmjet punës me projekte se si funksionon mënyra e nënshkrimit digjital.<br>• Aplikon mundësitë e reja që ofron komunikimi elektronik duke përdorur teknologji informative të ndryshme dhe aplikacione të ndryshme, në krijimin e mesazheve, menaxhimin e tyre dhe në shkëmbimin me të tjerët.<br>• Demonstron shkathtësi në organizimin dhe menaxhimin e informacioneve në komunikimin elektronik.<br>• Shpjegon, ndërton dhe planifikon bazë të të dhënave duke identifikuar operacionet themelore.<br>• Demonstron ndërtimin e një tabele dhe përdor tipet e ndryshme të të dhënave në tabelë dhe dallon tipet e ndryshme të të dhënave duke identifikuar rëndësinë dhe përdorimin e tyre në fusha të caktuara.<br>• Tregon rëndësinë e përdorimit të çelësit primar dhe vendosjen e tij në tabela.<br>• Demonstron përdorimin e opsionit Sort dhe Filter duke i paraqitur të dy opsionet.<br>• Demonstron krijimin e lidhjeve në mes të tabelave të ndryshme.<br>• Shpjegon për mundësitë e llogaritjeve brenda pyetësve. | | |

| | |
|---|---|
| | • Përshkruan ndërtimin  e formularëvedhe demonstron dizajnimin e llojeve të ndryshme të formularëve duke bërë dallimin mes tyre.<br>• dentifikon objektet kontrolluese duke dhënë informacione rreth rëndësisë dhe sistemimit të tyre në formular.<br>• Demonstron vendosjen e objekteve kontrolluese.<br>• Shpjegon vetitë e labelave dhe pullat komanduese.<br>• Demonstron dizajnimin e raporteve në dy mënyra: duke përdorur rrugën nëpërmjet magjistarit dhe elementeve kontrolluese. |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara me përmes temës):

**I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**

I.1 Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.

I.2 Lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhën amtare dhe/ose në gjuhë angleze apo gjuhë tjetër të huaj, në lëndë të ndryshme mësimore dhe u përgjigjet drejt pyetjeve të shtruara për kontekstin e tekstit të lexuar, mësimet e marra dhe mënyrën e prezantimit/interpretimit para të tjerëve.

I.3 Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.

**II Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ**

II.1 Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).

**III Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm**

III.2 Shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja.

III.6 Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.

Rezultatet e të nxënit për RM të fushës (të synuara përmes temës):

1.2. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë në mënyrë individuale dhe në grup.

2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit.

4.1. Analizon disa nga përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte hulumtuese dhe në punë

8.1. Përdor multimediat për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.

| |
|---|
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore (të synuara përmes temës):<br>17. Shpjegon, ndërton dhe planifikon bazë të të dhënave duke identifikuar operacionet themelore.<br>18. Demonstron ndërtimin e një tabele dhe përdor tipet e ndryshme të të dhënave në tabelë dhe dallon tipet e ndryshme të të dhënave duke identifikuar rëndësinë dhe përdorimin e tyre në fusha të caktuara.<br>19. Tregon rëndësinë e përdorimit të çelësit primar dhe vendosjen e tij në tabela. |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: Planifikimi, ndërtimi dhe ruajtja e bazës së të dhënave |
| Fjalët kyçe: Grupim i të dhënave, tabela, lidhje, çelës primar |

| | |
|---|---|
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:<br><br>Në përfundim të orëve të mësimit nxënësi të:<br>Kupton rëndësinë e menaxhimit të të dhënave.<br>Vë në pah rëndësinë e përdorimit të Access-it në krahasim me aplikacionet e tjera të njohura.<br>Planifikon databazën e tij të<br>parë. | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:<br><br>Krahason dallimet që ofron paketa e Office-it(Excell me Access).<br>Përcakton temën për krijimin e databazës së tij/ saj të parë.<br>Analizon rëndësinë që ka krijimi i data bazave për qasje në informata. |

| |
|---|
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit: Projektori, materiali i grumbulluar nga mësimdhënësi, Materialet që nxënësit kan prëgaditur vitin qe shkoi ne kuadër të projekteve individuale në orientimin në karrierë, kompjuterët personal |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Gjuhë angleze/Pragramet e paketës së Office-it (Accesi),<br>Gjuhë shqipe/ Përzgjedhjet e tabelave përkatëse me të dhëna<br>Situata jetësore/ Inofmrata reale të integrara në bazën e të dhënëave |

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| **PJESA HYRËSE** **Koha 10;** **Metoda e punës** | |

**Pyetje diskutimi:**

**Demostrim**

Ora fillon me prezantimin e të gjitha materialeve që nxënësit kan grumbulluar gjatë vitit që shkoi në kuadër të orientimit në karrierë dhe çasjes në informacion. Projekti ka pasur për qëllim shfrytëzimin e Excel-it, menaxhimin dhe grumbullimin e të dhënave të ndryshme në tabela të ndryshme si dhe hulumtimin mbi univerisitetet që operojnë në Kosovë. Në kuadër të pikës së fundit, nxënësit kan marrur përsipër një universitet, kan gjetur të gjitha drejtimet e atij universiteti, mësimdhënësit që ligjërojnë dhe nivelin e tyre akademik. Me ndihmën e mësimdhënësit, ato të dhëna janë vendosur nëpër tabela .

Drejtimet | Mesimdhenesit | Universitetet

| IDUniversiteti | EmriUniversitetit | Lokacioni | UniversitetShteteror/Kolegj | Click to Add |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 2 | Fakulteti i Shkencave Matemaiko Natyrore | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 3 | Fakulteti Filologjik | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 4 | Fakulteti Juridik | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 5 | Fakulteti Ekonomik | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 6 | Fakulteti Ndertimtarise dhe Arkitektures | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 7 | Fakulteti i Ingjinierise Elektrike Kompjuterike | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 8 | Fakulteti i Ingjinierise Mekanike | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 9 | Fakulteti i Mjeksise | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 10 | Fakulteti i Arteve | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 11 | Fakulteti i bujqesise dhe Veterinarise | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 12 | Fakulteti i Xhehtarise dhe Metalorgjise | Mitrovice | Universiteti i Prishtines | |
| 13 | Fakulteti i Kultures Fizike | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 14 | Fakulteti i edukimit | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 15 | Fakulteti i shkencave te aplikuara | Prishtine | Universiteti i Prishtines | |
| 16 | Gjilani | Gjilan | Kolegj | |
| 17 | Universiteti per Biznes dhe Teknologji | Prishtine | Kolegj | |
| 18 | AAB | Prishtine | Kolegj | |
| 19 | Amerikan University Of Kosova | Prishtine | Kolegj | |
| 20 | Dardania | Prishtine | Kolegj | |
| 21 | Universum | Prishtine | Kolegj | |
| 22 | Iliria | Prishtine | Kolegj | |
| 23 | Fama | Prishtine | Kolegj | |
| 24 | Pjeter Budi | Prishtine | Kolegj | |

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**

**Vlerësim individual**

Nxënësit vlerësohen për vazhdimin e paraqitjës së të dhënave në tabela pas demostrimit të mësimdhënësit. Msimdhënësi sigurohet të jep informatë ktheyse për punën që e bjënë nxënësit në tabela si dhe herë pas herë bën ndërhyrje udhëzuese nëse ndonjëri nga nxënësit nuk arrinë ta bëj paraqitjën e tabelave.

| IdDrejtimi | EmriDrejtimit | IdUniversite | Niveli | Click to Add |
|---|---|---|---|---|
| 101 | Departamenti i Punës Sociale | 1 | Ba | |
| 102 | Departamenti i Shkencave Politike | 1 | Ba | |
| 103 | Departamenti i Psikologjisë | 1 | Ba | |
| 104 | Intigrime Evropiane dhe Administrat Publike | 1 | Ba/Ma | |
| 105 | Departamenti i Sociologjisë | 1 | Ba/Ma | |
| 106 | Departamenti i Filozofië | 1 | Ba/Ma | |
| 107 | Departamenti i Historisë | 1 | Ba/PhD | |
| 108 | Histori Koha e Re | 1 | Ma | |
| 109 | Psikologji Shkollore dhe Keshillim | 1 | Ma | |
| 110 | Departamenti i Antropologjisë | 1 | Ma | |
| 111 | Politike nderkombetare | 1 | Ma | |
| 112 | Psikologji klinike dhe shendeti | 1 | Ma | |
| 113 | Arkivistike | 1 | Ma | |
| 201 | Matematikë e pergjithshme | 2 | b/m | |
| 202 | Matematikë financiare në banaka dhe sigurime | 2 | b | |
| 203 | Shkenca kompjuterike | 2 | b/m | |
| 204 | Matematikë arsimore | 2 | b/m | |
| 205 | Fizikë arsimore | 2 | b/m | |
| 206 | Fizikë e pergjithshme | 2 | b/m | |
| 207 | Kimi | 2 | b | |
| 208 | Kimi inxhinierike | 2 | b | |
| 209 | Kimi fizike dhe kimi inorganike | 2 | m | |
| 210 | Kimi organike | 2 | m | |
| 211 | Kimi analitike dhe kimi e mjedisit | 2 | m | |

**REALIZIMI I KUPTIMIT Koha 15 ; Metoda e punës**

**Pyetje diskutimi:**

A mendoni që do ishte praktike, qe sa herë një profesor të lajmërohet në universitet, të duhej të jap të gjitha informacionet e tij personale, duke filluar nga emri, mbiemri, data e lindjës, vendlindja, niveli akademik, diplomat, trajnimet? Ndoshta do t'i duhej të vinte dy-tre herë gjatë ditës në universitet dhe gjithmonë të deklaronte të gjitha të dhënat e veta!

**Mësimdhënësi sqaron rëndësinë e çelesit primar.**
-Si mendoni që do të ja bënim nëse do të na duhet që në tabelën e profesorëve do të donim të dinim edhe adresën e Universiteteve në të cilat profesorët mbajnë ligjerime?
**Pergjigjet që do marrim, sigurisht do të jenë nga njohuritë që nxënësit kan me filtrimin në Excel. Këtu mësimdhënësi derlidhet tek lidhjet e tabelave dhe i sqaron ato duke i demonstruar.**
-A ju merr mendja që do ishte e veshtirë të gjejmë të gjithë mësimdhënësit që punojnë në Prishtinë?
**Pergjigjja e pritshëshme mund të vie me njohuritë nga Excel-i dhe filtrimi në Excel, që është JO.**

**Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatar ëve**

**Diskutim:**

Nga përgjigjet që merr mësimdhënsi nga pyetjet e parashtruar duke vlerësuar opinjonet e nxënësve si dhe arsyetushmërinë e asaj që thonë brenda diskutimit bën vlerësimet përkatëse.

**Mbledh ja e provav e:**

**Diskutim:**

Mbledhja e provave bëhet përmes disuktimit rreth pyetje të parashtruar dhe lidhshmërisë së njohurive

**Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**

Shpjegim dhe demostrim

Meqë nxënësit pritët që pyetjet e parashatrua nga mësimdhësn ësi t'i lidhin me programin e Excell-it, mësimdhënë

-Po sikur të donim të dinim, të gjithë mësimdhënësit që punojnë në Prishtinë, arritja e tyre akademike është Dr. dhe gjithashtu janë mbi moshën 40 vjeçare?

Drejtimet | Mesimdhenesit | Universitetet

| IdMesimdhenesi | Emri | Mbiemri | Titulli akade | iduniversite | IdDrejtimi | Click to Add |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Adem | Beha | Prof.Ass.Dr | 1 | 102 | |
| 2 | Afrim | Hoti | Prof.Asoc.Dr | 1 | 102 | |
| 3 | Agim | Zogaj | Prof.Dr | 1 | 102 | |
| 4 | Agim | Hyseni | Prof.Dr | 1 | 105 | |
| 5 | Albina | Drançolli | Prof.Ass.Dr | 1 | 107 | |
| 6 | Aliriza | Arënliu | Prof.Asoc.Dr | 1 | 103 | |
| 7 | Anton | Berishaj | Prof.Dr | 1 | 105 | |
| 8 | Anton | Vukpalaj | Prof.Ass.Dr | 1 | 102 | |
| 9 | Arben | Hajdari | Prof.Ass.Dr | 1 | 107 | |
| 10 | Arben | Hajrullahu | Prof.Asoc.Dr | 1 | 102 | |
| 11 | Ardian | Gola | Dr.Ass | 1 | 105 | |
| 12 | Ardian | Kastrati | Dr.Ass | 1 | 102 | |
| 13 | Arsim | Canolli | Prof.Ass.Dr | 1 | 110 | |
| 14 | Arsim | Sinani | Prof.Ass.Dr | 1 | 110 | |
| 15 | Artan | Krasniqi | Ma.Ass | 1 | 105 | |
| 16 | Astrit | Salihu | Prof.Asoc.Dr | 1 | 106 | |
| 17 | Avdyl | Gashi | Ma.Ass | 1 | 105 | |
| 18 | Bardhok | Bashota | Prof.Ass.Dr | 1 | 102 | |
| 19 | Bekim | Baliqi | Prof.Asoc.Dr | 1 | 102 | |
| 20 | Blerim | Latifi | Prof.Ass.Dr | 1 | 106 | |
| 21 | Bujar | Dugolli | Prof.Dr | 1 | 107 | |
| 22 | Dashmir | Berxulli | Prof.Ass.Dr | 1 | 103 | |
| 23 | Dorajet | Imeri | Ma.Ass | 1 | 102 | |
| 24 | Durim | Abdullahu | Ma.Ass | 1 | 107 | |

në paketën e Office-it.

si bën intervenimet e duhara shpjeguese dhe demostruese në mënyrë që nxënënsit t'i arrijnë rrezultatet e pritura për orën mësimore.

**PËRFUNDIMI** **Koha 15;** **Metoda e punës**

**Pyetje përmbyllëse:**

**Demostrim/Punë praktike**

**Nxënësve u sqarohet rëndësia e pyetësorëve që ofron Access-i**
Nxënësit, me ndihmën e mësimdhënesit, i vendosin emrin databazës që planifikojnë të ndertojnë gjatë gjithë periudhës e që sygjerohen paraprakisht të jenë biznese, biblioteke apo cfaredo dege menaxhuese. Planifikojnë tabelat dhe permbajtjën e tyre.

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**

**Puna praktike**

Mësimdhënësi përmes kontrollimit të punës së nxënësve me tabela bën vlerësimet përkatëse si dhe

| | |
|---|---|
| | bën përmbledhjen e asaj që është shpjeguar sot bashkarisht me nxënësit duke e parë kështu nëse janë arritur kriteret e përcaktuara për orën mësimore. |
| **Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:<br>Vlerësim i vazhdueshëm, që nga fillimi i orës e deri tek puna individuale | |
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>Grumbullimi i informacioneve për tabelat e tyre | |
| **Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**: | |

**Shkolla: Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti” Komuna: Gjilan Data: 10.03.2021**
**Mësimdhënësi/ja: Pajtim Rashiti**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda: TIK** | **Shkalla e kurrikulës: VI** | **Klasa: 12** |
| Tema[49]: Ide ndërmarrëse<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[50]: 2 | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>● ***Zhvillon*** *strategji kreative në skuadër*<br>● ***Nxit*** *punën në grup*<br>● ***Bashkëpunon*** *dhe është kreativ*<br>● ***Zgjidh*** *konfliktet në mënyrë të orientua* | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[51] (të synuara me përmes temës)***:***<br>Kurrikula Bërthamë (fq: 18-19):<br>● ***Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (komunikues efektiv),***<br>● ***Kompetenca e të menduarit (mendimtar kreativ (krijues dhe kritik)),***<br>● ***Kompetenca e të mësuarit (nxënës i suksesshëm),***<br>● ***Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (kontribues produktiv).*** | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[52] (të synuara përmes temës):<br>Kurrikula Bërthamë (fq: 84-86):<br>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet,<br>2 .Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë,<br>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme,<br>5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë,<br>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[53] (të synuara përmes temës):<br>(Kurrikula Bërthamë fq: 84-86)<br>1.1 Hulumton, organizon në mënyrë efektive dhe prezanton informacione për aktivitete praktike individuale dhe në grup,<br>2.1 Vlerëson aftësitë personale dhe profesionale si dhe arritjet e identifikuara në bazë të fushave të ndryshme të interesit sipas objektivave të caktuara<br>për vetë -përmirësim, duke marrë në konsideratë ndikimet në zgjedhjen e karrierës në të ardhmen,<br>4.1 Zhvillon aktivitete me projekte, punë hulumtuese përmes gjuhëve programuese dhe programeve aplikative,<br>5.1 Harton plan të biznesit duke aplikuar hapat konkretë të realizimit të tij, | | | |

[49] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[50] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[51] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[52] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme
[53] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| |
|---|
| 6.1 Zbaton dhe menaxhon rregullat për mbrojtje dhe siguri gjatë aktiviteteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet, |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: Ndërtimi i urës |
| Fjalët kyçe: Lojë, projektim, materiale, kreativitet, urë |

| | |
|---|---|
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:<br>● *Zhvillohen ide, të cilat zgjidhin problemet dhe dallojnë shanset ne treg dhe shoqëri*<br>● *Grupohen ide dhe regjistrohen apo ruhen në një fletore me ide inovative*<br>● *Prezantohen idetë dhe mund të dallojnë risqet në jetën e përditshme dhe të mendojnë se si t'i shmang ato* | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:<br>● ***Zhvillo** ide të cilat zgjidhin problemet dhe mbajnë peshat e parapara*<br>● ***Grupo** idetë*<br>● ***Zgjedh** një urë apo ndërtim të caktuar*<br>● ***Regjistro** apo ruaj idetë në një fletore me ide inovative.*<br>● ***Prezanto** idetë me të tjerët Dizajno urën me qëllim të jetë sa më e fortë*<br>● ***Dallo** risqet në jetën e përditshme dhe të mendojnë si t'i shmang ato.*<br>● ***Puno** në grup*<br>● ***Reflekto** kreativitet dhe bëhu komunikativ* |

| |
|---|
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Burimet:<br>● Entrepreneurship Learning Toolkit<br>● Al-biz<br>Mjetet:<br>2 karrige, libra, 100 kapëse letre, Flipchart, 100 copë pipa, markera, 3 spango me formular reflektimi, gjatësi 1,5 metër |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Ekonomi, Matematikë, Lidhja me kornizën e përbashkët europiane të referencave për kompetencat rreth sipërmarrjes/ndërmarrësisë. |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| ***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 10 minuta;*** ***Metoda e punës: pyetje, diskutim*** |

| | |
|---|---|
| **Pyetje diskutimi:**<br>Mësimdhënësi shpjegon nxënësve se gjatë njësisë mësimore ata do të kenë një lojë kreative e cila ka të bëjë me krijimin e një ure. Pastaj i njofton nxënësit se ata duhet ndarë në grupe punuese dhe ju tregon për materialet punuese.<br>Pyet se çfarë ure do të ndërtojnë ata? | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**<br>Krijohen grupet, bëhet shpërndarja e materialeve dhe sqarohen kushtet për<br>ndërtimin e urës:<br>● Ura do të ndërtohet vetëm me të gjitha materialet e listuara.<br>● Ura duhet të mbajë në mes të paktën një libër.<br>● Skuadrat duhet të punojnë në sektorë të ndarë dhe nuk lejohet të shohin njëra-tjetrën (as të komunikojnë në mënyrë indirekte). |

<table>
<tr><td colspan="4">REALIZIMI I KUPTIMIT Koha: 60 minuta; Metoda e punës: punë në grup</td></tr>
<tr>
<td>Pyetje diskutimi:<br>Fillon ndarja e grupeve të nxënësve dhe grupet përcaktojnë idenë, llojin kryesor të materialit për përbërjen e urës, formën e saj dhe e fillojnë ndërtimin e urës.<br><br>Grupet përcaktojnë idenë, llojin kryesor të materialit për përbërjen e urës, formën e saj dhe e ndërtojnë atë.<br><br>Mësimdhënësi diskuton me nxënësit:<ul><li>Aktivitetet</li><li>Njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen</li><li>Kushtet e punës</li><li>Veglat e punës</li></ul></td>
<td>Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve<br>Formular për reflektim (Feedback)<br>Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual<br><br>Nxënësit hulumtojnë se çfarë ure do të ndërtojnë, analizojnë urat e sugjeruara nga hulumtimi.<br><br>Ndërtimi i urës.</td>
<td>Mbledhja e provave:<br>Nxënësit hulumtojnë, analizojnë, krijimin e urës, paraqesin listën komponentëve për krijimin e urës, zgjedhin urën apo ndërtimin qe u pëlqen. Hulumtojnë për fortësinë dhe dizajnet e urave të ndryshme dhe materialet punuese.<br><br>Në grupe nxënësit do të grumbullojnë rezultatet nga hulumtimi bazuar në kërkesat e tabelës.<br><table><tr><th>Nxenesi:</th><th>Materiali:</th><th>Pesha:</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table></td>
<td>Strategjitë për të siguruar informatën kthyese<br>Grupet prezantojnë produktin e krijuar duke sqaruar idenë dhe mënyrën e ndërtimit.<br><br>Drejtuesi i lojës kontrollon cilësinë me anë të provës së kapacitetit (fillimisht me një libër e më pas duke shtuar numrin e tyre), si dhe diskuton origjinalitetin e çdo grupi.</td>
</tr>
<tr><td colspan="4">PËRFUNDIMI Koha: 20 minuta; Metoda e punës: prezantim</td></tr>
<tr>
<td colspan="2">Pyetje përmbyllëse:<br>Pas punimit të urës, grupet prezantojnë produktin e krijuar duke sqaruar idenë dhe mënyrën e ndërtimit. Mësimdhënësi kontrollon cilësinë me anë të provës së kapacitetit (fillimisht me një libër e më pas duke shtuar numrin e tyre), si dhe diskuton origjinalitetin e çdo grupi.</td>
<td colspan="2">Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse<br>Si përfundim çdo anëtar i skuadrës duhet t'i përgjigjet individualisht pyetjeve të dhëna në formularin e reflektimit. Skuadra më pas harton përmbledhësen për grupin në flipchart. Rezultatet diskutohen së bashku.</td>
</tr>
<tr><td colspan="4">Teknikat e vlerësimit të nxënësve:<br>Kriteret e vlerësimit janë:<ul><li>Origjinaliteti,</li><li>Funksionaliteti,</li><li>Përpikëria.</li><li>Stabiliteti.</li></ul></td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur:<ul><li>Krijohen grupet prej 5–8 anëtarësh.</li><li>Çdo grup ka për detyrë të ndertojë një urë vetëm me materialet e dhëna.</li></ul></td></tr>
</table>

- Çdo grup ka për detyrë të ndertojë një urë me gjatësi 1,5 metër (verifikohet gjatësia e urës me spangon e dhënë).
- Ura duhet të mbajë në mes të paktën një libër (edhe më shumë libra nëse është e mundur).
- Grupet duhet të punojnë në sektorë të ndarë dhe nuk lejohet të shohin njëra-tjetrën (as të komunikojnë në mënyrë indirekte).
- Fiton lojën grupi që ka ndërtuar urën më të qëndrueshme (që mban peshën më të madhe).
- Largësia ndërmjet karrigeve me të cilat lidhen këmbët e urës duhet të jetë 1,5 metër larg nga njëra-tjetra (aq sa është dhe gjatësia e urës).

**Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:

Në vazhdim kemi paraqitur shembullin nga puna me nxënës





## Plani i orës mësimore

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna / Lënda: TIK - Ndërmarrësi Shkalla e kurrikulës: V / Klasa:XI

Tema / njësia mësimore: **1.Hyrje në ndërmarresi**

Rezultati i të nxënit të temës: Sqaron dhe kupton nocionin e ndërmarrësisë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : ***I.1,2,3,4,6,8; II.1,3,4,5,7; III.1,2,3,6,7,8,9 IV.2,4,5,7; VI.1,2,5,6***

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : ***1.2, 2.1, 3.2, 4.2, 5.1, 7.1, 8.1, 9.1***

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fjalët kyçe: Kuptim, sipërmarrës, biznes, ndërmarrje, kompani

Rezultatet e të nxënit të lëndës (për orë mësimore):

-Sqaron kuptimin e ndërmarrësisë.

- Kupton rolin e ndërmarrësit

- Kriteret e suksesit:

- Shpjegon kuptimin e ndërmarrësisë.

-Trego krijimin e nje ndërmarrje

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuter, video-projektor, internet, fletore për shënime,
tabela,shkumësi.

Përdorimi i TIK-ut: Interneti, word, Power Point.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Matematika /
Arsimimi me TIK dhe mësimi elektronik, Përgaditja për jetë dhe për punë, Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për punë, Arsimimi për ndërmarrësi, Vetëdijësimi për ekonomi, Njohuri themelore financiare

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**EVOKIM-E: (5')** Mësimdhënësi për të nxjerrë panjohuri parashtron pyetje rreth njësisë mësimore.Kuptimi i ndërmarrësisë

**REALIZIMI I KUPTIMIT-R:(15')** Mësimdhënësi i fton nxënësit të fokusohen në njësitë mësimore në liber dhe në fletore duke i shenuar karakterisitikat kryesore rreth njësisë mësimore duke bashkëbiseduar dhe
përsëritur profesori dhe nxënësi.

**REFLEKTIMI-R:(10')** Mësimdhënësi i fton nxënësit të bëjnë prezantimin rreth njësisë mësimore ,rreth asaj që e kanë kuptuar,duke aplikuar mënyren e bashkëbisedimit rreth njësisë mësimore. Për orën e radhës planifikohet që nxënësit në grupe të japin nga një ide

për një ndërmarrje të re në qytetin tonë.

Dëshmitë nga detyrat e nxënësve:

Grupi 1

Kryetar-e e grupit

| | **Emrat e anëtarëve te grupit** | **Emailat – nr. e tel** |
|---|---|---|
| 1 | | |
| 2 | | |
| 3 | | |
| 4 | | |
| 5 | | |
| 6 | | |
| 7 | | |
| 8 | | |

Logoja fillestare e biznesit

Përshkrimi i idesë fillestare të biznesit


Grupi 1
Kryetar-e e grupit
Gresa Elshani
Emrat e anëtarëve te grupit
Emailat – nr. e tel
FOOD
Logoja fillestare e biznesit
Përshkrimi i idesë fillestare të biznesit


Grupi 1
Kryetar-e e grupit
Alma Elshani
Emrat e anëtarëve te grupit
Emailat – nr. e tel
Logoja fillestare e biznesit
Magic Ideas
Përshkrimi i idesë fillestare të biznesit
-Idea jonë si grup për këtë aktivitet është formimi i një biznesi që merret me dekorimin e ambienteve të ndryshme qofshin të hapura ose të mbyllura për festa të ditëlindjeve, ahengeve të ndryshme familjare etj. Emri i grupit tonë është: Magic Ideas.





**GJIMNAZI I FILOLOGJISË "EQREM ÇABEJ" PRISHTINË**

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE, Viti shkollor 2018-2019,**
**Mësimdhënësi: Shpresa Hoxha**

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: **Jeta dhe Puna** / Lënda: TIK     Shkalla e kurrikulës: V  / Klasa: XI

**Tema**: Karriera ime

**Rezultati i të nxënit të temës:**
Nxënësi:

- Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës "se çfarë jam të aftë të bëjnë".
- Shpjegojnë se si mund tí arrijë qëllimet për të zhvilluar karrierën.
- Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë.
- Tregojnë për azhurnimi/përditësimi e portfolios personale
- Përdorin aplikacione të ndryshme për ndërtimin e CV, përzgjedh formën e duhur të cv-së dhe ndërton përmbajtjen e saj.

Tregojnë për rreziqet nga interneti.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

RNK  kompetencat për njesin Krijimi i Cv-is.

**RNK: I.4,9; III.6; IV.1,3;**

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**
RNF: 1.3 Kryen interperetime te tabelave dhe diagrameve të të dhënave
**RNF: 3. Këshillim dhe orientim në karrierë**
*3.1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme.*
*3.2. Ndërlidhë njohuritë dhe shkathtësitë personale me nevojat e tregut të punës.*
***ROKK- 4.1 Kërkimi i punës***

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore: Krijimi i CV-së**

**Fjalët kyçe: Curriculum Vitae (shkurt CV-ja = "jetëshkrim" ose "biografi")**

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Identifikimi i mundësive të punësimit( p.sh. gjatë pushimeve verore, part-time, etj) përmes portaleve të punës¸
- Përdorin aplikacione të ndryshme për krijimin e CV
- Përpilimi efektiv i CV-is për vendin e synuar të punës

**Shkathtësit e buta**

Shkathtësit e buta.docx

**Kriteret e suksesit:**

1. Krijon nje CV efektive në aplikacionin Word (Excel, PDF)
2. Rendit sipas kronologjisë se caktuar
3. Përdorë shkronja të pjerrëta dhe germa të mëdha për titujt kryesorë
4. Shkrimi duhet të jetë i qartë , një faqe është e mjaftueshme.
5. Analizo tri portale pune online dhe ngarko CV-in tuaj

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**
Libri, Kompjuteri, Projektori, MS Office 2016, Lidhja me internet, CV builder online , Shembull-CV

www.interpersonnel.al/docs/Europass_Shqip.doc;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore**:
Gjuhët dhe komunikimi, Matematika

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Organizimi i orës së mësimit, i cili përmban:
Lidhjen e njësis mësimore me njohuritë e mëparshme të nxënësve;
Ndërtimin e njohurive të reja;
Prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.

**Hapi I –Rrjeti i diskutimit (Bashkëbisedim)**
Për realizimin e njësis **"Krijimi CV-is",** filloimë me **pyetjen shtytëse**, hedh për diskutim si më poshtë...

**Si të bëjm jetën më të mirë?**

Kerkimi për punë part-time.pptx

**Hapi i dytë:**
**Prezantim i koncepteve të reja**

- Ç' është CV-ija

  Çështë CV-ja.docx

- Cilat janë rregullat bazë të shkrimit të saktë të një CV-ie?

  Udhëzime të përgjithshme për sh

  Europass_Shqip.doc

- Demonstrimi i krijimit te CV-is.

**Hapi i tretë:**

Punë e pavarur-Nxënësit bazohen në literaturën , prezantimit të pergaditur paraprakisht, videos, dhe kryejnë ushtrime në praktike.  Kërkojm qe nxënësit  të përdorin aplikacione të ndryshme per te krijuar një CV.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

**Vlerësimi: Portofolio, Vlerësimi i shokut- shoqës, Lista e kontrollit**

Punë e udhëhequr-CV-it e prezantuara në pjesën e parë të mësimit nga ne dhe të krijuara nga nxënësit kanë vlerë të matëshme.
Lista e kontrollit:
Niveli i lartë: Kur nxënësi demonstron pavarësi të plotë në përdorimin e aplikacioneve(Word, Excel) për të krijuar CV-in (+).
Niveli mesatar: Kur nxënësi ka njohuri të mjaftueshme mbi krijimin e CV-is, por nuk arrin t'i përfundojë në mënyrë të pavarur ato(-).
Niveli i ulët: Kur nxënësi nuk angazhohet për të përdor asnje prej aplikacioneve për të krijuar CV-i (-).

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të krijoj CV-i duke përdorur aplikacione të ndryshme, dergimi të bëhet me email.

*CV të krijuara nga nxënësit:*

*Nxënësi.1,* B.Gashi CV X4.docx

*Nxënësi .2,* B.U CV.docx

*Nxënësi.3,* CV , X4.doc

*Nxënësi.4,* **CV_PDF.pdf**

## Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Vetëvlerësimi- Analizë e orës së mbajtur: a) Plotësisht i kënaqur b) I kënaqur c) Nuk jam i kënaqur.
Nëse nuk jeni të kënaqur, tregoni arsyet.
1.________________________________ 2. _____________________________

Hyrje në Java

**Shkolla: Gjimnazi”Xhevdet Doda”** **Komuna: Prishtinë** **Data: ......................**

**Mësimdhënësi/ja: Njomza Selimi**

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna** | **Lënda: TIK** | **Shkalla e kurrikulës: VI** | **Klasa: XII** |
| Tema[54]: Hyrje në Java<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[55]: 10 orë | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>4.1.6 Instalon aplikacionin në Sistemet Operative që është adekuat dhe aktual për moshën e tij.<br>4.1.7 Shpjegon pamjen fillestare të aplikacionit dhe navigon në aplikacion.<br>4.1.8 Demonstron hapjen e projektit të ri dhe krijon objekte. Gjithashtu përpilon klasë dhe objekte si dhe kontrollon gabimet gjatë përpilimit.<br>4.1.9 Inspekton objektet dhe kontrollon gjendjen e brendshme të tyre.<br>4.1.10 Krijon aplikacione të pavarura dhe përdor operacione të tjera.<br>4.1.11 Krijon aplikacione duke pasur parasysh fazat e zhvillimit të tij: planifikimi, zhvillimi, implementimi dhe evaluimi i aplikacionit. | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[56] (të synuara me përmes temës)*:*<br><br>**I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**<br>I.2 Diskuton në mënyrë konstruktive në një dialog në grup dhe në kohëzgjatje të planifikuar, për një temë të caktuar, duke dhënë informata, argumente dhe duke shtruar pyetje në gjuhën amtare, apo në gjuhën angleze (ose në gjuhën tjetër jo-amtare apo të huaj).<br>I.9 Përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies (duke përfshirë edhe të nxënit në distancë), kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore dhe prezantimit për audiencave të ndryshme.<br><br>**III Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm**<br>III.1 Demonstron shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.).<br>**IV Kompetenca për jetë, për punë dhe mjedis – Kontribuues produktiv** | | | |

[54] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor

[55] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore

[56] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme

| |
|---|
| IV.6 Përdor programe softuerike për llogaritjen, shqyrtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informata të nevojshme (p.sh., të një mjedisi të biznesit) duke bërë një rangim sipas nevojave dhe prioriteteve të ndërmarrjes ose organizatës. |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[57] (të synuara përmes temës):<br>**4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.**<br>4.1 Zhvillon aktivitete me projekte, punë hulumtuese përmes gjuhëve programuese dhe programeve aplikative. |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[58] (të synuara përmes temës):<br>4.1.10 Krijon aplikacione të pavarura dhe përdor operacione të tjera.<br>4.1.11 Krijon aplikacione duke pasur parasysh fazat e zhvillimit të tij: planifikimi, zhvillimi, implementimi dhe evaluimi i aplikacionit. |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: Deklarimi i variablave |
| Fjalët kyçe: variabël, njësi hyrëse, llogaritje, string etj. |

| | |
|---|---|
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:<br>Në përfundim të orëve të mësimit nxënësi të:<br><br>Ndërtoj algoritmin dhe bën përcjelljen në kompjuter<br>Deklaroj varibla të ndryshme dhe i jep ato përmes njësive hyrëse për ndërtim të kodit.<br>Bëj ndryshime brenda kodit krahas kërkesave specifike. | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:<br><br>Ndërton saktë algoritmin për njehësim të perimetrit dhe syprinës së drejtëkëndësiht.<br>Analizon variablat për ndërtim të kodit<br>Zbaton deklarimin e variablave për ndryshueshmëri specifike në kod. |

| |
|---|
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Kompjuter, projektor, internet (programim online)/ program i shkarkuar më parë etj. |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Matematikë/ Krijimi i programit për njehësim të perimetrave dhe syprinave të figurave të ndryshme gjemotrike<br>Përgjegjësi individuale/ Vlerësimi dhe interpretim i punës së njëri tjetrit për hyrje të ndryshme të testimeve të kodit |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |

[57] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme

[58] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

<table>
<tr><td colspan="2">PJESA HYRËSE Koha 15 minuta; Metoda e punës</td></tr>
<tr><td>Pyetje diskutimi:<br>Çfarë na duhet të dijmë për njehsimin e perimetri të nje drejtkëndëshi?<br>Po për llogaritjen e syprinës së sipërfaqes së tij çfarë na duhet të dijmë?<br>Meqë në orët e kaluara nxënësit janë njoftuar me paraqitjen grafike të algoritmeve, nga ta kërkohet që të ndërtojnë algoritmin për llogaritjen e perimetrit dhe syprinës së rrethit.<br>




Paraqitja grafike e algoritmit</td>
<td>Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit<br><br>Dikutim:<br>Nga përgjigjet e nxënësve marr informatat fillestare për njohuritë bazike mbi llogaritjen e perimetrit dhe syprinës së drejtkëndëshit.<br><br>Kontrollim i ndërtimit të algoritmit nga puna e pavarur e nxënësve.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="4">REALIZIMI I KUPTIMIT Koha 25 minuta; Metoda e punës</td></tr>
<tr><td>Pyetje diskutimi:<br>Si do ta ndërtojmë kodin? (Përkthimi i algoritmit në gjuhë që e kupton kompjuter)<br>Demonstrim<br><br>Mësimdhënësi hap web faqën e programimit online në gjuhën programuese java dhe e shpërndanë linkun me nxënësit.<br>(https://www.onlinegdb.com/online_java_compiler)<br>Pasi që nxënësit nuk kanë pasur më herët gjuhë programuese dhe është ora e parë ku mësohet deklarimi i variablave si dhe njësia hyrëse, mësimdhënësi demonstron përmes projektorit dhe shpjegon këto dy koncepte.<br>Mësimdhënësi kyqen pjesën e parë duke demonstruar, gjegjësisht kryen pjesën e llogaritjes së perimetrit të drejtkëndëshit.<br>Pastaj nga nxënësit përmes një komenti që e len në program, kërkohet që të ndërtohet kodi për pjesën e mbetur, pra njehsimin e syprinës së drejtkëndëshit si dhe ta prezantojnë punën e tyre me shokun/ shoqen që kanë afër. Eventualisht të korrigjohen gabimet</td>
<td>Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve<br><br>Demonstrim/praktikim/testim<br><br>Nga nxënësit kërkohet që pasi të kenë përfunduar kodin ta demonstrojnë atë për shokun/shoqen që ata e kanë afër.<br>Ata vlerësojnë punën e njëri tjetrit dhe njëkohësisht i ndihmojnë njëri tjetrit në qoftëse ka gabime të paraqitura në kod.<br>Nga nxënësit është kërkuar që testimet e kodeve të bëhen për vlera të ndryshme hyrëse.</td>
<td>Mbledhja e provave:<br><br>Diskutim dhe punë praktike<br><br>Përmes diskutimeve për deklarimin e variabileve apo konkretisht në shembullin tonë, deklarimin e brinjëve të drejtkëndëshit sigurojmë informatat nëse po arrihen rezultat e të nxënit dhe kriteret e përcaktuara për orën mësimore.</td>
<td>Strategjitë për të siguruar informatë n kthyese<br><br><br>Puna praktike e nxënësve drejtë arritjes së kritereve të suksesit për orën mësimore si dhe intervenim et e herë pas hershme kurdo që</td></tr>
</table>

brenda kodit nëse ka si dhe të bëhen testime për hyrje të ndryshme.







Po ashtu me anë të punës praktike dhe vlerësimit të bashkëmoshatarëv e vihen në pah nëse janë mësuar saktë konceptet bazës të njësisë mësimore.

nxënësit kanë ndonjë vështirësi.

***PËRFUNDIMI*** ***Koha 5 minuta;*** ***Metoda e punës***

**Pyetje përmbyllëse:**
**Kërkesë:**
Modifiko kodin ekzistues për njehsim të perimetrit të katrorit dhe syprinës së tij.

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**

**Praktikim**
Ndryshueshmëria e saktë në pjesën e kërkuar të kodit, gjegjësisht praktikimi i deklarimit të variablave ( brinja “a” për njehsim të perimetrit dhe syprinës) i jep informatë nxënënsit si dhe mësimdhënësit se njësia mësimore ishte efektive dhe u arritën të gjitha kriteret e caktuara për orë mësimore.

**Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:
Nxënësit vlerësohen për ndërtimin e saktë të algoritmit dhe punës praktike në ndërtimin e kodit. Në veçanti vlerësohen diskutimet gjatë vlerësimit të bashkëmoshatarëve, ku edhe merren informatat e të nxënit të njësisë mësimore.

**Detyrat dhe puna e pavarur**:
Ndërtoni algoritmin dhe kodin për ndonjë problem nga lënda e fizikës.
Shembuj që mund të përdorni: Njehsimi i shpejtësisë, rrugës, kohës, intensiteti, rezistenca etj.

**Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:

Krijimi dhe Shitja e Produkteve të realizuara me 3D printer

**Shkolla: Gjimnazi Natyror "Xhavit Ahmeti"** **Komuna: Gjilan** **Data: 10.03.2021**
**Mësimdhënësi/ja: Pajtim Rashiti**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna</td><td>Lënda: TIK</td><td>Shkalla e kurrikulës: VI</td><td>Klasa: 12</td></tr>
<tr><td>Tema[59]: Ide ndërmarrëse<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[60]: 3</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>● Përdor TIK-un dhe platformat e ndryshme për të krijuar produkte<br>● Analizon tregun apo kërkesat për të krijuar produktet<br>● Dallon krijimin, ndërmarrësinë dhe shitjen apo të bërit biznes</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[61] (të synuara me përmes temës):<br>Kurrikula Bërthamë (fq: 18-19):<br>● Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (komunikues efektiv),<br>● Kompetenca e të menduarit (mendimtar kreativ (krijues dhe kritik)),<br>● Kompetenca e të mësuarit (nxënës i suksesshëm),<br>● Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (kontribues produktiv),<br>● Kompetenca qytetare (qytetar i përgjegjshëm).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[62] (të synuara përmes temës):<br>Kurrikula Bërthamë (fq: 84-86):<br>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet,<br>2 .Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë,<br>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme,<br>5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë,<br>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë,<br>7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[63] (të synuara përmes temës):<br>(Kurrikula Bërthamë fq: 84-86)<br>1.1 Hulumton, organizon në mënyrë efektive dhe prezanton informacione për aktivitete praktike individuale dhe në grup,<br>2.1 Vlerëson aftësitë personale dhe profesionale si dhe arritjet e identifikuara në bazë të fushave të ndryshme të interesit sipas objektivave të caktuara<br>për vetë-përmirësim, duke marrë në konsideratë ndikimet në zgjedhjen e karrierës në të ardhmen,<br>4.1 Zhvillon aktivitete me projekte, punë hulumtuese përmes gjuhëve programuese dhe programeve aplikative,</td></tr>
</table>

[59] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor

[60] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore

[61] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme

[62] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme

[63] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| | |
|---|---|
| 5.1 Harton plan të biznesit duke aplikuar hapat konkretë të realizimit të tij,<br>6.1 Zbaton dhe menaxhon rregullat për mbrojtje dhe siguri gjatë aktiviteteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet,<br>7.1 Përdor aplikacione softuerike për përpunimin e të dhënave për aktivitete të ndryshme profesionale. | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: Krijimi dhe Shitja e Produkteve të realizuara me 3D printer | |
| Fjalët kyçe: 3D, dizajn, projektim, shitje, marketing, platforma online, ndërmarrës. | |
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore:<br>● *Përdor TIK-un dhe platformat e ndryshme për të krijuar produkte*<br>● *Analizon tregun apo kërkesat për të krijuar produktet*<br>● *Dallon krijimin, ndërmarrësinë dhe shitjen apo të bërit biznes* | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore:<br>*Të përdorë pajisjet e TIK-ut dhe MakerSPace*<br>*Të përdorë platforma të ndryshme apo Tinkercad*<br>*Të demonstroj veprimet konkrete me kompjuter dhe me objekte 3 dimensionale*<br>*Të demonstroj veprime konkrete me printer 3D*<br>*Të analizoj kërkesat e tregut dhe të krijoj produkte*<br>*Në përgjithësi nxënësit do t'i njohin dhe t'i përdorin pajisjet e teknologjisë së informimit dhe të komunikimit si dhe nxisin iniciativa në marrjen e përgjegjësisë për punë dhe ndërlidhjen e shkathtësive personale me karrierën e tyre, të cilat kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore.* |
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Burimet:<br>● https://www.tinkercad.com/<br>● https://www.youtube.com/channel/UCTXWXbEfezxpOQpDr3Bh7Xw<br>Mjetet:<br>Kompjuter/Laptop, aplikacionet e nevojshme softverike apo platforma Tinkercad, lidhja me internet, printeri 3D, projektori, trajnime për mësimdhënës, mirëmbajtja | |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Ekonomi, Matematikë. | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |
| ***PJESA HYRËSE*** ***Koha: 10 minuta;***<br>***Metoda e punës:***<br>● ***Demonstrim dhe punë individuale dhe grupore duke përfshirë ligjërimin, demonstrimin dhe punën individuale dhe grupore.*** | |

- ***Ligjërimi i përmbajtjes programore në klasë, kabinet apo MakerSpace të bëhet me anë të demonstrimit në kompjuter dhe platformë.***

**Pyetje diskutimi:**
Mësimdhënësi fillon diskutimin duke pyetur nxënësit se çka janë objektet 3D dhe nëse ata kanë njohuri paraprake.
Pastaj mësimdhënësi shpjegon nxënësve rreth objekteve 3 dimensionale dhe dallimin nga 2D.

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**
Mësimdhënësi pyet nxënësit se çfarë objekte do të dëshirojnë ata të krijojnë dhe pastaj ato me ato objekte të mësohen se si duhet bërë tregëti dhe të tentojnë që t'i shesin.

***REALIZIMI I KUPTIMIT Koha: 25 minuta;***
***Metoda e punës:***
- ***Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimit të ideve dhe shkathtësive (puna interaktive),***
- ***Përsëritja e përmbajtjes nëpërmjet detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara.***

**Pyetje diskutimi:**
Mësimdhënësi njofton nxënësit që të vizitojnë fillimisht platformën www.tinkercad.com dhe të njoftohen me procesin e regjistrimit në këtë platformë, pastaj se si duhet filluar krijimi i objekteve 3 Dimensionale.

Pasi që është krijuar mësimdhënësi ka krijuar një objekt të thjeshtë provues në platformë, ju shpejgon nxënësve se si duhet shkarkuar/ekstaktuar file-in e krijuar dhe cili është formati i përshtatshëm të cilin pastaj e njeh Printeri 3D.
Mësimdhënësi ju tregon nxënësve se si të kopjohet/zhvendoset file-i i shkarkuar nga internet në një SD Card apo USB, pastaj njoftohen me procesin e futjes në printerin 3D. Njoftohen nxënësit se si duhet përdorur printer 3D dhe si duhet shtypur objektin e krijuar në

**Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**

Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual

Nxënësit kyqen në portalin Tinkercad, hulumtojnë veglat e punës, analizojnë format e objekteve 3D.
Përzgjedhin objektin e tyre punues.

**Mbledhja e provave:**
Nxënësit parqesin punimet e tyre duke u bazuar në përzgjedhjen e mëhershme të objekteve 3D të caktuara nga vet nxënësit.

Hulumtojnë për dizajnime të objekteve relevante të gatshme.

Nxënësit individualisht do të grumbullojnë rezultatet e tyre të arritura përmes dizajnit të objekteve nga kërkesat e tabelës.

| Nxënës i: | Objekti 3D: | Koha e printimit: |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |

**Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**
Analizë e produkteve finale të realizuara nga nxënësit.
Analizë e listës së kontrollit ne realizimin e kritereve të suksesit.
Gjatë praktikës nxënësit i mbështet mësimdhënësi/ja me sugjerime dhe ndihmë.
Informata kthyese përshkruese/ orientuese aty ku ka nevojë për përmirësim.

| | | | |
|---|---|---|---|
| platformë dhe fillon demonstrimi dhe printimi i objektit. | | | |

***PËRFUNDIMI*** ***Koha: 10 minuta;***
***Metoda e punës:***
***Punë grupore apo individuale në shtëpi apo pas mësimit të rregullt duke i shfrytëzuar Klubet e shkollave, vizita në kompani të ndryshme(Jashtë kurrikulare).***

| | |
|---|---|
| **Pyetje përmbyllëse:**<br>Cilat ishin sfidat për të zgjedhur objektin 3D për dizajnim?<br>Për çfarë mund t'i përdorim objektet 3D të krijuara nga nxënësit? | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**<br>Si rezultate përfundimtare, nxënësit do të sjellin projektimet e tyre përmes platformës dhe mund të printojnë punimet e tyre në printerin 3D dhe pastaj ata mund të fillojnë shitjen e atyre produkteve. Punimet e zhvilluara nga nxënësit mund të përdoren si dizajne të gatshme për gjeneratat e tjera të shkollës, ku ata mund të shfrytëzojnë ato produkte dhe të bëjnë shitje reale apo edhe shitje përmes rrjeteve sociale në bazë të kërkesave të klientëve. |

**Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:
Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, që përdoren për vlerësim. Ja disa prej tyre:

- Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë realizimit të njësisë mësimore,
- Buletini i pjesëmarrjes (Vlerësimi i punës individuale apo grupore),
- Lista e kontrollit,
- Portofoli e nxënësit,
- Portofoli elektronike,
- Vlerësimi përmes detyrës projektuese.

**Detyrat dhe puna e pavarur**:

- Pasi të përzgjidhen objektet për tu punuar, nxënësit përcaktojnë objektet finale për printim,
- Prezantohen produktet finale të printuara më të mira,
- Detyrë Shtëpie krijimi apo dizajni i objekteve 3D.

**Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:

Në vazhdim kemi paraqitur shembujt e punës së nxënësve sëbashku me mësimdhënësin









| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **FUSHA KURRIKULARE** | **LËNDA** | **TIPI I ORËS** | **SHKALLA E KURRIKULËS** | **KLASA** |
| Jeta dhe Puna | TIK 12 | Zhvillim | 6 | XII |

| **TEMA** | **REZULTATET E TË NXËNIT TË TEMËS/LËNDËS: (RNL)** |
|---|---|
| **Krijimi i vlerave** | - Krijimi i një produkti duke u nisur nga materiale të përcaktuara "pa vlerë"<br>- Krijohen dy ose më shumë skuadra, prej 4 deri në 5 persona, të cilët duhet të krijojnë nga materialet disponibël një ose disa produkte.<br>- Grupet vlerësohen me pikë në bazë të kritereve, fitues shpallet ai grup që ka grumbulluar më shumë pikë. |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 4 (RNK) | I.2,3,5,6 II.4,6,7,8 |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën 4(RNF) | 1.2, 2.1, 3.2, 4.1, 5.1, 7.1, 8.1, 9.1 |

| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
|---|---|
| Tema/njësia mësimore : | **Krijimi i vlerave** |
| Fjalët kyçe: | Vlerat, mundësit, ida, nderrmarresia |
| Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: | - Pershkruajne rendësin e krijimit te gjerave me vlera nga ato pa vlera<br>- Identifikojne gjerat pa vlera te cilat mund te krijohen gjera me vlera<br>- Analizojne fazat e krijimit te gjerave me vlera |
| Kriteret e suksesit: | - Shpjegojnë disa vlera<br>- Prezentojne 3 shembuj te gjerave me vlera te cilat janë krijuar nga ato pa vlera<br>- Krijo nje gjësend me vlere nga gjerat e pa vlera qe i keni ne dispozicion |
| Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore : | 2 m tel, 2 letra higjienike<br>2 mbajtëse qiriu bosh, 1 patate<br>1 dorëze një përdorimshme<br>1 pako facoleta, 2 shkopinjtë druri<br>25 cm letër zbukurimi, 2 m fije/spango |
| Përdorimi i TIK-ut, burimet : | TIK 11, Burimet elektronike nga interneti |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe çështjet ndërkurrikurale: | Fizike, Kimi, Ed.Qytetare, Gjuhe angleze (per shfrytëzim te literaturës) |

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHJES SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Pjesa hyrëse (EVOKIM) | Fillimisht bëhet një brainstorming “Sipërmarrja dhe vlera” dhe me pas bëhet ndarja në grupe, u shpërndahen qeset me materialet, materialet shtese si dhe formularët e reflektimit dhe udhëzuesin e lojës.<br>Sqarohen kushtet e lojës:<br>-produkti (ose produktet) duhet të jenë krijuar duke përdorur të gjitha materialet e qeses.<br>Kriteret e vlerësimit: dobishmërinë, kreativitetin, gjithëpërfshirjen |
| Pjesa kryesore (REALIZIM) | Grupet duhet të përdorin të gjitha materialet që ka qesja e vënë në dispozicion.<br>Çdo grup zhvillon idenë dhe krijon produktin/tët duke bashkëpunuar në grup.<br>Grupet mbajnë shënime në A4 për të përshkruar mënyrën e krijimit të produkte të tyre, dhe fotografojnë punën e kryer.<br>Drejtuesi i lojës vëzhgon vazhdimisht aktivizimin e anëtarëve të grupeve, komunikimin, bashkëpunimin; si dhe vlerëson punën e grupeve sipas kritereve:<br>-kreativitetin<br>-përfshirjen e materialeve në produktin e realizuar<br>-dobishmërinë e produktit<br>-aktivizimin e anëtarëve |

| | |
|---|---|
| Pjesa përfundimtare (REFLEKTIM) | Grupet prezantojnë produktet e krijuara duke shpjeguar:<br>- zhvillimin e idesë mbi konceptimin e produktit,<br>- zbatimin e idesë për zhvillimin e produktit,<br>- mënyrën se si u përfshinë të gjitha materialet në produktin e realizuar,<br>- argumentojnë dobishmërinë e produktit të krijuar.<br>Vlerësimi bëhet nga grupet.<br>Grupi që vlerëson nuk ka të drejtë të vlerësojë grupin e vet.<br>Ne përfundim grupeve u jepet dhe diskutohet formulari për Feedback<br>Lidhje të mundshme me diskutime të metejshme ose detyra shtëpie<br>A njihni ju produkte, të cilat krijohen nga mbeturina? |
| Vlerësimi i nxënësve | Gjate realizimit te aktiviteteve dhe lojës mësimdhënësi vlerëson punën e nxënësve, po ashtu edhe ide dhe krijimin e gjësend te krijuar nga gjerat e pa vlera. |
| Detyra dhe puna e pavarur | Hulumtoni rreth materialeve te pa vlera te cilat kane mundësi te shndërrohen ne materiale me vlera |
| Reflektim për rrjedhën e orës mësimore | A) I kënaqur B) Relativisht i kënaqur C) Aspak i kënaqur |

## Udhëzuesi i lojës

-Krijohen skuadra me nga 4 – 5 persona.

-Skuadrat do të  përdorin vetëm materialet e dhëna për prodhimin e produktit.

-Cdo skuadër mund të krijojë më shumë se një produkt.

-Produkti (ose produktet) duhet të jeië krijuar duke përdorur mundësisht  të gjitha materialet e qeses.

-Grupet mbajnë shënime në A4 për të përshkruar mënyrën e krijimit të produkteve të tyre, fotografojnë punën e kryer.

-Grupet do të vlerësohen sipas disa kritereve: dobishmërisë, kreativitetin, gjithëpërfshirjen.

-Grupi nuk vlerëson vetveten.

-Fiton grupi i cili ka përmbushur më mirë kriteret e vlerësimit të lojës.

**Materialet e nevojshme per realizimin e lojes për cdo grup:**

2 m tel,

2 letra higjenike

2 mbatjëse qiriu bosh,

1 patate

1 dorëze një përdorimshme

1 pako facoleta,

2 shkopinj druri

25 cm letër zbukurimi,

2 m fije/spango

**Formular për Feedback**

Qarkoni përgjigjen e dëshiruar

Ushtrimi Krijimi i vlerave

1. Si ishte bashkëpunimi në grup? Shumë mirë Mirë Mjaftueshem Dobët

2. Si ishte komunikimi? Shumë mirë Mirë Mjaftueshem Dobët

3. Si ishte niveli i motivimit? Shumë mirë Mirë Mjaftueshëm Dobët

4. Si u arrit rezultati?

____________________________________________________________

5. Cilat janë sugjerimet tuaja për përmirësim

6. Cili grup i përmbushi të gjitha kriteret e lojës?

________________________________________

Karriera Ime: Profesioni im

**Shkolla: Gjimnazi i filologjisë "Eqrem Çabej"** **Komuna: Prishtinë** **Data: ......................**
**Mësimdhënësi/ja: Shpresa Hoxha-Behrami**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><th>Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna</th><th>Lënda:TIK</th><th>Shkalla e kurrikulës:VI</th><th>Klasa: XII</th></tr>
<tr><td>Tema[64]: Karriera Ime<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[65]:<br><br>10 orë mësimore</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br>3.1.1. Hulumton burime të ndryshme të informimit për zhvillim personal dhe profesional (mediat, zyrat e punësimit, QAP-Qendra për Aftësim Profesional dhe QK-Qendra e Karrierës).<br>3.1.2. Promovon shkathtësitë personale përmes përgatitjes dhe prezantimit të një projekti.<br>3.1.4. Aplikon forma të testimit përmes platformave të ndryshme për të vlerësuar aftësitë personale e profesionale.<br>3.2.1. Harton plane afatshkurta dhe afatmesme për karrierën e tij.<br>3.2.3. Praktikon plotësimin online të aplikacioneve të ndryshme (për fakultet, bursa, projekte).<br>3.2.4. Praktikon mënyrat e dërgimit online të dokumenteve (CV, Letër motivuese).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[66] (të synuara me përmes temës):<br>II.2 Analizon në mënyrë të pavarur informatat e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë, p.sh., Orientimi në karrierë, Integrimet evropiane, Ndryshimet klimatike, Rreziqet nga armët konvencionale, Armatimi bërthamor, Zhvillimi kulturor-artistik në vend, Zhvillimi i qëndrueshëm, etj.)<br>III.7 Përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e aplikuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme.<br>IV.3 Me shembuj argumenton ndërlidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, në një punim/prezantim me shkrim prej jo më pak se 1000 fjalësh, në përmbledhje të punimit/prezantimit ofron shembuj të shfrytëzimit të mundësive në dispozicion për arsimim dhe përgatitje profesionale ose këshillim në karrierë.<br>V.1 Demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në jetën e përditshme, duke dalluar me kohë aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve të synuara personale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[67] (të synuara përmes temës):<br><br>3. Këshillim dhe orientim në karrierë<br><br>3.1. Prezanton plane afatshkurtra dhe afatgjata, përmes vendimmarrjes për karrierë të mëtutjeshme.<br>3.2. Harton planin e zhvillimit personal për realizimin e qëllimeve të veta profesionale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[68] (të synuara përmes temës):<br><br>3.1.4. Aplikon forma të testimit përmes platformave të ndryshme për të vlerësuar aftësitë personale e profesionale.<br>3.2.1. Harton plane afatshkurta dhe afatmesme për karrierën e tij.</td></tr>
</table>

[64] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[65] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[66] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[67] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme
[68] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| Njësia mësimore: **Profesioni im ( [69]2 orë mësimore)** | | | |
| Fjalët kyçe: Busulla.com,Testet e karrieres, profesion, karrierë, | | | |
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore<br><br>Në përfundim të orëve të mësimit nxënësi do të:<br>• **përdor** TIK-un për të kërkuar në portalin e karrierës busulla.com për profesionin që e konsideron në të ardhmen<br>• **krahason** njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen në këtë profesion me ato që ai ndjehet se i zotëron ose që duhet të zhvillojë në të ardhmen.<br>• **reflekton** mbi masat që duhet të ndërmerr për të arritur qëllimin e vet.<br>• bënë paraqitje grafike te të dhënave të një analizë dhe statistike, pas një hulumtimi të realizuar. | | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore, nxënësi:<br><br>**1. Kyqet në** portalin Busulla.com dhe sigurohet qe niveli i profilit të tij është kompletuar 100%.<br>**2. Zgjedh** profesionin e së ardhmes nga profesionet e sugjeruara bazuar në përgjigjet e dhëna.<br>**3. Reflekton** për profesionin e zgjedhur, aktivitetet, njohuritë, shkathtësitë kompetencat që i kërkon profesioni i preferuar i tij.<br>**4. Krijon** grafik për pagat e profesionit në nivel të klasës. | |
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br><br>Teksti mësimor, njohuritë që nxënësit kanë në lidhje me temen , kabineti i informatikës i pajisur me kompjuter (laptop),tel. mobil, internet, video projektor.<br>Linku: https://busulla.com/occupations<br>Një burim tjetër i rëndësishëm për informim rreth profesioneve të ndryshme në Kosovë është edhe "Katalogu i Profesioneve" i cili mund të shfletohet online përmes link-ut: http://kpk.rksgov.net/<br>Shënim: Kjo njësi nuk ka internet. Mësimdhënësi duhet të sigurohet që të rregullojë qasjen në internet para orës në mënyrë që të mos humb kohë. | | | |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Ndërlidhja kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim, Shoqëria dhe mjedisi, Shëndeti dhe mirëqenia. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **PJESA HYRËSE Koha: 5 minuta; Metoda e punës: Diskutim, zbatim në praktik** | | | |
| **Diskutim**<br>**Pyetje diskutimi:**<br>Rikujtojmë njohuritë nga klasa X,XI në lidhje me portalin Busulla.com<br>( Nxënësit janë regjistruar nga kl X,XI në portalin Busulla.com, kanë njohuri për komponentët e portalit, kanë realizuar testet e karrierës.)<br>Preferenca e profesionit të se ardhmes ? | | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**<br>**Zbatim në praktikë**<br>Nxënësit kyqen në portalin Busulla.com dhe sigurohen qe niveli i profilit është kompletuar 100%; | |
| **REALIZIMI I KUPTIMIT Koha 25 min; Metoda e punës: Demonstrim, hulumtim, zbatim në praktikë** | | | |
| **Demonstrim i komponentes Profesionet nga portali Busulla.com**<br>https://busulla.com/occupations | **Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**<br><br>Vlerësim i vazhdueshëm individual dhe në grup. | **Mbledhja e provave:**<br>**Hulumtim/ Punë individuale dhe në grupe**<br><br>Nxënësit hulumtojnë, analizojnë, | **Strategjitë për të siguruar informatën kthyese** |

[69] Në kushte normale është planifikuar 1 orë mësimore 45', por në kushte të jashtëzakonshme minutat e planifikuara i zvogëlojm duke ju përshtatur situates.

<table>
<tr>
<td>Hapi 1: Mësimdhënësi kyqet në portalin busulla.com, me profil të tij të kompletuar 100%,<br>Hapi II: Përzgjedh profesionin e mësimdhënësit:<br>https://busulla.com/occupations/mesimdhenes-e-i-e-shkolles-se-mesme-te-larte<br>Hapi 3: Prezanton videon e mësimdhënësit dhe diskuton me nxënësit:<br>• Aktivitetet<br>• Njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen<br>• Kushtet e punës<br>• Veglat e punës<br>• Shkollimi dhe trajnimet e domosdoshme</td>
<td>Nxënësit kyqen në portalin Busulla.com, hulumtojnë, analizojnë profesionet e sugjeruara nga Busulla, pasi qe i kanë përfunduar testet e<br><br>karrierës.<br>Përzgjedhin profesionin e së ardhmes.</td>
<td>rezultatet e arritura në testet e karrierës, paraqesin listën me profesionet e sugjeruara bazuar në përgjigjet e dhëna, zgjedhin profesionin qe u pëlqen, qe do ta vazhdojnë në të ardhmen dhe qe përshtatet me interesat e tyre.<br>Hulumtojnë për pagat e profesioneve.<br>Në grupe nxënësit do të grumbullojnë rezultatet nga hulumtimi i bazuar në kërkesat e tabelës.
<table>
<tr><th>Nxenesi/ja:</th><th>Profesioni:</th><th>Paga: (€)</th></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>
</td>
<td>Analizë e listë kontrollit ne realizimin e kritereve të suksesit.<br>Gjatë praktikës nxënësit i mbështet mësimdhënësi/ja me sugjerime dhe ndihmë.<br>Informata kthyese përshkruese/ orientuese aty ku ka nevojë për përmirësim.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="4">PËRFUNDIMI Koha: 15 min; Metoda e punës: Reflektim</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Pyetje përmbyllëse:<br><br>Cilat ishin sfidat për të zgjedhur profesionin e së ardhmës?<br>Cfarë rëndësie kanë profesionet e sugjeruara bazuar në përgjigjet tuaja?</td>
<td colspan="2">Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse<br>Nxënësit reflektojnë duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë, përforcojnë njohurit duke analizuar në detaje profesionin e së ardhmes.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="4">Teknikat e vlerësimit të nxënësve:<br>Portfolio<br>Të gjitha detyrat për temën ruhen në portfolio.<br>Për këtë njësi ne portofoli vendoset :<br>● Dëshmi me Prt sc për nivelin e kompletimit 100 %,<br>● Dëshmi për profesionin e zgjedhur<br>● Reflektim për profesionin e zgjedhur : aktivitetet, njohuritë, shkathtësitë që nevojiten për atë profesion.<br>● Paraqitja grafike e profesioneve sipas pagave</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur:<br>1. Hulumto për profesionin e së ardhmes<br>2. Analizo aktivitetet dhe njohuritë, shkathtësitë që nevojiten për profesionin e zgjedhur,<br>3. Realizo intervista me profesionistë të fushës me interes dhe krahaso ato me të dhënat në portal.<br>4. Bazuar në të dhënat e profesionit të së ardhmes , krijoni një sekuencë filmike me temën : Profesioni im, duke përdorur aplikacione të ndryshme, dërgimi të bëhet në email, platform online shkollore.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="4">Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore:<br><br>Kjo orë mësimi u organizua duke pasur plotësisht në qendër të procesit vetë nxënësit. Nxënësit ndiheshin të lirshëm dhe të pavarur në punën e tyre.<br>Gjatë punës u vu re se fantazia e nxënësve u la e lirë dhe krijimet ishin me shumë kreativitet, duke bërë të mundur të shpalosin kështu një sërë aftësish. Ishte orë shumë frytdhënëse dhe argëtuese për nxënësit.</td>
</tr>
</table>

**Shëmbuj nga puna e nxënësve: Gjithëpërfshirje e nxënësve në hulumtimin e profesionit**









| Nr. | Nxenesi/ja: | Profesioni: | Paga: (€) |
|---|---|---|---|
| 1 | A. A. | Operator/-e i/ makinave me dirigjim kompjuterik | 1000 |
| 2 | B. K. | Specialist/-e i/marredhenieve me klient | 950 |
| 3 | B. B. | Specialist/-e i/marredhenieve me klient | 950 |
| 4 | E. J. | Specialist/-e i/marredhenieve me klient | 950 |
| 5 | A. Sh. | Matematikan/-e | 900 |
| 6 | E. K. | Avokat/-e | 900 |
| 7 | E. J. | Avokat/-e | 900 |
| 8 | A. B. | Stomatolog/-e | 750 |
| 9 | A. T. | Gazetar/-e | 700 |
| 10 | L. K. | Dizajner/-e i/e modës | 700 |
| 11 | R. S. | Oficer/-e i/e doganave | 700 |
| 12 | V. B. | Fiziatër/-e | 700 |
| 13 | A. D. | Psikolog/-e | 650 |
| 14 | A. R. | Psikolog/-e | 650 |
| 15 | A. V. | Psikolog/-e | 650 |
| 16 | B. L. | Psikolog/-e | 650 |
| 17 | D. U. | Psikolog/-e | 650 |
| 18 | E. L. | Psikolog/-e | 650 |
| 19 | A. K. | Hetues/-e i/ inspektoriatit policor | 638 |
| 20 | A. D. | Biolog/-e | 600 |
| 21 | B. Sh. | Edukator/-e i/e sportit | 600 |
| 22 | D. K. | Edukator/-e i/e sportit | 600 |
| 23 | Rr. H. | Menaxher/-e i/e mirëqenies sociale | 600 |
| 24 | S. S. | Edukator/-e i/e sportit | 600 |
| 25 | A. Z. | Tregtar/-e me shumicë dhe pakicë | 450 |
| 26 | E. P. | Edukator/-e | 450 |
| 27 | F. M. | Edukator/-e | 450 |
| 28 | M. J. | Specialist/-e i/marredhenieve me klient | 450 |
| 29 | P. G. | Edukator/-e | 450 |
| 30 | S. G. | Tregtar/-e me shumicë dhe pakicë | 450 |
| 31 | E. S. | Mekanik/-e i/e veturave | 350 |
| 32 | E. M. | Mekanik/-e i/e veturave | 350 |
| 33 | F. P. | Organizator /-e i/aktiviteteve shoqerore | 300 |

| Profesioni në nivel klase | Paga | Nr. i nx. |
|---|---|---|
| Operator/-e i/ makinave me dirigjim kompjuterik | 1000 | 1 |
| Specialist/-e i/marrëdhënieve ndërkombetare | 950 | 3 |
| Matematikan/-e | 900 | 1 |
| Avokat/-e | 900 | 2 |
| Stomatolog/-e | 750 | 1 |
| Dizajner/-e i/e modës | 700 | 1 |
| Gazetar/-e | 700 | 1 |
| Oficer/-e i/e doganave | 700 | 1 |
| Fiziatër/-e | 700 | 1 |
| Psikolog/-e | 650 | 6 |
| Hetues/-e i/ inspektoriatit policor | 638 | 1 |
| Biolog/-e | 600 | 1 |
| Edukator/-e i/e sportit | 600 | 3 |
| Shkencëtar/-e i/e informatikës | 600 | 1 |
| Menaxher/-e i/e mirëqenies sociale | 600 | 1 |
| Mësimdhënës/-e i shkollave të mësme të larta | 550 | 1 |
| Tregtar/-e me shumicë dhe pakicë | 450 | 1 |
| Edukator/-e | 450 | 3 |
| Specialist/-e i/marredhenieve me klient | 450 | 2 |
| Mekanik/-e i/e veturave | 350 | 2 |
| Organizator /-e i/aktiviteteve shoqerore | 300 | 1 |


PROFESIONI IM NË NIVEL KLASE
6
5
4
3
2
1
0
1
3
1
2
1
1
1
1
1
6
1
1
3
1
1
1
1
3
2
2
1
Operator/-e i/...
Specialist/-e...
Matematikan/-e
Avokat/-e
Stomatolog/-e
Dizajner/-e i/e modës
Gazetar/-e
Oficer/-e i/e doganave
Fiziatër/-e
Psikolog/-e
Hetues/-e i/...
Biolog/-e
Edukator/-e i/e sportit
Shkencëtar/-e i/e...
Menaxher/-e i/e...
Mësimdhënës/-e i...
Tregtar/-e me...
Edukator/-e
Specialist/-e...
Mekanik/-e i/e...
Organizator /-e...


PAGA E PROFESIONIT TIM NË NIVEL KLASE
1200
1000
800
600
400
200
0
1000
950
900
900
750
700
700
700
700
650
638
600
600
600
600
550
450
450
450
350
300
Operator/-e i/ makinave me...
Specialist/-e...
Matematikan/-e
Avokat/-e
Stomatolog/-e
Dizajner/-e i/e modës
Gazetar/-e
Oficer/-e i/e doganave
Fiziatër/-e
Psikolog/-e
Hetues/-e i/ inspektoriatit...
Biolog/-e
Edukator/-e i/e sportit
Shkencëtar/-e i/e...
Menaxher/-e i/e mirëqenies...
Mësimdhënës/-e i shkollave...
Tregtar/-e me shumicë dhe...
Edukator/-e
Specialist/-e...
Mekanik/-e i/e veturave
Organizator /-e...

**Shembuj nga krijimi i  nje sekuencë filmike : “Profesioni Im” , krijmtari e nxënësve**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
|  Profesioni Mësimdhënës SHML<br>Profesioni Mësimdhënës SHML |  Profesioni-tennis coach<br>Profesioni-tennis coach.mp4 |  Profesioni Arkitekte<br>Profesioni Arkitekte.mov |  XII2 Fitore Rudari - Edukatore e Sportit<br>XII2 Fitore Rudari - Edukatore e Sportit. |  Profesioni-Logoped<br>Profesioni-Logoped .mp4 |  V. Binaku, profesion -Vallëtare |  A. Hashani, profesioni-Sportiste |
|  S. Sadiku, profesioni-Edukatore Sporti |  A. Sadiku, Intervista- Mjeke |  A. Selimi, profesioni- Mjeke |  A. Hasani, profesioni-Perkthyese |  A. Veseli, profesioni-Sportiste |  B. Gashi, profesioni-Gj.angleze |  D. Mehmeti, profesioni -Dizajn Interiere |
|  O. Grajqevci, profesioni-Edukatore |  E. Uka, profesioni -Mjeke |  J. Pireva, profesioni-Psikologe |  Sh. Mustafa, profesioni-Bibliotekiste |  D. Uka, profesioni -Shkrimtare |  O. Gashi, profesioni- Mjeke |  E. Leci, profesioni-Arkitekte |

Karriera Ime: Kërkimi i Fakultetit

**Shkolla: Gjimnazi i filologjisë "Eqrem Çabej" Komuna: Prishtinë Data: ......................**
**Mësimdhënësi/ja: Shpresa Hoxha-Behrami**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna** | **Lënda:TIK** | **Shkalla e kurrikulës:VI** | **Klasa: XII** |
| Tema[70]: Karriera Ime<br><br>Orët/Njësitë e nevojshme për realizim[71]:<br><br>10 orë mësimore | Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:<br><br>3.1.1. Hulumton burime të ndryshme të informimit për zhvillim personal dhe profesional (mediat, zyrat e punësimit, QAP-Qendra për Aftësim Profesional dhe QK-Qendra e Karrierës).<br>3.1.2. Promovon shkathtësitë personale përmes përgatitjes dhe prezantimit të një projekti.<br>3.1.4. Aplikon forma të testimit përmes platformave të ndryshme për të vlerësuar aftësitë personale e profesionale.<br>3.2.1. Harton plane afatshkurta dhe afatmesme për karrierën e tij.<br>3.2.3. Praktikon plotësimin online të aplikacioneve të ndryshme (për fakultet, bursa, projekte).<br>3.2.4. Praktikon mënyrat e dërgimit online të dokumenteve (CV, Letër motivuese). | | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës[72] (të synuara me përmes temës)*:*<br>**II.2** Analizon në mënyrë të pavarur informatat e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë, p.sh., Orientimi në karrierë, Integrimet evropiane, Ndryshimet klimatike, Rreziqet nga armët konvencionale, Armatimi bërthamor, Zhvillimi kulturor-artistik në vend, Zhvillimi i qëndrueshëm, etj.)<br>**IV.3** Me shembuj argumenton ndërlidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, në një punim/prezantim me shkrim prej jo më pak se 1000 fjalësh, në përmbledhje të punimit/prezantimit ofron shembuj të shfrytëzimit të mundësive në dispozicion për arsimim dhe përgatitje profesionale ose këshillim në karrierë.<br>**V.1** Demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në jetën e përditshme, duke dalluar me kohë aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve të synuara personale. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për RM të fushës[73] (të synuara përmes temës):<br>**3. Këshillim dhe orientim në karrierë**<br>3.1. Prezanton plane afatshkurtra dhe afatgjata, përmes vendimmarrjes për karrierë të mëtutjeshme.<br>3.2. Harton planin e zhvillimit personal për realizimin e qëllimeve të veta profesionale. | | | |
| Rezultatet e të nxënit për lëndën mësimore[74] (të synuara përmes temës):<br>Përdor TIK-un për të kërkuar në portalin busulla.com për fakultetet në Kosovë<br>Krahason programet që i ofrojnë fakultetet dhe shkathtësitë që kërkohen për të aplikuar.<br>Analizon fakultetin më të kërkuar për punë në treg | | | |

[70] Tema nxjerret nga plani i përgjithshëm vjetor/dymujor/javor
[71] Tema mund të realizohet përmes një apo më shumë orëve/njësive mësimore
[72] Nga RM të shkallës kurrikulare nga KB, këtu përzgjedhen ato të cilat synohen përmes kësaj teme
[73] Nga RM të fushës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato cilat synohen përmes kësaj teme
[74] Nga RM të lëndës mësimore të përcaktuara me KB, përzgjedhen ato të cilat synohen përmes lëndës

| |
|---|
| Përpilojnë plan veprimin personal për karrierën e tyre dhe tregojnë rrugët e realizimit të tij |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: **Kërkimi i fakultetit ( [75]1 orë mësimore)** |
| Fjalët kyçe:Universitetet/ Kolegjet, drejtimet/departamentet e fakulteteve |

| | |
|---|---|
| Rezultati/et e të nxënit të pritura nga njësia mësimore<br><br>Në përfundim të orës së mësimit nxënësi do të:<br>• **Hulumton** duke kërkuar fakultetet që janë në portalin e karrierës bosulla.com, universiteti i Prishtinës dhe përparësitë e tyre<br>• **Identifikon** përparësitë e fakulteteve sipas kërkesave në treg<br>• **Analizon** fakultetet duke gjetur atë më të kërkuar nga studentët dhe tregu | Kriteret e suksesit për njësinë mësimore, nxënësi:<br>• **Hulumton** për fakultetin qe i ofron profesionin e përzgjedhur<br>• **Analizon** drejtimin, semestrat lëndet për fakultetin e përcaktuar.<br>• **Argumenton** arsyen përse e zgjodhi këtë fakultet |

| |
|---|
| Burimet, materialet mësimore, dhe mjetet e konkretizimit:<br>Teksti mësimor, njohuritë që nxënësit kanë në lidhje me temen , kabineti i informatikës, internet, videoprojektor.<br>Linqet: https://busulla.com/ , https://uni-pr.edu/<br>Shënim: Kjo njësi vështirë realizohet nëse nuk ka internet. Mësimdhënësi duhet të sigurohet që të rregullojë qasjen në internet para orës në mënyrë që të mos humb kohë. |
| Lidhja me lëndët tjera, çështjet ndërkurrikulare dhe me situata jetësore:<br>Ndërlidhja kurrikulare:<br>Më të gjitha fushat e kurrikulës-<br>Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Matematika; Shkencat e natyrës; Shoqëria dhe mjedisi; Edukata fizike, sportet dhe shëndeti; Jeta dhe puna. |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| ***PJESA HYRËSE Koha: 5 minuta; Metoda e punës: Brainstorming(Stuhi idesh)*** |

| | |
|---|---|
| **Diskutim**<br>**Stuhi idesh**<br>Mësimdhënësi hap diskutimin me nxënës:<br>Pas realizimit të testeve të karrierës nga web faqja busulla.com, keni arritur të përcaktoheni për profesionin e se ardhmes.<br>Si mund të informoheni për fakultetin qe ju ofron profesionin e përzgjedhur? | **Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përshkruese për nxënësit**<br>Marrja e ideve nga nxënësit rreth informimit për fakultetin ku ata synojnë ta vazhdojnë. |
| ***REALIZIMI I KUPTIMIT Koha 25 min; Metoda e punës:Demostrim, Hulumtim/Punë në grupe*** | |

[75] Në kushte normale është planifikuar 1 orë mësimore 45', por në kushte të jashtëzakonshme minutat e planifikuara i zvogëlojm duke ju përshtatur situates.

**Demonstrim**

Mësimdhënësi/ja prezanton fakultetet në busulla.com dhe në web faqen e Universitetit të Prishtinës.







https://busulla.com/school_finder/faculties
https://uni-pr.edu/

**Strategjitë për vlerësim dhe vlerësim të bashkëmoshatarëve**

Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual.
Nxënësit në mënyrë individuale hulumtojn për fakultetin qe ju ofron profesionin e përzgjedhur.
Nxënësit deklarohen për fakultetin e përzgjedhur, dhe bëhet ndarja në grupe sipas fakulteteve qe do të vijojnë, vazhdojn hulumtimin për drejtimet/semestrat/lendet ...

**Mbledhja e provave:**

**Hulumtim/ Punë në grupe**
Nxënësit hulumtojn web faqet qe të ofrojn mundësin e informimit rreth fakulteteve si portali: Busulla.com ,linku:https://busulla.com/school_finder/faculties
Web faqja e Universitetit të Prishtinës Linku: https://uni-pr.edu/
Plotësimi i tabeles: Di, Dua të di, Mësova.
Tabela është elektronike, e plotësuar dergohet të mësimdhënësi përmes emailit, platformave elektronike, por mund të jetë edhe e printuar dhe të plotësohet në menyrë manuale nga nxënësit.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| | | |

**Strategjitë për të siguruar informatën kthyese**

Analizë e tabelës: : Di, Dua të di, Mësova, pasi është plotësuar nga nxënësit.
Informata kthyese përshkruese/ orientuese aty ku ka nevojë për përmisim.

***PËRFUNDIMI*** ***Koha: 15 min;*** ***Metoda e punës: Reflektim***

**Pyetje përmbyllëse:**

Çfarë rëndësie kanë portali https://busulla.com/ dhe web faqja https://uni-pr.edu/ për ju si nxënës në orientimin në karrierë?
Cili është fakulteti që ke në përzgjedhjen e ngushtë?
Përse ke vendosur të shkosh në këtë fakultet? A ishte vendim i lehtë?
Ku mund të gjeni punë me këtë fakultet?
Sa mund të jetë rroga në mesatare me këtë fakultet?
A ka vend pune për të gjithë me këtë fakultet?
Sa mund të jetë përqindja e punësimit?

**Strategjitë për të siguruar informatë kthyese përmbyllëse**

Nxënësit reflektojnë në pyetjet përmbyllëse duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë, duke berë një përmbledhje për rëndesinë që kanë web faqet online në Orientimin në Karrierë.
Tani e njohin veten më mirë. Tani dinë më shumë lidhur me rrugët e shkollimit dhe kanë mësuar të informohen. Kjo natyrisht se sjellë më shumë siguri për vendimmarrje. Rezultatet e mbledhura i shfrytëzojnë si ndihmesë për orientim në karrierë.

**Teknikat e vlerësimit të nxënësve**:
Vlerësim formativ përmes:
Informatave kthyese
Teknikës -DI/DUA TE DI/MËSOVA
Pyetjeve efektive
Portofolio

| |
|---|
| **Detyrat dhe puna e pavarur**:<br>• Hulumton për fakultetet që janë në Kosovë<br>• Analizon drejtimet që i ofrojnë këto fakultete<br>• Bën krahasimet e profesioneve sipas pagës dhe kërkesave në treg<br>• Përzgjedh se cili është fakulteti i preferuar i tij<br>• Shkruan arsyen përse e zgjodhi këtë fakultet<br>Të gjitha punimet me dëshmi të vendosen në portofoli elektronike të nxënësit. |
| **Reflektim i mësimdhënësit mbi realizimin e orës mësimore**:<br>Kjo orë mësimi u organizua duke pasur plotësisht në qendër të procesit vetë nxënësit. Nxënësit ndiheshin të lirshëm dhe të pavarur në punën e tyre. Ishte orë shumë frytdhënëse dhe argëtuese për nxënësit.<br>Nxënësit tani dinë më shumë lidhur me rrugët e shkollimit dhe kan mësuar të informohen. Kjo natyrisht se sjellë më shumë siguri për vendimmarrje. Rezultatet e mbledhura i shfrytëzojn si ndihmesë për orientim në karrierë. |

Shembuj nga puna e nxënësve

<table>
<tr><th>DI</th><th>DUA TE DI?</th><th>MESOVA</th></tr>
<tr><td>Testet e karrierës nga webfaqja Busulla.com me ndihmuan në përcaktimin e profesionit, profesioni im i përzgjedhur është logopede.





</td>
<td>Fakultetin që e ofron këtë profesion?</td>
<td>Nga webfaqet: busulla.com dhe uni-pr.edu mësova fakultetin që e ofron këtë profesion, mesova për semestrat, bursat dhe lëndet që ka ky drejtim.




Ky drejtim ka 6 semestra: Semestri i parë ka 5 lendë, semestri i dytë ka 8 lendë, semestri i tretë ka 5 lendë, semestri i katert ka 7 lendë, semestri i pestë ka 6 lendë dhe semestri i gjashtë ka 7 lendë.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><th>Di</th><th>Dua të di</th><th>Mësova</th></tr>
<tr><td>
Nga plotësimi i testeve të karrierës tek portali Busulla.com, kam arritur të përcaktohem për profesionin tim.

Profesioni im i zgjedhur është:

</td>
<td>-Fakultetin qe ma ofron profesionin e përzgjedhur.
-Sa semestra ka fakulteti i përzgjedhur, nivelin dhe graden akademike dhe kohezgjatjen per degen shkenca kompjuerike.</td>
<td>
</td></tr>
</table>



Fakulteti Filologjik

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| -Pas plotësimit të testeve të karrierës, testit IVAP dhe atij të potencialit, rezultati që morra për profesionin e të ardhmes ësntë "Profesoreshë e gjuhës angleze". | 1) Sa vite janë gjithsej? 2) Sa kushton çdo vit? 3) Sa semestra janë gjithsej? 4) A ofron ky universitet bursë? 5.) | 1) Janë 3 vite gjithsej. 2). 50 euro për çdo vit. 3). Janë gjithsej 6 semestra. 4) Ky universitet nuk ofron bursë?. 5.) |

Olta Grajçevci XII/3



Njësia- Kërkimi i fakulltetit

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| -Në bazë të përgjigjeve pas kryerjes së testeve IVAP dhe të potencialit më dolën disa profesione, nga të cilat profesioni të cilin dua te kem është psikologe. | -Dua të di se cilin fakultet duhet ta zgjedh për të vazhduar këtë profesion, sa është çmimi dhe a ofron bursë, sa semestra janë dhe cilat janë lëndët që jepen gjatë këtyre semestrave. | -Mësova se:<br>-Fakulteti filozofik -publik- Universiteti i Prishtinës<br>-Drejtime: Shkenca sociale, gazetari dhe informim.<br>-Çmimi: nga 50€ për 3 vite.<br>-Nuk ofrom bursa.<br>-Janë gjithsej 6 semestra.<br>-Lëndët që jepen janë:<br>• Psikologji e përgjithshme,<br>• Statistikë,<br>• Psikologji zhvillimore,<br>• Hulumtimi i literaturës,<br>• Gjuhë angleze,<br>• Biopsikologji etj. |

Anjesa Gërvalla

**Shtojca 1: Analiza e RNF, RNL dhe Njësive mësimore për qëllime planifikimi**

| **Plani Vjetor** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla 5** | | | | |
| **Klasa** | **X** | | | |
| **Koncepti** | **Orë 74** | **RNF** | **RNL** | **Temat e propozuara** |
| TIK | 36 | 1. **Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.**<br>*1.1. Analizon ndryshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.*<br>*1.2. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë në mënyrë individuale dhe në grup*<br>2. **Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë**<br>*2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënit*<br>**4. Përdorimi i TIK-ut për të avansuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.**<br>4.1. Analizon disa nga përparësitë dhe mangësitë e | 4.2.1. Shpjegon veprimet në lidhje me formulat.<br>4.2.2. Lokalizon vendosjen e formulave në qeli.<br>4.2.3. Cekë shprehjet aritmetikorë.<br>4.2.4. Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritja e shumës, e prodhimit etj.).<br>4.2.5. Përdorë funksione për punën me tekst, funksionet financiare dhe shpjegon rëndësinë e tyre<br>4.2.6. Identifikon zgjidhjen e problemeve gjatë përdorimit të funksioneve.<br>4.2.7. Shpjegon sortimin rritës dhe zvogëlues si dhe bën filtrimin e të dhënave.<br>4.2.8. Tregon hapat për printimin e të dhënave.<br>4.2.9. Emërton fillimin dhe fundin e faqes.<br>4.2.10. Demonstron organizimin e fletës punuese.<br>4.2.11. Ndërlidh hapat që duhet të përdoren për aktivizimin e sistemit grafik ( insertimi i një grafiku për tabelën e dhënë).<br>4.2.12. Shpjegon llojet e grafikëve duke demonstruar hapat e insertimit të tyre.<br>4.2.13. Krahason përparësitë e aplikacionit PoëerPoint për prezantim me aplikacionet e tjera.<br>4.2.14. Tregon krijimin e një prezantimi të një teme të caktuar duke pasur parasysh edhe përdorimin e teknologjisë për të realizuar prezantimin.<br>4.2.15. Tregon mënyrën e editimit të të dhënave në sllajde duke pasur parasysh stilin e përdorur, madhësinë e tij dhe vendosjen e tekstit në pozitën e caktuar.<br>4.2.16. Interpreton dizajnimet e ndërtuara duke dhënë sqarime për secilin sllajd të dizajnuar për prezantim | 1. **Projekti Shitorja Ime (12 orë)** (Formulat dhe Funksionet)<br>(RNF 1.1.,1.2, 2.1)<br>(RNL 4.2.1-4.2.6))<br>Përdorimi i excel për të:<br>● regjistruar artikujt në fletën punuese(2 orë)<br>● kategorizuar dhe procesuar artikujt në qeliza, rreshta dhe shtylla (2 orë)<br>● bërë llogaritjet duke përdorur formulat (2 orë)<br>● punon me tekst dhe llogaritje financiare duke përdorur funksionet (4 orë)<br>● Test ( 2 orë )<br>2. **Raportet e produkteve, shitjeve.(** Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve, shtypja dhe grafiku**) (8 orë)**<br>RNF (4.1 dhe 4.2)<br>RNL (4.2.7-4.2.12)<br>Përdorimi I excel per të: |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | përdorimit të TIK-ut për projekte hulumtuese dhe në punë<br>4.2. Demonstron shkathësi për përdorimin e aplikacioneve dhe webshërbimeve<br>.<br><br>**8. Komunikimi për jetë dhe punë.**<br>*8.1. Përdorë multimedia për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme* | 4.2.17. Shpjegon rëndësinë e paraqitjes së tekstit në sllajde.<br>8.1.1. Tregon se gjatë krijimit të prezantimit në PoëerPoint përveç teksteve mund të shfrytëzon edhe materiale të tjera multimediale, si: fotografi, incizime multimediale, vizatime, animacione etj.<br>8.1.2. Demonstron përdorimin e efekteve në sllajde.<br>8.1.3. Diskuton rëndësinë e prezantimit.<br>8.1.4. Përshkruan hapat gjatë fazës së printimit.<br>8.1.5. Tregon për avansimin dhe përparësitë e multimedias.<br>8.1.6. Tregon për elementet themelore të grafikës, përpunimit të fotografive (figurave).<br>8.1.7. Dallon kompjuterët të cilët shfrytëzohen gjatë dizajnimit ose prezantimit të sekuencave multimediale.<br>8.1.8. Dallon cilësinë e prezantimit të një materiali multimedial.<br>8.1.9. Tregon krijimin e sekuencave multimediale duke përdorur programet përka<br>8.1.10. Krijojnë sekuenca filmike dhe bëjnë prezantimin e tyre duke marrë për bazë punët në dizajnim, përpunim grafik dhe projektim. | • analizuar të dhënat duke sortuar dhe filtruar ato.(2 orë)<br>• Gjeneruar grafikone dhe tabela me qëllim të prezantimit të të dhënave(2 orë)<br><br>• Integrimi i grafikoneve për realizimin e shtypjes dhe shkrimin e raporteve (Excel dhe Word)(2 orë)<br><br>• Test (2 orë)<br><br>3. **Prezantimi i shitores dhe produkteve (10 orë)** Krijimi i prezantimeve<br><br>RNF 4.2<br><br>RNL (4.1.13. -4.1.17.)<br><br>Përdorimi i power point për të :<br><br>• Prezentuar shitoren dhe produktet duke përdorur tekst, foto, multi-media.(4 orë)<br>• Komunikuar idetë dhe produktet para kolegëve (4 orë)<br>• Prezantimet në klasë (2 orë)<br>4. **Multimedia, prezantimi i multimedies ( Reklama e shitores** Multimedia, krijimi i sekuencave multimediale**) (6 orë)**<br><br>RNF 8<br>RNL (8.1.1.-8.1.6) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Përdorimi i moviemaker ose canva për të bërë:<br>● Video reklamë të shitores dhe produktit (3 orë)<br>● Postim në media sociale për shitoren ose produktin ( 2 orë)<br>Prezantimet në klasë: 1 orë |
| NEF | 14 | **5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë.**<br>5.1. Prezanton ide kreative për krijimin e një biznesi duke u bazuar në analizën e tregut të punës. | 5.1.1. Përshkruan rolin e tregut.<br>5.1.2. Hulumton tregun<br>5.1.3. Kërkesat dhe nevojat në kohë dhe vend të caktuar.<br>5.1.4. Prezanton në power point kërkesat dhe nevojat në kohë dhe vend të caktuar. | **Ndermarrësi i ri.**<br>Krijimi i një biznesi të ri. Zhvillues i Webfaqeve ( 10 orë)<br>RNF 5.1<br>RNF 4.1.<br>RNL 5.1.1-5.14)<br>● Cka eshte nje nderrmarrës, cilësitë e nderrmarrëist ( 2 orë)<br>● Zhvillimi i webfaqeve, hulumtimi i tregut ( 2 orë)<br>● Zhvillimi i nje ideje të biznesi, modeli canvas ( 2 orë)<br>● Word press basics shembull (2 orë) (TIK)<br>● Prezantim i idesë së biznesit dhe planit të biznesit( 2 orë) |
| OKK | 14 | **3. Këshillim dhe orientim në karrierë**<br>*3.1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme.*<br>3.2. *Ndërlidhë njohuritë dhe shkathtësitë personale me nevojat e tregut të punës.*<br><br>**7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme.** | 3.1.1. Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës "se çfarë janë të aftë të bëjnë".<br>3.1.2. Shpjegojnë se si mund t'í arrijnë qëllimet për të zhvilluar karrierën.<br>3.2.1. Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë.<br>3.2.2. Tregojnë për azhurnimin/përditësimin e portfolios personale.<br>3.2.3. Përdorin aplikacione të ndryshme për ndërtimin e CV, përzgjedhin formën e duhur të CV-së dhe ndërtojnë përmbajtjen e saj. | **Karriera Ime**<br>**Planifikimi i Karrierës** (2 orë)<br>**Krijimi i e-mailit** (1 orë)<br>Për regjistrim në portalin Busulla.com, duhet qe nxënësit të posedojn e-mail (preferohet hapja e e-mailit në gmail ).<br>**Regjistrimi në portalin e karrierës busulla.com** (2 orë)<br>RNF 3.2.<br>RNL (3.2.1. )<br>Ndërlidhja kurrikulare:<br>Krijimi i llogarisë kërkon përdorimin e emailit (preferohet emaili zyrtar) dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 7.1. Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacionin dhe kërkesat e tregut të punës. | | krijimin e passwordit.<br><br>**Testi i Karrierës IVAP dhe i Potencialit** (4 orë)<br>RNF 3.2<br>RNL ( 3.1.1, 3.1.2)<br>● Testi IVAP<br>● Testi i Potencialit<br><br>Ndërlidhja kurrikulare:<br>Përdorimi i internetit<br>Paraqitja e rezultateve të testit si fotografi në detyrën e dorëzuar në Word<br><br>**CV dhe portfolio personale (3 orë)**<br>RNF 3.2, 7.1<br>RNL ( 3.2.2 dhe 3.2.3)<br>● Ndërtimi i CV-së<br>● Portfolio<br>Ndërlidhja kurrikulare:<br>Shkrimi i CV, gjuha shqipe Procesimi i CV në Word,<br>Plotësimi i CV në portalin busulla.<br>Krijimi dhe azhurimi i portfolios<br>Prezantim i detyrave (2 orë) |
| ZHQ | 10 | **RNF: 9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit.**<br><br>9.1. Tregon kujdes për mjedisin e punës dhe arsyeton rolin e teknologjisë në ruajtjen e ambientit. | 9.1.1. Analizon pajisjet teknologjike duke bërë krahasime rreth shpenzimeve energjetike dhe procesit të shpejtësisë së tyre të përpunimit.<br>9.1.2. Tregon rëndësinë e pajisjeve të Teknologjisë Informative në shëndetin e njeriut.<br>9.1.3. Përpunon informata rreth sulmeve kibernetike dhe shpjegon rëndësinë e tyre.<br>9.1.4. Tregojnë për rreziqet nga interneti. | **Shtëpia e Menqur**<br>Përdorimi i teknologjisë me shpenzim të ulët të energjisë elektrike.<br>**Ndikimi i wifi-së në shëndetin e njëriut**<br>**Sulmet kibernetike**<br>Mbrojtja e informatave personale dhe institucionale |